

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri



MINISTRIA E MJEDISIT PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TE UJRAVE

***PERGATITJA E PROFILIT KOMBETAR SHQIPETAR
PER TE VLERESUAR STRUKTUREN KOMBETARE
NE MENAXHIMIN E KIMIKATEVE DHE ZBATIMIN E
UDHEZIMEVE TE SAICM***

Tirane

Prill 2006

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri



National Profile for Chemical Management and SAICM Implementation Albania

***PERGATITJA E PROFILIT KOMBETAR SHQIPETAR
PER TE VLERESUAR STRUKTUREN KOMBETARE
NE MENAXHIMIN E KIMIKATEVE DHE ZBATIMIN E
UDHEZIMEVE TE SAICM***

Koordinator Kombetar

Kujtim Bicaku

*TIRANE
PRILL 2006*

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

Tabela e Permbajtjes

	Hyrje ne Profilin Kombetar.....
Kapitulli 1 :	Bekgraundi i Informacionit Kombetar.....
Kapitulli 2 :	Prodhimi i Kimikateve , Eksporti , Importi dhe Perdorimi.....
Kapitulli 3 :	Prioritete ne Lidhje me Prodhimin e Kimikateve , Importin , Eksportin dhe Perdorimin.....
Kapitulli 4:	Instrumentet Ligjore dhe Mekanizmat Jorregullator per Menaxhimin e Kimikateve.....
Kapitulli 5:	Ministrite , Agjensite dhe Institucionet e Tjera per Menaxhimin e Kimikateve.....
Kapitulli 6:	Aktivitetet Perkatase te Industrise , Grupeve te Intersit Publik dhe Sektorit Te Kerkimit.....
Kapitulli 7:	Komisionet Nderministrare dhe Mekanizmat Koordinativ.....
Kapitulli 8:	Hyrje ne te Dhena dhe Perdorimi Informacionit
Kapitulli 9:	Infrastruktura Teknike.....
Kapitulli 10:	Lidhjet Nderkombetare.....
Kapitulli 11:	Ndergjegjsimi / Kuptimi i Punonjesve dhe Publikut.....
Kapitulli 12:	Burimet e Disponueshme dhe te Nevojshme per Menaxhimin e Kimikateve.....
Shtojca 1:	Fjalorth.....
Shtojca 2:	Raportet Kombetare te Disponeushme dhe Shkresat e Adresuara Aspekteve te Ndryshme te Menaxhimt te Kimikateve.....
Shtojca 3:	Emrat dhe Adresat e Individeve Kryesor dhe Organizmave qe merren me kimikatet Shtojce ne Dokumentin Udhezues1 . Lista e Shkurtimeve

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

Grupi Kodinator Kombetar

Kordinator Kombetar – Kujtim Biçaku

No	Institucionet	Perfaqesuesit
1	Min. Mjed. Pyjeve dhe Admin te Ujrave	Pellumb Abeshi,Narin Panariti,Brikena Shima
2	Instituti i Mjedisit	Etleva Canaj
3	Min. Bujq. Ushq. Mbrojtjes se Konsumatorit	Ismet Bici
4	Min. Punes Ceshtjeve Soc.& Shans.Barabart	Eda Beqiri
5	Ministria Ekonomise Tregetise dheEnergjise	Genc Luarasi
6	Min. Transportit dhe Telekomunikacionit	Arben Maloku Vladimir Bezhani
8	Ministria e Mbrojtjes	Fadil Vucaj
10	Ministria e Shendetesise	Merita Selfo
13	Shoqata Kimisteve	Iilir Malollari
15	Fakulteti Shkencave Natyres	Alqi Cullaj
16	UNDP	Vladimir Malkaj
17	Deka Compani	Arben Memo
18	Levizja Ekologjike	Xhemal Mato
19	REC	Mihallaq Qirio
21	Qendra Komb. Shkenc. Hidrokarbureve Fier	Irakli Prifti
22	Instituti Tokave	Ometa Fejzo
23	Instituti I Hidrometeorologjise	Emirjeta Adhami
24	Drejtoria e doganave	Liljana Alimeta
25	NGO	Petraq Krastafillaku

Hyrje

Pergatitja e Profilit Kombetar per Menaxhimin e Kimikateve ne vendin tone eshte rezultat i perpjekjeve te bera nga UNITAR (Instituti i Kombeve te Bashkuara per Trainim dhe kerkim), i financuar nga Komisioni European , Qeveria Zvicerane dhe I pjesemarrsesve te tere organizmave Qeveritare dhe Joqeveritare te interesuara per kete problem ne Shqiperi .

Konferenca e Kombeve te Bashkuara per Zhvillimin e Qendrueshem te mbajtur ne Rio ne 1992 , dhe samiti Boteror i Zhvillimit te Qendrueshem specifikoi kuadrin politik nderkombetar per aktivitetet ne fushen e menaxhimit te kimikateve .

Ne vitet e para pas Samitit te Rios per shkak te situatave ekonomike , sociale dhe politike qe lidheshin me nje tranzicion te veshtire , kuptimit te ngushte te rendesise se mjedisit , nivelit te ulet institucional te organit te ngarkuar me mbrojtjen e mjedisit , pamundesise financiare , teknike etj , ceshtjet e mbrojtjes se mjedisit nga kimikatet dhe zhvillimit te qendrueshem , nuk benin pjese ne listen e problemeve me prioritete te larte ne vendin tone .

Ne vitet e fundit ato gradualisht kane ardhur gjithnje e me shume ne vemendjen e qeverise dhe si rezultat ne nje numer dokumentesh te rendesishem politike kombetare jane bere perpjekje per tu dhene vemendjen e duhur ceshtjeve kryesore te mjedisit duke i integruar ato me problemet e fushave te tjera.

Hartimi i Profilit Kombetar per Menaxhimin e Kimikateve behet per disa arsye ;

1. Te krijoje sigurine e nevojshme per prodhimin , perdorimin , transportin dhe ruajtjen e kimikateve .
2. Te perputhet me marreveshjet nderkombetare lidhur me ;
 - a. Harmonizimin e legjislacionit shqiptar me ate te Komunitetit European
 - b. Zbatimin e detyrimeve te Shqiperise si anetare e OBT
3. Te zvogeloje rrezikun mjedisore dhe shendetsor si dhe
4. Te plotesoje kerkesat per antarsim ne Komunitetin European

Ne Shqiperi pothuajse eshte nderprer prodhimi i kimikateve si ac. sulfurik , nitric pesticidet etj Vazhdon prodhimi i O_2 , CO_2 , CaO , CaC_2 , $CaCO_3$ etj.. te cilat perdoren per nevojat e vendit.

Shqiperia eshte importuese e tere lendeve kimike , boje per prodhime industriale,te mallrave te ndryshem . Jane ngritur shume pika prodhuese te detergjenteve te ndryshem , vajrave lubrifikante , bojrave , llaqeve te cilat bazohen ne importin e lendeve aktive , te lendeve ndihmuese te nevojshme duke bere perzierje , formulime kompozime sipas nevojave e kerkesave te tregut te lire

Pergatitja e Profilit Kombetar per Menaxhimin e Kimikateve u mundesua nga UNITAR , Komisioni European dhe Qeveria Zvicerane , u mbeshtet dhe u miratua nga Ministria e Mjedisit , Ministria e Bujqesise , Ministria e Industrise , Ministria e Shendetesise dhe institucine te tjera te interesuara . Ndihma financiare , informacioni dhe konsulta e dhene nga UNITAR ishte vendimtare per realizimin e projektit

Ne vendin tone mbyllja e ndermarrjeve prodhuese vec papunesise solli edhe braktisjen e mjediseseve te punes dhe lenien jashte kontrollit te kimikateve gjendje , mbetjeve toksike dhe te rrezikshme duke rritur shume shkallen e ekspozimit ndaj riskut ne zona te caktuara , qe per fat te keq jane populluar nga shtresa te varfere te popullsisë te migruar kohet e fundit nga zonat verilindore .

Nje nga treguesit e praktikave te perdorimit te paqendrueshem eshte dhe ndotja nga industrite e se kaluare dhe krijimi per kete arsye i zonave te nxehta mjedisore (Hot Spote). Aktualisht vendi ka 9 zona qe bartin mbeturina te tilla toksike e kancerogjene te lena ne me te shumten e rasteve jashte kontrollit . Pese prej tyre jane konsideruar si zona te nxehta mjedisore edhe nga studime nderkombetare . Keto permbajne mbetje te merkurit , lindanit , kromit 6 valent , tiramit , dioksiave ,

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

furamit dhe mbetje të tjera të pesticideve ose të produkteve të naftës si dhe instalime perkatëse të braktisura .

Rehabilitimi mjedisor i këtyre zonave është një nga prioritetet e Strategjisë së Zhvillimit Socio-Ekonomik të vendit dhe Planit Kombëtar të veprimit për Mjedisin , i lidhur ngushtë me nevojën për përmirësimin e shëndetit publik dhe të drejtën për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm . Ai shihet si një mundësi për rritjen e potencialit turistik të zonave bregdetare prandaj të cilave ndodhen disa nga pikat e rëndësishme

Kapitulli 1
Informacion Pasqyrues Kombëtar

- 1.1 Karakteristikat Gjeografike , Natyrale dhe Demografike
- 1.2 Struktura Politike e Vendit
- 1.3 Sektoret Industrial dhe Bujqësor
- 1.4 Komentë

1.1 Karakteristikat Gjeografike , Natyrale dhe Demografike

Pozicioni Gjeografik

Shqipëria është e vendosur në pjesën perëndimore të Gadishullit Ballkanik ndërmjet $49^{\circ} 39'$ gjerësi gjeografike veriore (Vermosh) , $39^{\circ} 16'$ jugore (Konispol) , $21^{\circ} 40'$ lindore , Vernik $19^{\circ} 16'$ perëndimore (Sazan) . Shqipëria është një ndër vendet me të vogla në Europë .

Shqipëria i ndan kufijtë me Malin e Zi dhe Kosovën në Veri , me Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë në Veri Lindje dhe me Greqinë në Jug dhe në Juglindje , në Perëndim dhe Jugperëndim janë Detërat e Adriatikut dhe Jonit .

Shqipëria është kryesisht një vend malorë . Afërsisht $\frac{3}{4}$ e territorit të saj përbehen nga vende malorë mbi 300 m mbi nivelin e detit . Maja më e lartë është Maja e Korabit (2.753 m) Mali i Korabit është në kufi me ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë . Pjesa tjetër përbehet nga rrafshina të rrafshta bregdetare ose kodra të ulta .

Shqipëria ka një sipërfaqe prej 28.750 km . Gjatesia kufitare e saj është 1094 km , prej të cilave 316 km janë vijë bregdetare , 657 km janë kufitare , 48 km janë lumenj , 73 km janë liqene .

Natyrë

Shqipëria është kryesisht një vend malor : 28% është e përbërë nga malet dhe 47% janë kodra . Kurse fushat përbejnë 25% , me një amplitudë 300 m mbi nivelin e detit . Amplituda mesatare e vendit është 708 m mbi nivelin e detit , dy herë më e lartë se mesatarja e Europës .

Peisazhi i maleve të Shqipërisë është i mrekullueshëm dhe mbresëlënës , me pyje të dushkut , ahut , pishave , pemëve halorë , rrjedhave të pastra dhe të ftohta ujore . Rajonet më të larta , ku majat ngrihen rreth 2.700 m janë Alpet Shqiptare në Veri dhe më male të pyllëzuara të cilat shtrihen në gjatësinë e vendit dhe në kufijtë Lindorë . Malet janë të populluara në pjesën qendrore me pemë duke vazhduar me kullotat në jug .

Mbi bazat e karakteristikave territoriale dhe strukturave të relievit , katër rajone natyrore janë të dalluara ; Alpet e Shqipërisë së Veriut , Rajonet Malorë Qendrore , Rajoni Malor Jugor , Ultersirat Perëndimore .

Klima

Shqipëria është e vendosur në një zonë me klimë Mesdhetare . Është e karakterizuar nga verë e nxehtë , ditë të shëndritme me diell , përgjithësisht dimer i lageshtë dhe rreshje të bollshme . Periudha nga Qershori në Shtator është e ngrohtë , ndërsa nga Tetori në Maj është e freskët dhe e lageshtë .

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

Rrafshinat bregdetare kanë një klimë Mesdhetare me vere të nxehte dhe të thate, dhe stuhi të shpeshta. Dimri është i butë dhe i lagësht, temperaturat ngriresh janë të rralla. Në male rreshjet e verës janë më të mëdha se në vendet e ulta, temperaturat ditore në male janë të larta ndërsa netet janë shumë më të freskta. Dimri në male mund të jetë i ashpër me rënje të mëdha debore, stuhi dhe shtresa debore që zgjasin për një periudhë të gjatë kohore. Dhjetori, muaji më i lagësht, ka një rënje shiu mesatarisht 211 mm, ndërsa muajt më të thate, Korriku dhe Gushti, kanë vetëm 32 mm shi. Në bregdet rreshjet mesatare vjetore janë 1000 mm, por në male mund të jetë 3000 mm. Kushtet meteorologjike ndryshojnë nga Jugperëndimi në Veriperëndim, temperaturat dhe rreshjet zvogelohen në të njëjtin drejtim. Sasia e shiut dhe e deborës është e mjaftueshme (rreth 1.300mm për vit). Temperatura mesatare vjetore varion nga 14.8⁰ C në 16.5⁰ C ndërsa maksimalja varion nga 38.3⁰ C dhe ulet në afërsi të detit.

Muaji më i nxehte është Korriku me një temperaturë mesatare prej 25⁰ C. Temperatura më e lartë e shënuar e verës është në Kucovë 43.9⁰ C.

Muaji më i ftohtë është Janari me një temperaturë mesatare prej 6⁰ C. Pjesa lindore e Shqipërisë ka dimër shumë të ftohtë. Temperatura më e ulët e regjistruar ka qenë -34⁰ C në Bize, 35 km në Lindje të Tiranës.

Popullsia

Popullsia e Shqipërisë është 3.087.159 banorë; me një densitet prej 113.3 banorë për km katror. Koeficienti i rritjes së popullsisë është 0,9% për vit. Koeficienti i lindjeve është 21.35 lindje për 1000 banorë. Jetëgjatësia është 71.4 vjet (për meshkujt 68.5, për femrat 74.3)

Struktura e Moshës

0-14 vjeç ; 29.53%	Meshkuj 536.495	Femra 500.026
15-64 vjeç; 63.48%	Meshkuj 1.073.351	Femra 1.155.115
64 vjeç e lart 6.99%	Meshkuj 107.476	Femra 138.021

Popullsia e vitit 2001 është marrë nga Regjistrimi i Popullsisë dhe i Banesave, Prill 2001. Përpara 1990 2/3 e popullsisë jetonin në periferi. Sot ky raport ka ndryshuar si rezultat e levizjes së lirë të popullsisë nga periferia drejt qyteteve në vend ose jashtë. Qysh në 1990 Shqipëria vazhdon të ketë emigrim masiv. Greqia dhe Italia janë destinacionet më të shpeshta të emigrantëve. Emigrantët Shqiptarë janë të shpërndarë; Greqia-480.000 emigrantë; Italia-180.000; USA-12.000 Gjermania-11.750; Kanadaja 5.000

Etnikisht, 99% e popullsisë është Shqiptarë, por ka minoritet Grek prej 50.000 vetësh të vendosur në rajonin jugorë të vendit në rrethin e Gjirokastrës, Delvinës, Sarandës. Pas 1990 disa njerez të minoritetit Grek janë vendosur në Greqi. Një minoritet prej 4.000

Maqedonesish janë vendosur afër liqenit të Prespës së Madhe (Korca) në lindje, dhe një numër i vogël Romunësh të vendosur në pjesën Qendrore dhe Juglindore të Shqipërisë. Minoriteti i Malit të Zi është i vendosur në fshatrat e Shkodrës.

Jane rreth 6 milion Shqiptarë që jetojnë jashtë kufijve të Shqipërisë. Jane 2 milion Shqiptarë që jetojnë në Kosovë; në Mal të Zi Shqiptarët përbejnë rreth 6.5%, në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë 32.8% gjithashtu ka koloni Shqiptarë në USA, Argjentine, Bullgari, Kroaci, Egjipt, Greqi dhe Turqi.

Eshtë vënë re një rritje e popullsisë; Tirana mbi 700.000 banorë, Durrësi 95.400 banorë, Shkodra 87.800, Elbasani 83.800, Vlora 73.800, Korca 65.300, Fieri 45.300.

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

Tabela 1 – Te dhenat kryesore rreth vendit

Objekti	Njesia	Cilesia
Gjuha zyrtare		Shqiptare
Forma e Qeverise		Republike Parlamentare
Siperfaqja e Vendit	Km ²	28,748 Km ²
Popullsia ne Total	Numri	3.087.159
Dendesia e popullsisë	Banore per Km ²	106.8 per Km ²
Popullsia Urbane	Numri	1.294.196
Popullsia Rurale	Numri	1.775.09
Mosha Mesatare e Popullsisë	Vitet	33.6
Popullsia ne Moshe (Punesuar)	Numri	1.767.000
Numri I Lindjeve	Per 1000 Banore	21.35
Numri I Vdekjeve	Per 1000 Banore	11.4
Jetegjatesia Mesatare	Vjec	71.4
Jetegjatesia (meshkuj)	Vjec	68.5
Jetegjatesia (femra)	Vjec	74.3
Niveli i Popullsisë (shkrim kendim)		87.8%
Niveli mesatar I arsimimit	vjec	8.8
Papunesia e regjistruar	banore	181.000
Shkalla e Papunesisë		17.4
Papunesia -Femra		56.7%
-Meshkuj		43.9%

INSTAT "Shqiperia ne shifra 2005"

Arsimimi

Arsimimi eshte pare si nje tregues I rendesishem social . Numeri I nxenesve dhe studentave ne popullsisine e pergjithshme ra menjehere pas ndryshimeve politike me 9% kryesisht si rrezultat I emigrimit masiv por u stabilizua ne nivele me te ulta keto vitet e fundit . Mesatarisht nxenesit dhe studentet perbejne 20.7% te popullsisë . Ne zhvillimin hapsinore verehen diferencime te vogla . Ndersa numri I studentave dhe nxenesve ne jug dhe jug – lindje te Shqiperise nuk ka rene nen 25% nga nje mesatare prej 30% (1970) , ne Shqiperine qendrore dhe veriore ka rene nen 20% . Shkaku i kesaj nuk eshte thjesht proporcioni i madh i femijve dhe te rinjve nen 18 vjec por gjithashtu migrimi i brendshem dhe i jashtem nga keto rajone .

Nga 1970 deri ne 2001 kishte nje rritje dhe pastaj nje ulje ne numrin e shkollave vecanerisht shkollat e mesme . Numri I shkollave te mesme ra nga 513 ne 1990 ne 375 ne 2001 .Arsye per kete ishte mbyllja e shume shkollave te cilat gjate periudhes se socializmit ishin te orientuara drejt bujqesisë . Emigracioni , I cili u rrit shpejt qysh ne 1990 , ka ndikuar ne kete renie . Gjate liberalizimit te universiteteve , numri I studentave u rrit nga 6 ne 8 studenta per 1000 banore . Ka universitete ne Shkoder , Elbasan , Korce , Vlore , Gjirokaster ,Tirane . Vetem Tirana ka tre universitete (Universiteti i Tiranës , Universiteti Politeknik ,Universiteti Bujqesor)

Pavarsisht ndryshimeve te perkohshme dhe hapsinore niveli i edukimit vazhdon te kete nje kerkese e madhe per institucione arsimore . Vecanerisht shkolla nevojiten ne Shqiperine qendrore dhe ne Tirane . Te regjistruarit ne Arsimin Publik perbejne 96.7% te te regjistruarve ne Arsim nga 97.6% qe zinin ne vitin shkollor 2002-2003.Braktisja e shkolles nga femijet ne arsimin 8 vjecar eshte ne nivelin 1.2%.

Kalimi I Shqiperise ne Ekonomine e Tregut

Shqipëria e nisi kalimin e saj drejtë ekonomise se tregut nga nje shtuate e veshtire ekonomike . Te gjithë sektoret prodhues pervec bujqesise ishin pothuaj te paralizuar . Ne 1992 inflacioni ishte 226% dhe pothuajse 30% e fuqise puntore ishte e papune . Sipas FMN , GDP-ja e vendit ra me 10% ne 1990 , 28% ne 1991 dhe 7.2% ne 1992 . Pas renies se ekonomise , Shqipëria kishte nje permiresim ekonomik nga 1993 ne 1996. Gjate kesaje periudhe GDP-ja vjetore e vendit kishte nje rritje midis 8.3 – 13.3%. Inflacioni ra nga 22.6% ne 1992 ne 8.0% ne 1995 , por u rrit perseri ne 12.7% ne 1996 . Valuta vendase mbeti stabel kundrejt dollarit Amerikan deri ne 1996 .Papunesia ra nga 22% ne 1993 ne 12.3% ne 1996 .

Zhvillimi I qendrushem ekonomik erdhi ne renie te menjehershme ne fillim te 1997 kur skemat piramidale falimentuan dhe kjo gje coi ne protesta dhe trazira masive pothuajse e coi vendin ne nje anarshi . Pasojat ekonomike ishin te medhaja. GDP-ja ra ne 7% ne 1997 dhe inflacioni u rrit ne 33.2% .

Ne 1998 Qeveria Shqiptare ndermorri nje program me reforma thelbesore ne administrate dhe ne sektorin financiar . Ekonomia u rikthye ne rritje ne 1996 . Te ardhurat nga jashte u rikthyen ne 440 million \$. Rritja e GDP-s u rikthye ne 8% ne vit dhe leku u rivlersua kundrejt dollarit .

Shqipëria arriti te menaxhoje me sukses procesin e privatizimit I cili filloi ne 1991 me privatizimin e ndermarrjeve te vogla . Privatizimi i tokes bujqesore dhe i shtepive u be shpejt dhe ne 1993 , 94% e tokes bujqesore iu shpernda 450.000 fermereve dhe ish qeraxhit e apartamenteve I privatizuan ato ne masen 97% . Mungesa e investitoreve dhe e kursimeve te pakta penguan privatizimin e ndermarrjeve te medha . Procesi masiv I privatizimit nisi ne 1995 me shperndarjen e letrave me vlere por ky proces nuk ishte shume I sukseshem . Megjithate 17 nga 97 ndermarjet e medha u privatizuan pjeserisht . Privatizimi vazhdon akoma ne sektoret e bankave , naftes, gazit dhe telekomunikacionit .

1.1 Struktura Politike e Vendit

Shqipëria eshte Republike Parlamentare me nje Parlament ,Kuvendi Popullor i Shqiperise ne te cilin 140 deputete jane te zgjedhur nga vota e lire per nje mandat 4 vjecar . Ne zgjedhjet e shkuara parlamentare ne 3 Korrik 2005, Partia Demokratike e Shqiperise fitoi 56 vende, ne bashkepunim me koalicionin e partive te vogla fitoi 81 vende ne parlament. Kuvendi Popullor zgjedh Presidentin me shumicen e 2/3 per nje periudhe 5 vjecare me te drejten e rizgjedhjes . Presidenti emeron Kryeministrin per te drejtuar Keshillin e Ministrave (tani me 14 anetare) . Keshilli i Ministrave eshte organi ekzekutiv , propozuar nga Kryeministri dhe aprovuar nga Presidenti . Keshilli duhet te kete nje vote kofidence nga Kuvendi i Shqiperise .

Gjyqesori: Perbehet nga Gjykata Kushtetuese , Gjykata e Larte , Gjykatat e Apeleve dhe Gjykatat e Rretheve .Per here te pare ne historine e Shqiperise nje Gjykate Kushtetuese e cile interpreton Kushtetuten , percakton kushtetutshmerine e ligjeve dhe zgjidh mosmareveshjet midis autoriteteve federale dhe lokale , eshte e perfshire ne sistemin gjyqesor . Gjykatat e tjera jane te ndara ne tre juridiksione ; kriminale , civile , dhe ushtarake . Gjykata e Larte eshte gjykata me e larte e apelit dhe perbehet nga 11 anetar te emeruar nga Kuvendi i Shqiperise .

Shqipëria eshte e ndare ne 12 rajone te cilat jane me tej te ndara ne 165 bashki dhe 309 komuna . Secili rajon ka drejtuesin e saj i cili eshte i zgjedhur nga keshilli i Rajonit .Keshillat e Rajoneve jane te zgjedhura nga listat e partive mbi bazen e perfaqesimit te Proporcionalit .

1.3 Sektoret Industrial dhe Bujqesor

Sektori Bujqesor

Shqipëria kryesisht është një vend bujqesor . Familjet fshatare vazhdojnë të mbizoterojnë mbi ekonominë kombëtare ku bujqësia kontribuon me rreth 33% të GDP-s . Tani rreth 62% e popullsisë është duke jetuar në zonat rurale dhe bujqësia përben mundësinë kryesore të punësimit të këtyre njerzve . Të dhënat zyrtare për punësimin për vitin 1999 tregojnë se fuqia puntore e punësuar në sektorin e bujqësisë përben rreth 60% të forcës puntore në total . Prodhimet e ushqimit vendas plotësojnë rreth 70% të kërkesës totale për ushqim në Shqipëri . Megjithatë , sasia e prodhimeve ushqimore të importuar është akoma shumë e lartë .

Pas shkatërrimit në masë gjatë 1991-1992 , prodhimi bujqesor ka qenë vazhdimisht në rritje (rritja me e madhe me rreth 13% është arritur në 1995) , si rezultat i privatizimit të tokës dhe të pajisjeve bujqësore si edhe industria . Ndermarrjet bujqësore të vogla dhe të mesme tashmë e kanë mbyllur procesin e privatizimit . Janë vetëm 8 ndermarrje të mëdha agro-industriale shtetërore të cilat nuk janë privatizuar teresisht . Tani , rreth 95% e produkteve të industrisë ushqimore dhe peshkimit sigurohen nga sektori privat (1999)

Bujqësia , duke qenë e kushtezuar nga madhësia e vogël e fermave , akoma mbeten të orientuara drejt plotësimin të nevojave për mbijetëse të familjeve të fermerëve . Për këtë , vetëm 20-30% të prodhimit bujqesor dhe blegtoral , janë të destinuara për në treg . Rreth 70% e të ardhurave ekonomike të familjes sigurohet nga blerja e prodhimeve blegtorale .

1.4 Komente Informacione të Tjera mbi Vendin

Rrjeti Rrugor

Një rrjet rrugor prej rreth 18.000 km , përfshi 3.200 km rrugë të asfaltuara dhe 4.600 km rrugë të pa asfaltuara të administruara nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit . Rreth 10.200 km rrugë të nivelit të ulët .

Transporti Hekurudhor

Janë rreth 447 km linjë kryesore hekurudhore dhe 230 km të linjave degezuese . Rrjeti hekurudhor u demtua shumë në fillim të 1990 kur shinat dhe sinjalet vidheshin dhe shiteshin për skrap . Rrjeti hekurudhor i Shqipërisë që lidhet nepermjet Malit të Zi me rrjetin hekurudhor Europian është rihapur kohët e fundit .

Transporti Ajror

Aeroporti kryesor dhe i vetëm i Shqipërisë është aeroporti ” Nënë Tereza ” i lokalizuar në Rinas afër Tiranës . Është rindërtuar pjesërisht nga fonde të dhëna nga NATO , SIEMENS dhe vazhdon zgjerimi i metejshëm .

Portet Kryesore të Vëndit

Porti kryesor është porti i Durrësit ndërsa portet dytesore janë në Vlorë , Sarandë dhe Shëngjin . Sipërfaqja totale e portit të Durrësit është 1.200.000 m katrorë plus 670.000 m katrorë ujë dhe një thellesi që varion nga 7.5 m në 11 m . Kanali hyrës është 9.5 m i thellë , 40 m gjerësi dhe 1.2 milje i gjatë Porti i Sarandës është rikonstruktuar me fondet e BE dhe Italisë . Porti i Shëngjinit nuk është përmirësuar akoma .

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

Turizmi

Turizmi ne Shqiperi eshte ne nje faze te heret zhvillimi . Megjithate Shqiperia paraqet potenciale per zhvillimin e turizmit per shkak te bregdetit te saj mahnite sidomos ne jug te vendit , liqenet e saj dhe rajonet malore .Sipas strategjise se pregatitur nga Banka Europiane per Zhvillim dhe Ndertim , eshte parashikuar qe deri ne 2010 numuri i turistevete te rritet ndjeshem

Zonat Prioritare te Turizmit

Ka dy zona prioritare per zhvillimin e turizmit :

Zona Bregdetare , Kryesisht zona midis Velipojes dhe Karavastase ne veri , midis gjirit te Vlores dhe Llogarase ,dhe brigjet e Jonit ne kufirin Grek ne jug

Zonat e Brendshme , kryesisht liqenet dhe zonat malore

Tabela 1.A : Pasqyra e Prodhimit te brendeshem bruto sipas aktivitetit ekonomik

Nr	Sektori	Kontributi ne GDP	Nr. Punonjesve	Prodhimet me te Medha ne Secilin Sektor
1	Bujqesia, gjuetia dhe pyjet	24.0	755000	Gjedhet 47% TeLashtat 45% Peme frutore 8%,peshkimi detar+brendeshem
2	IndustriaNxjerrrese Perpunuese	12.3	68969	Ind.nxjerrrese,Bakrit,kromit,Ind.lehte ,lekure,detergjent bojra,nxjerrja e perpunimi I naftes,energji ujore

Sipas INSTAT vjetari I ri 2005

Tabela 1.B : Struktura e Sektorit Prodhues Industrial/ Sektorit Bujqesor

Permasat e Ndermarrjeve	Mikro Nderm/Fermat 1 - 4	Te vogla Nderm/Fermat 5 - 9	Te mesme Nderm/Fermat 10 - 20	Total Ndermarrjet/Fermat
Sektori Industrial / Prodhues	4209	7440	1190	6143
Sektori bujqesor dhe agroperpunimi	1793	144	46	38
Total	6002	7584	1236	6181

Sipas INSTAT vjetari I ri2005

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

Tabela 1.C : Prodhimi Bujqesor Sipas Rajoneve

Rajoni	Vlera Totale e Prodhimit milion/leke	Numri I Punonjesve	Permase e Sipefaqes Prodhuese(Ha)
Berat	52	47412	180
Diber	31	36552	250
Durres	18.2	30051	77
Elbasan	69.7	87162	329
Fier	113	97327	189
Gjirokaster	17	18190	288
Korce	63.6	54213	371
Kukes	18.2	16172	237
Lezhe	23.3	32343	162
Shkoder	39.7	44387	356
Tirane	28.6	57283	165
Vlore	24.5	20519	271
Totali	498.8	542152	2875

Vjetari min.bujqesise. 2004

Tabela 1.D : Prodhimi Industrial Sipas Rajoneve

Rajoni	Sektoret e industrise me peshe me te madhe	Vlera Totale e Prodhimit	Numri I Ndermarrjeve Industriale	Numri I Punonjesve
Berat	Ind.lehte,ushqimore,prodhimi baterive	Ska vleresim	366	5008
Diber	Ind.lehte,ushqimore	Ska vleresim	122	3000
Durres	Ind.lehte,ushqimore,perpunim lekure, lende plastike,pesticide	Ska vleresim	817	18694
Elbasan	Ind.cimentos,metalurgjike,bojra	Ska vleresim	424	12787
Fier	Plehrat azotike, TEC, nxjerrje perpunim nafte	Ska vleresim	720	10586
Gjirokaster	Ind.lehte,ushqimore,perpunimlekure	Ska vleresim	243	4825
Korce	Ind.lehte,ushqimore perpunim lekure,lende plastike,pesticide	Ska vleresim	684	11302
Kukes	Ind.lehte,ushqimore,ind.nxjerrrese minerale	Ska vleresim	25	1600
Lezhe	Ind.lehte,ushqimore,peshkimi	Ska vleresim	168	5217
Shkoder	Ind.lehte,ushqimore	Ska vleresim	291	7419
Tirane	Ind.lehte,ushqimore,prodhim detergjent,bojra ,kozmetike,perpunim lekure,shkrirje metalesh me ngjyra Al,Zn	Ska vleresim	1921	122653
Vlore	Hg ndotje	Ska vleresim	529	9911
Totali			6310	213000

INSTAT 2004

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

1.4 Punesimi nga Sektoret Industrial me te Medhenj te Ekonomise

Qellimi i **Tabeles 1.E** eshte te identifikojë rendesine e industrive te ndryshme qe mund te shkaktojne ndotje dhe kane lidhje me menaxhimin e kimikateve

Tabela 1.E Punesimi Industrial nga Sektoret baze te Ekonomise

Kodi ISIC	Pershkrimi	Numri I Ndermarrj.	Punesimi Total	Vlera e Prodhimit (per vit)	Ndikimet ne Mjedis(llojet)
	Industria Ushqimore	1587	7138	27012	Ndotja e ujit
	Tekstilet/Rrobat Prodhimet e Lekures	438	10785	6309	Ndotja e ujit
	Leshi dhe Prodhimet e Leshit	875	3260	6429	Ndotja e ujit dhe e ajrit
	Letra dhe Produktet e Letres	236	2361	4279	Ndotja ajrit ne shtypshkronja
	Kimikate/Qymyr/Nafte Prodhimet Plastike	116	3459	16195	Ndotja ujit siperfaq.e nentokes., ndotja e ajrit
	Produktet e Mineraleve Jo-Metalike	399	3735	13000	Ndotja e ujit nga kimikatet e Trajtimit metaleve
	Industria e Metaleve	648	4822	15112	Ndotja e ujit nga kimikatet e trajtimit metaleve
	Prodhimi i Makinerive dhe Paisjeve	648	4822	15112	Ndotja e ujit nga kimikatet e trajtimit metaleve
	Industri te Tjera Prodhuese	26	763	1854	Ndotja e ujit dhe e ajrit
	Minierat, ind. nxjerrese (Qymyr, Minerale etj.)	215	5865	8977	Ndotja e ujit dhe e ajrit
	Prodhime Elektrike	58	13053	27012	
	Pastrim Kimik	I pa percaktuar	I pa percaktuar	I pa percaktuar	Ndotja e ujit dhe e ajrit
Total			85%		

INSTAT 2004

Kapitulli 2
Prodhimi , Importi , Eksporti dhe Perdorimi i Kimikateve

- 2.1 Prodhimi , Importi , Eksporti dhe Perdorimi i Kimikateve
- 2.2 Perdorimi i Kimikateve Sipas Kategorive
- 2.3 Mbetjet e Rrezikshme

2.1 Prodhimi , Importi , Eksporti dhe Perdorimi i Kimikateve

Kushtet makroekonomike në Shqipëri nga fillimi i reformës në 1990 - 1991 deri në ditët e sotme janë karakterizuar me procese dinamike , të lidhura dhe të shoqëruara me një rënie të konsiderueshme të prodhimit të kimikateve, si dhe të politikave monetare të kufizuara për prodhimin e tyre etj. Rezultatet negative të këtij prodhimi janë si pasoje e ngadalesimit të reformave strukturale të privatizimit dhe kushtet e jashtëme specifike, furnizimi i gati total nga importi nga vende fqinje e nga vende të tjera me ekonomi të zhvilluar, mos korespondimi i importit të vazhdueshëm dhe të ndonjë mundësie për export të lendeve të para ose të gjysem produkteve etj .

Gjendja paraqitet optimiste duke parë reagimin dhe të investitoreve private të cilët duke parë dhe efektivitetin e prodhimit të disa kimikateve dhe për të cilat lëndet e para gjenden në vend po parashikojnë realizimin e disa investimeve me interes ,kjo do të bëjë që vendi ynë të hyjë në fazën tjetër të tranzicionit ekonomik.

Prodhimi industrial është përgjysmuar, dhe rënia me e madhe është në industrinë e prodhimeve kimike, si acid sulfurik nitrik, fosforik, të sodës kaustike, sodës solvej, superfosfatit, pleherave azotike, pesticideve, të prodhimit të naftës e gazit të SiO₂, glicerines, O₂, S, SO₂, CO₂ etj. Rënia e ndjeshme në prodhimin e makinerive dhe industrinë e perpunimit të metaleve , në perpunimin e drurit dhe metalurgjisë la trashëgim shumë kimikate të pa përdorura që sot kanë krijuar probleme për ambientin

Megjithatë gjatë këtyre viteve një pjesë e kësaj industrie filloj të riaktivizohet si nëpërmjet privatizimit të objekteve të industrisë lehtë, asaj të drurit, kimike mekanike, të disa sektoreve minerare në kariera (gurorë) ashtu dhe nëpërmjet dhënies me qera me afat të gjatë apo me koncesion të disa minierave të kromit , bakrit, qymyreve, të disa uzinave të prodhimit celikeve, Ferr-kromit etj.

Rimekembje kanë marrë këto kohët e fundit dhe industria plastike, prodhimi detergjenteve, prodhimi i bojërave , sfugjerit polisterolit, vajrave lubrifikante etj.

Informacionet e mbledhur nga firmat , prodhuesit , konsumatorët e substancave kimike për sasitë e prodhimit , importit dhe eksportit të substancave kimike në periudhën e përgatitjes së Profilit Kombëtar janë siguruar nëpërmjet Institutit të Statistikave, Drejtorisë Doganave, Drejtorisë në Ministrinë e Linjës , prodhuesve privat.

Në tabelën 2A janë disa të dhëna statistikore të marra nga drejtoria e doganës dhe nga ministria e Bujqësisë e cila regjistron dhe jep lejet për importin e pesticideve. Në totalin e kimikateve që hyjnë në Shqipëri , me sistemin e informacionit që kemi , nuk ishte e mundur ndarja në kimikate konsumi, inorganike apo organike gjë që na del si detyrë për të ardhmen që të përshtasim e përpunojmë të dhënat që disponojmë në mënyrë të tillë që të jenë të vlefshme për tu përdorur në çdo koment të gjendjes e persosjes së menaxhimit të kimikateve .

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

Tabela 2A – Prodhimet kimike dhe importi

Lloji i kimikatit	Prodhimi (Ton)	Konsumi (Ton)	Importi (Ton)	Eksporti (Ton)
Pesticidet (bujqesore ,perdorim konsumi dhe shendetit publik)	=	198	198	=
Plehera kimike	=	73525	73525	=
Prodhim-perpunim Naftë	314 000	1062 000		=
Kimikatet Organike	=	-		=
Kimikatet Inorganike	=	-		
Kimikate per mallra Konsumi	=	-		=
Kimikate te tjera	=	-		=
Totali			97011	=

Doganat shqiptare 2005

Informacioni ne Tabelen 2A mund te na ndihmoje ne ngritjen dhe mbajtjen e evidencave baze per menaxhimin e kimikateve ne vend .

LISTA E KIMIKATEVE (ne total) QE HYJNE NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE SIPAS SHTETEVE

Ne Shqiperi veprojne 294 importues legal te kimikateve qe importojne nje total prej 97 011 Ton nga 26 shtete te ndryshme te ndara si me poshte.Jan te evidentuara llojet e kimikateve qe importohen por eshte e pamundur ndarja ne kimikate konsumi,organike dhe inorganike.Me persosjen e sistemit te informacionit,do te behet ndarja dhe evidentimi i plote i llojev te kimikateve pa permendur importuesit per efekt te mbrojtjes se biznesit.

Tabela 2A/1

Viti 2005

Nr	Shtetet	Ton
1	GREQIA	11025
2	ITALA	4484
3	TURQIA	13190
4	RUMANIA	8818
5	BULLGARIA	2491
6	ANGLIA	6000
7	SLLOVENIA	177
8	KINA	216
9	GJERMANI	70
10	MAQEDONI	5564
11	AUSTRI	7
12	EGJYPT	2500
13	IRLANDE	9.1
14	KROACI	30
15	HOLLAND	14
16	URUGUAJ	23632
17	JUGOSLLAVI	160
18	SINGAPOR	40
19	DANIMARKE	0.15
20	UKRAINE	364
21	TURKMENISTAN	610
22	RUSI	17475
23	HUNGARI	38
24	USA	1.8
25	SPANJE	4.1
26	FRANCE	0.88
27	Te TJERA	90
	Totali	97 011

Doganat shqiptare 2005

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

Me poshte po japim listen e PMB-ve te regjistruara qe hyjne ne Shqiperi,liste e cila rishikohet here-pas here kur ka ndryshime dhe ndalime te komponenteve te vecane .Ministria e Bujqsise Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit ka drejtori dhe specialiste te vecante qe ndjekin me kujdes problemin ne fjale.

LISTA E PRODUKTEVE PER MBROJTJEN E BIMEVE TE REGJISTRUARA PER T'U IMPORTUAR DHE TREGTUAR NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE ME VENDIM TE KOMISIONIT SHTETEROR TE REGJISTRIMIT TE PMB-ve

Plan Protection Products Registered in Albania

Monday, February 27, 2006

LISTA E PMB-ve TE REGJISTRUARA NE SHQIPERI

Tabela 2A/2

Nr	EMRI TREGTAR	EMRI I LENDES	KLASIFIKIMI	APLIKUESI	NR . AKTIVE	Data e Regjistrimit
1	ABALONE 18 EC	Abamectine	Insekticid-Acaricid	Chimac-Agriphar	Perkoh. 42	01/02/2006
2	ABAMEX 1.8 EC	Abamectine	Insekticid-Acaricid	VAPCO	Perkoh. 165	05/25/2005
3	ACARIDOIL 13 SL	Kripe kaliumi	Insekticid	VIORYL S.A	Perkoh. 30	05/25/2005
4	ACROBAT	Dimetomorph	Fungicid	BASF	Perkoh. 168	12/26/2005
5	ACROBLU 12/60	Dimetomorph+OH Cu	Fungicid	Shinchem Co.L.t.d	Perkoh. 190	12/24/2000
6	ACTARA 25 WG	Thiamethoxam	Insekticid	Syngenta	I plote 164/1	05/25/2005
7	ADIFON	Triadimefon	Fungicid	VAPCO	Perkoh. 6	05/24/2005
8	AGRINATE 90	Methomyl	Insekticid	VAPCO	Perkoh. 170	04/23/2003
9	AGROPSIN 70 WG	Thiophanate methyl	Fungicid	Ypsilon S.A	Perkoh. 41	01/02/2006
10	AGROPSIN 70 WG	Pirimiphos Metil	Fungicid	Ypsilon S.A	Perkoh. 5/1	05/24/2004
11	AKTELLIC 50 EC	Pirimiphos Metil	Insekticid	Syngenta	Perkoh. 5/1	05/24/2004
12	ALLIETTE FLASH	Fosetil aluminium	Fungicid	BAYER AG	Perkoh. 65	04/03/2004
13	AL PHOSPHIDE	AlPhosphide	Insek Fumigan	Shenyan Pesticides	I plote 148	02/05/2000
14	ANTRACOL 70	WPPropineb	Fungicid	BAYER AG	I plote 73	05/08/1997
15	ANVIL 5 SC	Hexaconazole	Fungicid	Syngenta	Perkoh. 3/1	05/24/2004
16	APACHE 20 SP	Acetamiprid	Insekticid	Shinchem Co. L.t.d	I plote 169	12/26/2004
17	ARAGOL L 40	Dimethoat	Insektici	SIPCAM	Perkoh. 16/1	05/25/2005
18	AS 50	Carbaryl	Insekticid	SIPCAM	I plote 125	03/21/2000
19	ASCO 30	Cymoxanil	Fungicid	AGRIMIX	I plote 101	11/25/2000
20	B - PLUS 50 WDG	Carbendazim	Fungicid	Nanjing Essence Chemical Co. Ltd	Perkoh. 48	01/02/2006
21	BAKRENI	Propineb+ Oxiklorur Cu	Fungicid	BAYER AG	I plote 43	01/02/2006
22	ANTRACOL WP63 BASAGRAN	Bentazone	Herbicid	BASF	I plote 52	10/28/1996
23	BASAMID	Dazomet	Nematocid	BASF	I plote 53	10/28/1996
24	BAVISTINE DF	Carbendazim	Fungicid	BASF	I plote 59	05/08/1997
25	BAYLETON 25 WP	Triadimefon	Fungicid	BAYER AG	I plote 72	05/08/1997
26	BAYTAN	Triadimenol+	Fungicid Dizifekt	BAYER AG	I plote 94	10/07/1998
	UNIVERSAL	Fuberidazole				
27	Bi - 58	Dimethoat	Insekticid	BASF	I plote 54	10/28/1996
28	BIOLIDE E	Vaj mineral	Insekticid	SIPCAM	I plote 126	03/21/2000
29	BOTRILAN 500 SC	Iprodione	Fungicid	Chimac-Agriphar	Perkoh.205	10/28/2004
30	BRAVO 500 SC	Chlorthalonil	Fungicid	Syngenta	Perkoh.154	12/24/2003
31	BRODY (WAX BLOCK)	Bradifacoum	Rodenticid	AZF	Perkoh. 44	01/02/2006
				AGRICOLTURA Srl		
32	BULLDOCK 025 EC	Beta - cyfluthrin	Insekticid	BAYER AG	I plote 75	05/08/1997
33	CABRIO TOP	Metiram+Pyraclostrobin	Fungicid	BASF	Perkoh. 40	01/02/2006
34	CALIPSO SC 480	Thiacloprid	Insekticid	BAYER AG	I plote 197	12/24/2003
35	CALLISTO 48 SC	Mesotrione	Herbicid	Syngenta	Perkoh. 156/1	05/24/2004
36	CALTAN SC	furace+ Folpet	Fungicid	BAYER AG	I plote 102	11/25/1999
37	CANVIL	Hexaconazole	Fungicid	VAPCO	Perkoh. 171	04/23/2003
38	CAPTAN 80 WG	Captan	Fungicid	Arvesta Corpor	Perkoh. 32/2	01/02/2006
39	CHAMP FORMULA 2	Hidroxid Cu	Fungicid	Hellas	I plote 140	12/26/2000
40	CHAMPION 50 DF	Hidroxid Cu	Fungicid	AGRIMIX	I plote 123	02/16/2000

Min.Bujqesise 2006

Vazhdon lista e plote ne www.albchemicals.com.al

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

2.2 Perdorimi i kimikateve sipas kategorive

Perdorimi i pesticideve Problemet ne prodhimin bujqesor kan reflektuar negativisht ne prodhimin vendas , por importi i pesticideve ka pasur nje rritje te ndjeshme gjate 3 viteve te fundit . Tregu i pesticideve dhe bazat e reja normative kane reflektuar pozitivisht ne menaxhimin e pesticideve . Cmimi i larte i ka limituar ato ne perdorim dhe nga ana tjetere importi dhe prodhimi vendas jane kufizuar ne lloje sipas direktivave Europiane dhe eksperiencat ne vendet e BE-se .Jan marre pesticide me efektivitet te larte dhe eshte ndaluar importimi i atyre qe kan rekomanduar direktivat europiane .Por megjithate eshte e nevojshme dhe e domosdoshme harmonizimi i legjislacionit Shqiptar. Direktivat 67 , 88 , 91 , 93 . dhe zhvillimet e fundit ne legjislacionin European ne kete fushe duhet te ndiqen me kujdes , vecanerisht ne lidhje me pesticidet . Tabela 2B-1 paraqet pesticidet e perdorura ne 3 vitet e fundit .

Tabela 2B-1 . Pesticidet e perdorura ne Ton .

	Ton		
Viti	Herbicide	Insekticide	Fungicide
2001	14	16	15
2002	75	60	58
2003	27	70	125
Total	116	136	198

Insekticidet e perdorura nga konsumatorët per qellime familjare,per momentin nuk jane te evidentuara por nje komision i posacem qe eshte ne drejtorine e higjenes te ministrise se shendetesise jep lejet dhe kontrollon importin e tyre

Importi i Plehrave Kimike ne Shqiperi behet nga shume vende te botes dhe deri tani evidentohet 73.525 Ton te ndara sipas tabelës 2B/2

Tabela 2B/2

Nr	Plehra kimike gjithsej	73.525 Ton
1	Plehra azotike	44.249 Ton
2	DAP (Diamon Phosphat)	17.000 Ton
3	Superfosfat	10.200 Ton
4	Plehra komplekse	2.176 Ton
5	N , P, K + mikroelement	-----

Min.Bujqesise 2006 Vazhdon lista e plote ne www.albchemicals.com.al

Deri tani jane perfunduar 5 cikle te kontrollit te prodhimit agrokimik . Analizat agrokimike behen vetem atehere kur prodhuesi deshiron pasi paguan shpenzimet per analizat dhe rekomandimet per pleheruesit .

Por ka nje renie te numrit te testeve te analizave per shkak te mungeses se koordinimit ne sistemin e Ministrise se Bujqesise , ku nga PHARE-PROGRAME jane bere analiza pa pagese . Nuk ka nje metodologji te percaktuar te marrjes se testit , te metodes , te analizës dhe te perdorimit te plehrave te rekomanduar .

Numri i kufizuar berjes se testit te analizave nuk na e ben te mundur te nxjerrim konkluzione te pergjithshme ne shkalle kombetare , por qarteson se ka tendenca te vazhdueshme negative .

2.2 Mbetjet Industriale dhe te Rrezikshme

Ne vitin 1990 industria kontribuonte me me shume se 37% te GDP-s : kjo pjese ra ne vitin 1999 rreth 12% Sektorët kryesore te industrise ishin , metalurgjia, rafinimi i naftes dhe prodhimet kimike . Shqiperia eshte e pasur me burime minerale . Sipas Studimeve Gjeologjike rezervat potenciale burimore te mineraleve jane:(ne milion tone) : krom 5 : baker 45-50 : nikel 500 : qymyr 350 . Aktivitetet industriale ne te shkuaren dhe te tanishme jane te bazuara mbi perdorimin e burimeve natyrale si lende e pare . Gjate viteve te fundit prodhimi industrial i shume produkteve te medhaja ra ne 50-70% , disa produkte nuk prodhohen me . . Keto produkte perfshijne te gjitha koncentratet metalurgjike , nikelin , prodhimet kimike te cilat gjeneruan mbetje industriale te rrezikshmete mbetura fushave ose ne impiantet e ndaluara nga puna. Arsyet kryesore per kete jane ndryshimet e kushteve sociale dhe ekonomike . Prodhimet industriale tani konsistojne ne minierat dhe pasurimi i mineraleve te bakrit dhe kromit , qymyrit , perpunimi i naftes dhe materialeve te ndertimit keshtu qe shumica e mbetjeve industriale formohet nga keto industri . Per ndermarrjet industriale te cilat jane mbyllur , problemi kryesor mjedisor eshte akumulimi i mbetjeve nga operacionet e meparshme . Ne vitin 2000 sasite me te larta te mbetjeve industriale te rrezikshme u formuan ne industrine e kromit dhe te bakrit . Sasite e mbetjeve te akumuluar nga minierat dhe pasurimi i mineraleve jane dhene ne tabelen e meposhtme :

Volumi i Mbetjeve te Ngurta Industriale te Akumuluar ne Vitin 2000

Industria Minerare	Milion m ³
Qymyri	3.0
Nxjerrja e hekur nikelit	4.2
Nxjerrja e bakrit	12.0
Nxjerrja e kromit	18.8
Industria pasuruese	
Pasurimi i mineralit te bakrit	11.8
Pasurimi i mineralit te kromit	2.5

Burimi : Ministria e Ekonomise Publike dhe Privatizimit , 2000

Formimi i Mbetjeve Industriale

Rreth 18.8 milion m³ te mbetjeve te ngurta nga nxjerrja e mineraleve te kromit dhe rreth 2.5 milion m³ nga pasurimi i tyre jane te grumbulluara nga industria e bakrit,ato permbajne 0.2% baker , 10% sulfur , si edhe zink , metale te tjera te renda dhe materiale inerte (perberja ekzakte nuk eshte e disponueshme) . Pothuajse e gjithe nxjerrja e mineralit te bakrit dhe pasurimi i tije nuk vazhdon me , por ujrat siperfaqesor dhe ato nentokesor vazhdojne te jene te kontaminuara nga bakri dhe metale te tjera te renda nga mbetjet industriale ne vendet e grumbullimit

Problemet mbi menaxhimin e mbetjeve eshte nje nga prioritetet ne politikat tona ekologjike. Disa nga problemet , ne lidhje me menaxhimin e mbetjeve , kane zgjidhjen e tyre me adoptimin e ligjit per "Trajtimin Mjedisor te mbetjeve te ngurtra" Nr 9010 dt.13/02/2003 dhe te ligjit Nr 9108 dt.17/7/2003 Mbi substancat dhe preparatet kimike"

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

Volümet e prodhimeve të mbetjeve kryesore industriale .Viti 2001

Ton

Industria Nxjerrese	Ton
Nafte	77.755
Gaz natyral	2.357
Linjit	507
Lende të para jo energjitike	
Minerali i kromit	10.324
Minerali kromit (42%)	----
Industria prodhuese	
Benzen	3.620
Vajrat lubrifikuese	-----
Koks nafte	4.771
Ferrokrom karbonik	-----

Tabela 2C- Gjendja e Mbetjeve të Rrezikshme dhe Tregetimi

Kodi	Emri i Prodhimit të Mbetjes	Prodhimi Ton/Vit	Eksporti (Ton/Vit)
	Mbetjet e produkteve të marra nga proceset kimike dhe sinteza	S'ka të dhena	S'ka
	Mbetjet e produkteve me origjinë minerale dhe të produkteve të procesit	S'ka të dhena	S'ka
	Mbetjet e produkteve të bimëve dhe ato me origjinë shtazore dhe produktet e procesit të tyre	S'ka të dhena	S'ka
	Mbetjet e produkteve të pastrimit të paisjeve , produktet e mbetjeve të rrezikshme spitalore dhe të përdorimit të përditshëm	S'ka të dhena	S'ka

Kapitulli 3

Ndikimet potenciale ne mjedis Lidhur me Prodhimin , Importin , Eksportin dhe Perdorimin e Kimikateve

- 3.1 Problemet Prioritare ne lidhje me Importin , Prodhimin dhe Perdorimin e Kimikateve
- 3.2 Komente dhe Analiza

3.1 Problemet Prioritare ne lidhje me Importin , Prodhimin dhe Perdorimin e Kimikateve

Industria kimike Shqiptare ne kete periudhe tranzicioni ka pesuar nje renie te ndjeshme . Prodhimi i pesticideve , plehrave kimike , te sodes , acidit sulfurik , glicerines etj , te cilat kishin prioritet te vecante ne te kaluaren sepse duhej mbajtur bujqesia dhe industria me lende te pare per nevojat e vendit tashme nuk egzistojne me .

Sot vendi yne ka te zhvilluar industrine e cimentos , pjesisht metalurgjine , industrine e mallrave te konsumit te gjere te cilat kane nevojte per lende te pare e ndihmuese kimike te cilat kryesisht importohen e ne pak raste prodhohen dhe kerkohet treg per eksport si O_2 , N_2 Si pasoje e ketij zhvillimi industrial e bujqesor te arritur Shqiperia importon pesticidet , plehra kimike , kimikate te llojeve te ndryshme per detergjentet , vajrat lubrifikante , pastrimin kimik ndertimin etj , impakti mjedisor i te cilave eshte i lidhur ngushte me perpunimin , ruajtjen dhe transportin e tyre . Disa nga problematikat qe ato krijojne jane:

Ndotja e ajrit

Ndotja e ajrit si pasoje e emisioneve nga djegjet e karburanteve , transportit automobilistik , ndertimeve te pakontrolluara eshte bere problematike ne zonat kryesisht industriale , te industrise se cimentos , metalurgjise , rafinerite e naftes , rrjeti i transportit automobilistik etj . Ndotsit kryesore te krijuar jane PM_{10} dhe $PM_{2.5}$ te krijuara nga industria e cimentos dhe ndertimet e shumta ne te gjithë vendin ; i NO_x te krijuara nga rafinimi i naftes apo transporti automobilistik ; i SO_x e CO_2 te krijuara nga Termocentralet , gjeneratoret e rrymes , lenda e amonjakut e cliruar nga procese te industrise ushqimore , fenole te cliruar nga industria metalurgjike , rafinerite etj . Faktor i rendesishem qe duhet marre ne konsiderate jane aksidentet industriale te cilat ndotin ajrin ne forma te caktuara , zjarret ne industrine e naftes , djegia e puseve te naftes ose perdorimi pa kriter i pesticideve ne bujqesi .

Monitorimi i Cilesise se Ajrit

Detyrimi ligjor per te monitoruar cilesine e ajrit rrjedh nga Ligjet mbi Mbrojtjen Mjedisore dhe mbi Inspektoriatin Shteteror te Shendetit . Eshte e rendesishme te theksojme se rregullat dhe rregulloret per forcimin e ketyre dy ligjeve jane te pa plotesuara : ato nuk parashtrojne ne menyre te qarte definicionet dhe nuk japin detyrat dhe pergjegjсите e institucioneve te ndryshme . Kjo ka cuar drejt keqkuptimit dhe keqinterpretimit te vazhdueshem , i cili ka ndikuar ne proces. Instituti i Shendetit Publik operon kontrollin kryesor te ndotjes se ajrit ne Tirane . Laboratori nisi funksionimin ne vitin 1997 dhe eshte i pajisur me instrumenta moderne. Gjithashtu ky Institut monitoron cilesine e ajrit ne qytetet e Tiranes , Korces , Duresit , Elbasanit , Shkodres, Fierit dhe

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

Vlores . Per arsye te kufizimit te burimeve teknike dhe financiare monitorimi i ajrit mesatarisht behet 5 dite ne muaj per secilin qytet . Kjo ben nje total jo me shume se 60 dite ne vit ne cdo qytet e cila rezulton ne nje te dhene mesatare rreth 16% . Kjo eshte shume poshte nga minimumi prej 247 ditesh ne vit qe rekomandon Organizata Boterore e Shendetesise . Monitorimi pasiv eshte perdorur vetem per monitorimin e O₃ dhe disa matje paralele te NO₂ . Gjithashtu , I.Sh.P ka nje stacioni automatik monitorimi per cilesine e ajrit qe nga viti 1996. Ky stacion ndodhet ne Tirane dhe mat pa nderprerje dinamiken e ndotesve te O₃, SO₂, CO dhe NO_x. Programi i monitorimit automatik u nderpre ne 1999 per mungese te pjeseve te riparimit dhe te sherbim-kalibrimit . Laboratori i ndotjes se ajrit ne I.Sh.P eshte duke planifikuar te rinise monitorimin automatik sipas programit CARDS. Ne situaten e rritjes se trafikut urban , shpeshtesia e regjistrimit eshte e pamjaftueshme . Nderkohe qe perqendrimet e PM₁₀ pergjithsisht regjistrohen 4-5 here ne muaj , per te pasur te dhena te mjaftueshme interpretimi kerkohet nje vezhgam prej te pakten 247 ditesh ne vit.

Monitorimi i ujrave

Nje dekret i Keshillit te Ministrave mbi Monitorimet ne Republiken e Shqiperise ne menyre qe te ndaje dhe qartesoje detyrat e instituteve te ndryshme dhe te shmangte boshlleqet dhe duplikimet kushtezon se kush duhet te monitoroje tregues te vecante. Ne vitin 2001 Ministria e Mjedisit e cila eshte pergjegjese per monitorimin e ambientit subkontrakti monitorimin e ujit me disa Institucione te specializuara te vendit.

Ujrat tokesore . Per afro gjysem shekulli Inspektimi Gjeologjik Shqiptar ka monitoruar ujrat tokesore , vecanerisht per sasine , cilesine dhe levizjen e ujrave . I.Gj.Sh ka ndermarre edhe studime hidrologjike per ujrat tokesore . Me ligj , Inspektimi duhet te mbroje akuiferet por informacioni mbi sasine e ujit prej akuifereve nuk i raportohet. I.Gj.Sh thekson se perdorimi i vazhdueshem i ujrave tokesore eshte i paqendrueshem per shkak se eshte shume intensiv ne disa akuifere dhe ne disa zona .

Ujrat siperfaqesore . Monitorimi i lumenjeve i eshte subkontraktuar nga Ministria e Mjedisit me Institutin e Hidrometeorologjise . Sipas Raporteve Mjedisore te ketij Instituti ujrat siperfaqesore jane te kategorise se pare per nga cilesia , por gjithashtu raporti tregon se stacionet e monitorimit jane lokalizuar larg nga burimet e ndotjes . Monitorimi i ujrave siperfaqesore eshte ulur shume . Shumica e 150 stacioneve nuk funksionojne me sepse ato nuk kane staf te mjaftueshem , paisje per mostrat dhe analizat ose makina .Sot vetem Dy seri rezultatesh i jepen Ministrise se Mjedisit per cdo vit .

Uji i pijshem. Uji i pijshem dhe ai i bregdetit monitorohet nga Ministria e Shendetesise e subkontraktuar nga Ministria e Mjedisit . Rreth 15 parametra monitorohen , perfshi standardet globale te fiziko-kimise dhe bakterieve . Pesticidet rralle monitorohen ndersa hidrokarburet nuk monitorohen .Monitorimi i zonave te plazhit ne bregdet gjate sezonit turistik behet vetem ne menyre te crregullt .

Prodhimi i mbetjeve industriale

Prodhimi industrial konsiston ne minierat dhe pasurite e mineraleve te bakrit dhe kromit , qymyrit , nxjerrjen e naftes dhe perpunimin e saj dhe materialeve ndertuese , keshtu qe mbetjet industriale qe prodhohen nga keto industri ndotin ambientet perreth . Per ndermarrjet industriale qe jane mbyllur , problemi kryesor mjedisor eshte akumulimi i mbetjeve nga operacionet e meparshme . Ne vitin 2000 sasia me e madhe e mbetjeve te rrezikshme industriale u prodhuan ne industrite e bakrit dhe kromit .

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

Tabela e sasise se mbetjeve te ngurta industriale te akumuluar ne vitin 2000

Industria e Minerave	Milion m³
Minierat e qymyrit	3.0
Nxjerrja e hekur nikelit	4.2
Nxjerrja e bakrit	12.0
Nxjerrja e kromit	18.8
Industria e pasurive minerale	
Minerali i bakrit	11.8
Minerali kromit	2.5

Rreth 18.8 milion m³ mbetjesh te ngurta nga minierat minerali i kromit dhe rreth 2.5 milion m³ nga nxjerrja e tyre jane depozituar . Keto mbetje permbajne krom 6 valent i cili eshte shume toksik dhe nje rrezik per njerezit dhe mjedisin . Mbetjet nga industria e bakrit permbajne 0.2% baker , 10% sulfur dhe zink , Afersisht te gjithë minierat e bakrit kane qene te pezulluara , por ujrart siperfaqesore dhe ato tokesore jane akoma te kontaminuara nga bakri dhe metale te renda te mbetjeve industriale . Pergjegjesia per kontaminimin industrial te meparshem eshte nje ceshtje e rendesishme ne pastrimin e zonave te ndotura .Nuk ka nje legjislacion specifik per pergjegjesine per ndotjen industriale te meparshme dhe nuk eshte e qarte se kush duhet te paguaj . Gjate privatizimit bleresi mund te diskutoje me Ministrine e Mjedisit dhe Ministrine eEkonomise Tregetise dhe Energjitikes se kush duhet te paguaj per rinatyrimin e zones se ndotur .

Ne vitin 2005 ministria e Energjitikes dhe Industrise perpiloi nje inventar te mbetjeve te rrezikshme ne 36 ndermarrje , 40 kompani tregtie dhe 22 ndermarrje te sherbimit publik duke informuar per gjendjen si me poshte:

Sasia e substancave te rrezikshme te grumbulluara sipas kategorise

Kimikatet	Sasia ne ton
Shume toksike	40
Toksike	575
Ekstremisht te djegshme	110
Oksidiuese	330
Te demshme per shendetin	300
Irrituese	12
Te tjera	164
Totali	1.531

Ne vitin 2000 sasia e substancave te rrezikshme te akumuluar ne ndermarrjet industriale ishte ne totalin e 3.105 ton prej te cilave 2.115 ton jane magazinuar si kimikate te paperdorshme dhe 990 ton mund te perdoren si lende e pare . Shume substanca te rrezikshme u prodhuan nga industria kimike (1531ton) burime te tjera ishin industria e naftes (706 ton) dhe industria e lehte (501 ton) . Nuk ka masa praktike per te parandaluar prodhimin e mbetjeve industriale qe ne burim ose per ti ricikluar . Te gjitha mbetjet industriale jane te magazinuar ne vende te pakontrolluara .

Sipas ish Ministrit te Industrise dhe Energjitikes rreth 1000 ton pesticide te paperdorshme jane asgjësuar . Ato ishin magazinuar ne kushte te papelqyeshme mjedisore dhe paraqesinin rrezik per popullsinë dhe mjedisin . Mbetjet e rrezikshme industriale jane magazinuar ne zona te braktisura

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

industriale ose se bashku me mbetjet e qytetit . Nuk ka statistika se sa mbetje te rrezikshme jane akumuluar ose prodhuar ne kete kohe

Tabela 3.A : Pershkrimi i Zonave Problematike

Natyra e Problemit	Qyteti/Rajoni	Pershkrim i Prob.	Kimikatet/Ndotesi
Ndotja e ajrit	Tirane,Durres,	Transp.Automobili. Ndertimet, Industrite	NO _x ,SO _x ,CO ₂ ,PM ₁₀
	Fier,Marins ,Ballsh,Patos	Ndotja nga hidrkarburet, Ind. E plehrave azotike	SO ₂ , CO ₂ , As ,
	Elbasan	Fab.Cimentos,Metalurgji	PM ₁₀ ,SO ₂ .CO ₂ ,NO _x
Ndotja e tokes , ujit	Vlora,	Ndotja nga zhiva	
	Lac	Industria e plehrave fosforike dhe ac.sulfurik	V ₂ O ₅
	Durresi	Ndotja nga kromatet dhe pesticide, perpunimi i lekurave	Cr , pesticide
	Rubik	Ind.bakrit dhe pasurimit te mineraleve	Bari, mikroelemente

Tabela 3.B : Shqetesimet Prioritare ne lidhje me Kimikatet

Natyra e Problemit	Shkalla e Problemit	Niveli i Shqetsimit	Mundesia kontrollit te prob.	Disponim i te dhenave statistikor	Kimikate te vecanta qe shkaktojn probleme	Prioriteti
Ndot.Ajrit	Kombetar	Larte	Mesatar	I Pamjaftu eshem	PM ₁₀ ,PM _{2.5} SO ₂ .CO ₂ , NO _x	Levizja e kontrolluar makinave Ndertimet me kriter
Ndotja e Lumenjve	Kombetar	Larte	Mesatar		NH ₃ ,NO ₂ ,NO ₃ ,P, COD,BOD ₅	Kontrrolli I shkarkimeve ne lumenj vendosja e impianteve te pastrimit
Ndotja ujrave tokesore	Kombetar	Larte	Mesatar		Shkarkimet urbane	Kontrrolli I shkarkimeve, vendosja e impianteve te pastrimit
Ndotja e tokes	Kombetar	Larte	Mesatar		Industria , ndertimi	Kontrrolli I shkarkimeve, vendosja e impianteve pastrimit
Ndotja nga Mbetjet kimike ne ushqime	Kombetar	Larte	Mesatar		Metalet e renda Pesticidet	Kontrrolli I perdorimit te pesticideve dhe teknologjive

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

Ndotja e ujit te pijshem	Kombetar	Larte	Mesatar		Ngarkesat mikrobike , mbetjet e metaleve te renda	Kontrrolli I shkarkimeve, vendosja e impianteve te pastrimit
Trajtimi i mbetjeve te rrezikshe	Kombetar	Larte	Mesatar		As , zhiva , Cr ⁺⁶	Kontrrolli i ndermarrjeve prodhuese,ndertimi i land-fillit
Shendeti profes.i.Bujqes	Kombetar	Larte	Mesatar		Pesticidet , pleheruesit, agro-kimikatet	Perdorimi I kujdesshem I pesticideve.mbrojtja ne pune informimi fermereve
Shendeti professional ne industri	Kombetar	Larte	Mesatar		Metalet e renda , perberesit organik	Perdorimi I kujdesshem I kimikateve mbrojtja ne pune informimipunetoreve
Shendeti publik	Kombetar	Larte	Mesatar		Metalet e renda Pesticidet	informimi I publikut
Aksidentet kimike. Industriale	Kombetar	Larte	Mesatar		SO ₂ .CO ₂ ,NO _x , gazrat toksike ,prodhimet naftes	Kujdesi ne pune,kontrroll dhe kushte pune te pershtateshm
Aksidentet kimike Transport	Kombetar	Larte	Mesatar		Pesticidet,gazrat toksike ac.org.inorg	kushte te pershtateshme trasporti informim,trajnim
Importi i kimikateve te panjohura	Kombetar	Larte	Mesatar		Industriale, bujqesore,radioak te	Kontrroll rigoroz ne dogana, persosja sistemit informimit
Magazinimi i kimikatev te paperdorshme	Kombetar	Larte	Mesatar		Pesticidet,kimikat et industriale mbetjet prodhimet e naftes ,	Rritja e pergjegjesise nga ministrite e linjes,permiresimi I sistemit te informacionit
Helmet kimike	Kombetar	Larte	Mesatar		Ilacet ,pesticidet	Rritja e pergjegjesise nga ministrite e linjes,permiresimi I sistemit te inform. Koordinimi me Min.shendetesise,industries,bujqesise,dog anat
Ndotsit organik	Kombetar	Larte	Mesatar		Pesticidet,sustanc. organike industrial	Rritja e pergjegjesise nga ministrite e linjes,permiresimi I sistemit te informacionit. Koordinimi me Min.shendetesise,industries,bujqesise,dog anat

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

Komente

- Qellimi dhe objektivat e punës së Institucioneve përgjegjëse për menaxhimin e kimikateve, të ndotjeve dhe të uljes së rrezikut që vjen nga to, janë prioritet të qeverisë shqiptare dhe ato qendrojnë në :
 - Zhvillimin e një strategjie për të menaxhuar zonat industriale të braktisura duke përfshirë edhe një vlerësim të riskut të shëndetit dhe mjedisit i ekspozuar në këto zona, identifikimi masiv dhe prioritetëve për rehabilitimin e tyre dhe hartimi i një plani për kontrollin, eliminimin dhe monitorimin e ndotësve në zonat e kontaminuara .
 - Zhvillimin e një programi për mbylljen e sigurt të grumbullimit të mbetjeve urbane dhe industriale që ndotin mjedisin dhe rrezikojnë shëndetin e njeriut .
- Zhvillimin e një strategjie dhe plani veprues për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme, industriale dhe spitalore, duke përfshirë berjen e një inventari të mbetjeve të rrezikshme, vlerësimin e riskut të shëndetit njerzor dhe mjedisor, monitorimin e këtyre mbetjeve si edhe përmirësimi i kuadrit ligjor dhe institucional .
- Përkrahjen e prodhimit të pastër duke përfshirë dhe krijimin e një qendre për teknologjitë e pastra
- Ngritja e zyrës së Regjistrimit të menaxhimit të kimikateve
- *Përgatitja e një grupi të komunikimit kombëtar për menaxhimin e kimikateve dhe zbatimin e strategjive nderkombëtare për menaxhimin e kimikateve (SAICM)*
- Përgatitja e një programi për komunikimin kombëtar për menaxhimin e mbetjeve në mënyrë që të përmirësojmë informacionin mjedisor për publikun dhe të rrisim ndergjegjësimin për këto çështje

KAPITULLI 4

Instrumentat Ligjore dhe Mekanizmat Jo-Regullatorë për Menaxhimin e Kimikateve

- 4.1. Permbledhje e Instrumentave Ligjore Mjedisore.
- 4.2. Permbledhje e Problemeve të Instrumentave Ligjore të Cilat i Adresohen Administrimit të Kimikateve.
- 4.3. Kuadri ligjor ekzistues sipas kategorise së përdorimit, që i adresohet llojeve të kimikateve nga Prodhimi/Importi deri Asgjësimi.
- 4.4. Permbledhje e Problemeve të Konstatuara dhe Procedurave për Kontrollin e Kimikateve
- 4.5. Mekanizmat Jo-rregullatorë për Menaxhimin e Kimikateve
- 4.6. Komente dhe Analiza

4.1. Permbledhje e Instrumentave Ligjore Mjedisore.

Kuadri ligjor mjedisor është në përsosje dhe kompletim. Kohët e fundit Qeveria ka miratuar Planin Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit me atë të Bashkimit Europian dhe Zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizimit Asocimit. Legjislacioni mjedisor në fakt është krejtësisht i ri, me një prirje të qartë përafrimi me legjislacionin evropian; ai përbëhet nga të gjitha nivelet dhe llojet e akteve ligjore dhe normative duke filluar me kushtetutën, ligje të vecanta, vendime qeverie, urdhëra dhe udhëzime, rregullore, norma, standarte etj. Nga ana tjetër është për të theksuar se kuadri ligjor mjedisor mbështet dhe nxit me shumë përdorimin e mjeteve të kontrollit dhe të komandës së instrumentat ekonomike mjedisore.

Pas viteve '90 e këtej, shoqëria demokratike Shqiptare u ndodh para shumë problemeve të mëdha që duhet të zgjidhte jo vetëm të fushës ekonomike-shoqërore por dhe asaj mjedisore.

Shteti demokratik, forcat politike, shkenca, ambientalistët dhe shumë pjesë të emancipuara të shoqërisë u angazhuan shumë e me shumë rreth mjedisit. Duke pranuar këto përfshirje dhe motivim, përballë vështirësive dhe ndërprerjeve filloj të marrë formë dhe të rritet një qëndrim i ri për mjedisin, shumë më ndryshe nga ai i mëparshëm.

Proceset demokratike në Shqipëri pësojnë ndryshime radikale zhvillimi, duke përfshirë këtu dhe hapin e madh mjedisor tashmë që ka filluar. Është e kuptueshme që gjatë 10-vitet e fundit, mjedisi dhe mbrojtja e tij kanë kaluar nëpërmjet një procesi të plotë zhvillimi. Me qëllim që procesi të jetë sa më real për marrjen e vendimeve, ai është duke vendosur ide bashkëkohore për mjedisin dhe mbrojtjen e tij, duke e zhvilluar këtë si një fazë të rëndësishme në përpjekjet e vendit tëone për integrimin në Evropë.

Një nga këto përpjekje të politikës dhe shtetit shqiptar ka qenë hartimi dhe plotësimi i legjislacionit mjedisor, i cili nga pikpamja e hartimit dhe përshtatjeve mund të ndahet në dy periudha :

Periudha e parë nga viti 1993-2000 dhe e dytë prej vitit 2001 deri më sot

Gjatë periudhës së parë, mbrojtja e mjedisit mbështetej në ligjin nr.7664, datë 21.01.1993 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” dhe në amendamentet e tij nr.8364, datë 2.07.1998, nr.8825, datë 5.11.2001. Ky ligj parashikonte gjithashtu nevojën e një asistence dhe krijimit të bazave për shumë procese dhe aktivitete që sot zhvillohen normalisht.

Në këtë periudhë u hartuan dhe miratuan një sërë ligjesh në fusha të tjera të cilat paten një rëndësi të madhe në menaxhimin e mjedisit.

Në këtë në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, Ligji nr.7895 të vitit 1995 u parashikua një kapitull (kapitulli IV) i vecantë për veprat e ndryshme penale kundër mjedisit (nënet 201-207). Neni

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

202 i ketij Kodi per veper penale ne transportin e mbetjeve toksike parashikon burgim deri 15 vjet. Po keshtu ne Ligjin nr.7850/1994 “Kodi Civil i Republikes se Shqiperise neni 624 i drejtohet detyrimeve per mjedisin.

Me miratimin e Kushtetutes se Shqiperise,disa nga principet dhe kerkesat per mbrojtjen e mjedisit, sic eshte principi per nje zhvillimi te qendrushem dhe e drejta e publikut per informim mjedisor jane tashme norma kushtetuese.

Dispozita te vecanta te Kushtetutes sanksionojne qellimet e shtetit “per nje mjedis te shendetshem dhe te pershtatshem ekologjik per brezat e sotem dhe te ardhshem” dhe “per shfrytezim racional te pyjeve,ujerave,kullotave,bazuar ne parimin e zhvillimit te qendrushem”,si dhe per te drejten e cdo shtetasi “per t’u informuar per gjendjen e mjedisit dhe mbrojtjen e tij.”

Shume shpejt,vendi u ndodh para problemeve te mprehta qe lidheshin me menaxhimin,perdorimin,shfrytezimin e burimeve natyrore dhe shume problemeve te tjera te mbrojtjes se mjedisit qe ligjet ekzistuese te mbrojtjes se mjedisit nuk mund ti pergjigjeshin ndryshimeve te vendit.

Aktivitetet me impakte mjedisore ishin prezente ne shume dege dhe sektore te zhvillimit te vendit te cilat preknin dhe rrezikonin seriozisht mjedisin.*Vleresimi i ndikimit ne mjedis* si nje aktivitet dhe pergatitje per dhenjen e lejes mjedisore per aktivitetet qe kerkonin te zhvilloheshin, kerkonte me shume saktesi dhe plotesim te rregullave ligjore.

Demtimet qe kishte pesuar mjedisi duhet te ndaloheshin dhe rehabilitoheshin per t’ju kthyer normalitetit dhe ne vecanti proceseve irreversible qe ishin shfaqur si shfrytezimi i flores dhe specieve te faunes,specieve te vecanta dhe popullimit te tyre,shkatrimit te habitanteve dhe mbrojtjes se hapësirave dhe demtimet nga veprimet fizike dhe kimike te tokes.

Ne nivel nacional dhe shume specifik ne lidhje me mjedisin, synimi i integritimit ne BE eshte bere nje kerkese prioritare konstante per peraftrimin e legjistacionit lokal mjedisor me kerkesat dhe standarteve e BE dhe luan nje rol te vecante.

Ne keto kushte,kompletimi i kuadrit ligjor per mjedisin dhe peraftrimi i tij me direktivat e BE konsiderohet si nje nga prioritetet kryesore te angazhimit te shtetit per mjedisin dhe si nje hap i rendesishem per integrimin e Shqiperise ne Evrope.

Hartimi i kuadrit ligjor te ri mjedisor si nje kerkese e kohes qe askush nuk mund te toleronte dhe ti shmangej, u trajtua ne Planin e Ri Kombetar te Veprimit per Mjedisin te vitit 2001 si nje nga detyrat paresore qe Ministria e Mjedisit synonte per ta zgjidhur.

Per realizimin e kesaj detyre,u konceptua paraprakisht nje Pakete Ligjore per Mjedisin ne te cilen mund te inkludoheshin shume ligje urgjente per te plotesuar boshllekun qe ekzistonte ne kete fushe. Duke marre ne konsiderate eksperiencon,kapacitetet,planifikimin ne kohe dhe progresin e bere,padyshim ky process ishte shume kompleks dhe ambicios sepse kishte shume ligje teknike te vecanta qe mungonin dhe fusha te patrajuara per publikun shqiptar dhe qe duhet te hartoheshin per here te pare ne Shqiperi.Megjithate, perpjekjet disa vjecare te nje grupi te gjere specialistesh rezultuan te sukseshme ne hartimin e ligjeve te reja per mjedisin.

Pas vitit 2002 dhe ne vazhdim u bene amendamente te rendesishme ne legjistacionin shqiptar.Gjate ketyre viteve u aprovuan dhe jane ne zbatim si vijon :

Ligji Nr.8934,date 5.09.2002 “Per Mbrojtjen e Mjedisit”

Ligji Nr.8897,date 16.05.2002“Per Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja”

Ligji Nr.8906,date 06.06.2002“Per Zonat e Mbrojtura”

Ligji Nr.8905,date 06.06.2002“Per Mbrojtjen e Mjedisit Detar nga Ndotja dhe Demtimi”

Ligji Nr.8990,date 23.01.2003“Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis”

Ligji Nr.9115,date 24.07.2003“Per Trajtimin Mjedisor te Ujrave te Ndotura”

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

Ligji Nr.9010,date 13.02.2003‘Per Administrimin Mjedisor te Mbetjeve te Ngurta’

Ligji Nr.9103,date10.07.2003“Per Mbrojtjen e Liqeneve Transkufitare”

Ligji Nr.9108,date 17.07.2003 “Per Substancat dhe Preparatet Kimike”

Ne kete periudhe u hartuan dhe miratuan nje sere Vendimesh te Keshillit te Ministrave (V.K.M), te cilat ndihmuan ne zbatimin e ligjeve dhe qe peshojne ne menyre te konsiderushme ne rregullimin e mardhenjeve ligjore mjedisore per drejtorite dhe sektoret e vecante te institucioneve shteterore nga njera ana dhe subjekteve private nga ana tjeter.Kete mund ta illustrojme me listen e meposhtme te ketyre vendimeve:

V.K.M Nr.103,date 31.03.2002

“Per Monitorimin e Mjedisit ne Republiken e Shqiperise”

V.K.M Nr.42,date 16.01.2003

“Per Miratimin e Planit Kombetar te Veprimit per Mjedisin (NEAP)”

V.K.M Nr.435,date 12.09.2002

“Per miratimine normave te shkarkimeve ne ajer ne R.Shqiperise”

V.K.M Nr.676,date20.12.2002

“Per Shpalljen e Monumeteve Natyrore te Shqiperise”

V.K.M Nr.531,date 31.10.2002

“Per Shpalljen e kompleksit ligator teButrintit dhe te territorit perreth tij zone natyrore vecanerisht e mbrojtur dhe perfshirjen e tij ne listen e ligatave me rendesi nderkombetare,vecanerisht si habitate te shpendeve ujore”(Zone Ramsar)

V.K.M Nr.364,date18.07.2002

“Per Miratimin e Planit te Administrimit te Zones Bregdetare”

V.K.M Nr.42,date 16.01.2003

“Per Krijimin e Komitetit Nderministror per implementimin e planit NEAP”

V.K.M Nr.659,date 18.12.2002

“Per Krijimin e Institutit te Mjedisit”

V.K.M Nr.266,date 24.04.2003

“Per Administrimin e Zonave te Mbrojtura”

V.K.M Nr.267,date 24.04.2003

“Per Procedurat e Miratimit te Zonave te Mbrojtura dhe Buffer”

V.K.M Nr.268,date 24.04.2003

“Per Certifikimin e Eksperteve per Perpilimin e Raportit te V.N.M dhe Auditimin Mjedisor”

V.K.M Nr.249,date 24.04.2003

“Per Dokumentacionin e Lejes Mjedisore dhe Elementet e saj”

V.K.M Nr.248.04.2003

“Per Normat e Perkohshme te Emissioneve ne Ajer”etj.

V.K.M Nr.447,date 19.09.1994

“Per Ndalimin e Azbestit si Material Termoizolues ne Ndertim”

V.K.M Nr.26,date 31.01.1994

“Per Mbetjet e Rrezikshme dhe Mbeturinat’

V.K.M Nr.776,date 8.12.1998

“Per Grumbullimin dhe Depozitimin e Detyruar te Automjeteve te Braktisura”

V.K.M Nr.433,date 3.09.1999

“Per Ndalimin e Importimit te Gomave te Perdorura”

V.K.M Nr.323,date 8.07.1999

“Per Pergatitjen,Pershtatjen dhe Zbatimin e Rregullave Teknike dhe Procedurat per Vleresimine Konformitetit me Rregullat Teknike e Standartet”

V.K.M Nr.447,date 16.09.1999

V.K.M Nr. 72,date 15.02.2001

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

Per miratimin e “Rregullore e produkteve per mbrojtjen e bimeve”

“Per Miratimin ne Parim te Marrveshjes Ndermjet Qeverise se Republikes se Shqiperise dhe Keshillit Federal te Zvicres per Statusin e Personelit Zviceran qe do te Angazhohet ne Shkatrimin e Mbetjeve Toksike te Magazinuar ne Depot e Ushterise Shqiptare”.

Bazuar ne keto arritje,disa perfundime sinjifikative dhe indikatore mund te vihen ne dukje ne lidhje me aspektet ligjore te mbrojtjes se mjedisit ne Shqiperi.

Shqiperia, tashme ka krijuar te drejtat e saj mjedisore,shume me te kompletuara tani per tani dhe te zbatueshme gjithashtu.Gradualisht,e drejtat mjedisore eshte duke u konsoliduar si nje dege e vecante e te drejtave ne Shqiperi.

Gjithashtu pervec sa me siper e drejta per mjedisin reflektohet edhe ne ligje te vecanta si kapituj ose komponente kryesore ose ceshtje te mjedisit.

Tani mund te konsiderohet pothuajse i kompletuar legjislacioni i hartuar per ruajtjen e biodiversitetit dhe komponenteve te tij.

Ketu perfshihen disa ligje te hartuara dhe ne fuqi si : Ligji nr.7623,dt.13.10.1992 “Per Pyjet dhe Policine Pyjore”, Ligji “Per Peshkimin dhe Gjallesat Ujore”, Ligji nr.7659,dt.12.01.1993“Per Farerat dhe Fidanat”, Ligji “Per Faunen e Eger dhe Gjuetine”, Ligji “Per Mbrojtjen e Pemeve te Hortikultures”, Ligji “Per Zonat e Mbrojtura”, Ligji “Per Mbrojtjen e Liqeneve kufitare”, Ligji “Per Livadhet dhe Kullotat”, Ligji “Per Mbrojtjen e Bimeve Natyrale-Mjekseore,Eterovajore dhe Tanifere” Ligji nr.7662, dt.19.01.1993“Per sherbimin e mbrojtjes se bimeve”etj.

Pervec ketyre nje grup tjeter ligjesh u hartuan per mbrojtjen e mjedisit nga ndotesit dhe demtimet sic jane ; Ligji “Per Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja”, Ligji “Per Trajtimin e Mbetjeve te Ngurta”, Ligji “Per Grumbullimin e Mbeturinave Publike”, Ligji “Per Trajtimin Mjedisor te Ujrave te Ndotura”, Ligji “Per Rezervat Ujore”, Ligji “Per Kuadrin Regullator te Sektorit te Furnizimit me Uje dhe Grumbullimin,Trajtimin e Ujrave Hedhurine”, Ligji “Per Token”, Ligji Minerar Shqiptar,Ligji Per Hidrokarburet, Ligji “Per Radiacionin Jonik”, Ligji “Per substancat dhe Preparatet Kimike” etj. U pergatit dhe u miratua ligji “Per mbrojtjen e shtreses se Ozonit” .Ky ligj ka per qellim te percaktojë rregullat per administrimin, deri ne heqjen nga perdorimi, te substancave ozonholluese, si dhe produkteve qe permbajne keto substanca, ose jane prodhuar me to.

Grup tjeter i vecante i ligjeve te hartuara do te perfshinte ligje qe rregullojne proceset e vlersimit te ndikimit ne mjedis dhe perdorimit te lejes mjedisore me ndikim ne mjedis.

Ketu mund te perfshihen ligjet;Ligji “Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis”, Vendimi i Keshillit te Ministrave “Per Certifikimin e Eksperteve per Hartimin e Raportit te V.N.M per Mjedisin dhe Auditimin Mjedisor”,V.K.M “Per Aktivitetet me Ndikime ne Mjedis qe Duhet te Parashikohet Leje Mjedisore”,V.K.M “Per Rregullat dhe Procedurat e Nxjerrjes se Lejes Mjedisore”etj.

Ky legjislacion krijon bazat e nevojshme qe aktivitetet ne perdorim, menaxhimi dhe mbrojtja e mjedisit te jene ligjore.Ky legalizim perputhet me zhvillimin aktual dhe perspektiven afat-mesem te zhvillimit ekonomik, e cila ka te parashikuar zgjidhjen e problemeve te zhvillimit, qe rezultojne nga praktika ne fushen e mbrojtjes se mjedisit.

Nga sa me siper mund te konkludohet qe legjislacioni shqiptar dhe amandamentet e tij jane ne te njejten nivel me zhvillimin, e te krahesueshme, me fqinjat e nje vendi ose rajoni,duke krijuar premise per te ndermarre aktivite te vecanta, ne fushen e mjedisit, per te lehtesuar sherbimin ne kete fushe ne menyre, qe te garantohet mbrojtja mjedisore e ekosistemeve, te cilat menaxhohen nga dy ose me shume vendefqinje.

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

Principet dhe kërkesat e shumta për mbrojtjen e mjedisit, të harmonizuara me normat dhe direktivat e BE për emisionet në mjedis që reflektohen në legjislacionin shqiptar, kanë rritur besimin për investitorët e huaj, që ata të jenë të mbrojtur dhe të garantuar nga ana mjedisore.

Legjislacioni mjedisor shqiptar nuk do të kompletohet në rast se nuk do të kishte parasysh konventat ndërkombëtare të mjedisit, protokollat dhe marrëveshjet me Republikën e Shqipërisë që janë në përputhje me disa nenshkrime, aderime dhe ratifikime.

Keto rrethana janë për tu vënë në dukje sepse në përputhje me nenin 122 të Kushtetutës së Shqipërisë, konventat ndërkombëtare janë të ratifikuara me ligj nga Kuvendi Popullor dhe janë të publikuara në Gazetën Zyrtare si pjesë integrale e legjislacionit kombëtar dhe mbizoterojnë ligjet kombëtare që nuk përputhen me to.

Ndryshimet demokratike në vend sollen një ndryshim të madh në pjesëmarrjen e Shqipërisë në konventa ndërkombëtare dhe në aktet ligjore. Aderimi në keto konventa dhe ratifikimi ishte një nga komponentet kryesore të hapjes së Shqipërisë me botën, të zhvillimit të saj intensiv, e kooperimit me faktorin ndërkombëtar dhe stabilizimit të marrëdhënjëve normale me të. Në keto iniciativa një vend të rëndësishëm zënë konventat rajonale dhe globale mjedisore. Për të ilustruar këto, më poshtë po përmendim disa nga konventat mjedisore, duke përfshirë këtu protokollat e tyre në të cilat Republika e Shqipërisë është pale.

1. Konventa për të Drejtën për Informim, Pjesëmarrjen e Publikut në vendim-marrje për mjedisin dhe të Drejtën për t'iu drejtuar gjykatës për probleme mjedisore (*Konventa e Aarhus*) e ratifikuar me Ligjin Nr.8672, datë 26.10.2000.
2. Konventa për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në Kontesin Nderkufitar (Espoo, Finland) ratifikuar në 4.10.1991.
3. Konventa për kontrollin e transportit ndërkufitar të mbeturinave të rrezikshme dhe depozitimin e tyre (*Konventa e Baselit*) ratifikuar me Ligjin Nr.8216, datë 13.05.1997.
4. Konventa për mbrojtjen e mjedisit detar dhe hapësirës bregdetare të Detit Mesdhe (*Konventa e Barcelonës*) ratifikuar me Ligjin Nr.8690, datë 26.10.2000.
5. Konventa për përdorimin dhe mbrojtjen e lumenjeve dhe liqeneve ndërkombëtare (Helsinki 1992) ratifikuar me Ligjin Nr. 5.01.1994.
6. Konventa e Diversitetit Biologjik (Rio de Janeiro 1992) ratifikuar me 10.11.1996.
7. Konventa për mbrojtjen e shtresës së ozonit ratifikuar me Ligjin nr.8463
8. Konventa për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC) ratifikuar me 1994.
9. Konventa për ruajtjen e specieve migrante të kafsheve të egra ratifikuar me Ligjin Nr.8692, datë 16.11.2000.
10. Konventa për ruajtjen e vendbanimeve të egra dhe natyrore evropiane, ratifikuar me Ligjin Nr.8294, datë 2.03.1998.
11. Konventa e Ramsarit ratifikuar me 29.03.1996
12. Konventa për ndikimin transkufitar të aksidenteve industriale ratifikuar me ligjin Nr.13.05.1997.
13. Konventa për luftën kundër shkretëzimit në ato vende që vuajnë në vecanti nga

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

thatesira dhe shkreterizimi ne vecanti Afrika, ratifikuar me Ligjin Nr.8556,date 22.12.1999.

14 .Konventa per ndalimin e zhvillimit,te prodhimit,magazinimit dhe perdorimit te armeve kimike dhe per shkatrimin e tyre,ratifikuar me Ligjin Nr.9092,date 3.07.2003.

Tani ky legjislacion eshte efektiv dhe i zbatueshem dhe aplikohet ne :

- a) Vendosjen e rregullave bashkekohore per integrimin dhe mbrojtjen e mjedisit dhe komponenteve te vecante te tij.
- b) Perdorimin korekt te termave dhe percaktimeve,per futjen ne to te ligjeve te reja mjedisore me mjaft koncepte dhe kategori te kohes .Koncepte te tilla si akreditim, certifikim, audience, auditim etj. jane futur per here te pare ne legjistacionin mjedisor te Shqiperise.Shume terma te perdorur me pare kane marre kuptime bashkekohore,te cilat jane selektuar nga letrat zyrtare mjedisore nderkombetare.Duke filluar me termin “mjedis” dhe shmangiet, keto terma kane qene te parashikuar me shpjegimin e vjeter te kuptimit,ndryshe nga kuptimi qe gjendej ne direktivat e BE dhe konventat mjedisore.
- c) Zhvillimin horizontal te legjistacionit, hartimi i ligjeve te vecante per shume komponente te mjedisit si ujit, ajrit dhe tokes si dhe shume aktivitete specifike per mjedisin si p.sh. vleresimi i ndikimit ne mjedis,monitorimi dhe kontrolli mjedisor,kontrolli dhe menaxhimi i emisioneve dhe mbetjeve, perdorimit te lejes mjedisore per aktivitetet qe ndotin mjedisin etj.
- d) Perfshirjen ne legjislacionin lokal te kerkesave te konventave nderkombetare, protokolleve dhe marveshjeve ne te cilat vendi yne eshte pale.Hartimi i projekteve te reja te ligjeve gjykohet se eshte nje okazion i mire per harmonizimin e cdo ligji me kerkesat e ketyre konventave sic e permendem me lart.Pervec kesaj,kerkesat e konventave dhe obligimet per te qene te zbatueshme gjeresisht ne praktiken e vendin tone gjykohen si pika referimi per permbajtjen dhe cilesine e projekt-ligjeve.
- e) Aplikimin e kerkesave,normave dhe standarteve te BE,adoptimi i tyre me kushtet e vendit tone, i kerkesave dhe direktivave te BE per mjedisin.

Ne shume ligje si p.sh. per substancat dhe preparatet kimike te mbrojtjes se ajrit nga ndotja,per mbrojtjen e zonave,per menaxhimin e mbetjeve te ngurta,per vleresimin e ndikimit ne mjedisi, perfshirja e kerkesave te direktivave te BE eshte lehtesisht e dallushme.

Integrimi i mjedisit si nje komponent i patolerushem ne politikat, strategjite,planet lokale dhe nacionale te veprimit,perfshirja ne cdo sektor,perbejne nje nga dallimet e reja karakteristike te legjislacionit mjedisor.Ne kapituj te vecante titulluar “Politikat mjedisore” te ligjit “Per mbrojtjen e mjedisit” jane pasyruar ne detaje keto elemente te rendesishem per mbrojtjen e mjedisit.Ne menyre specifike,neni 9 i ketij Ligji shprehet si vijon :

“Strategjite sektoriale dhe planet e veprimit me karakter kombetar hartohen ne perputhje me parimet dhe perparesite e strategjise kombetare te mjedisit.”

“Strategjite, planet dhe programet per zhvillimin e ekonomise dhe te degeve te saj ne nivel kombetar, rajonal, qarku ose bashkise,sigurojne integrimin e kerkesave te mbrojtjes se mjedisit, ne perputhje me strategjine kombetare te mjedisit.”

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

Per angazhimin e organeve te rendesishme te qeverise vendore ne mbrojtjen e mjedisit brenda ketij legjistacioni,ligji ne menyre keshilluese shprehet qe organet e qeverise lokale perfaqesojne struktura shume te rendesishme shteterore per administrimin dhe mbrojtjen e mjedisit brenda ketij kuadri ligjor.

Duke shfaqur keto vecori,legjislacioni i ri shqiptar,konstituon nje baze te forte per te permiresuar mbrojtjen e mjedisit,nje mentalitet tjeter te punes qe ndeshet ne praktike.

Niveli dhe cilesia e permiresimit te ketij kuadri ligjor do te sjelle me kohe dhe progress ne realizimin e tij.Kjo do te varet nga sigurimi i perfshirjes se gjere ne te, te ligjeve qe sigurojne nivel te larte detyrimi ne praktike.

Ministria e Mjedisit,Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave si organ pergjegjes eshte e vetedijshme qe keto ndryshime ne fakt jane presente.Ministria synon per implementimin sa me shpejt te jete e mundur nepermjet aplikimit te kerkesave te ketij kuadri ligjor ne programet dhe komitetet koordinatorore midis institucioneve shteterore dhe organizatave te shoqerise civile,duke bere te njohur impaktet dhe kostot reale te aplikimit te ligjeve.

Te gjitha instrumentat ligjore pa perjashtim ne Republiken e Shqiperise behen publike nepermjet Gazetes Zyrtare te Republikes se Shqiperise.Pervec kesaj me interesimin e Ministrise se Mjedisit dhe kujdesit te Qendres Rajonale te Mjedisit (REC)te gjitha instrumentat ligjore qe i adresohen mjedisit jane permbledhur dhe botuar ne dy vellime.

-Vellimi i pare permbledh aktet ligjore mjedisore nga viti 1993-2001

-Vellimi i dyte permbledh aktet ligjore mjedisore nga viti 2002-2003

Keto permbledhje tashme te publikuar perbejne padyshim nje informacion me vlere dhe perdorim nga audienca ne Shqiperi e cila interesohet per mjedisin e saj.Pervec kesaj botimet do te vleresohen dhe do te sherbejne si nje fond i mire,vecanerisht per institucionet e huaja qe operojne ne Shqiperi; ne mardhenjet me organizatat e BE, te cilat ndjekin procesin e perafritimit te legjistacionit me standarte dhe kerkesat e BE, per investitore dhe biznesmene qe synojne te investojne ne Shqiperi per te rritur dhe intesifikuar mardhenjet me fqinjat dhe vendet e rajonit ne fushen e mjedisit.Per institucionet kerkimore te huaja te specializuara,shkollat dhe departamentet e drejtesise te cilat jane te angazhuar per studimin e ketij legjislacioni me qellim te parashikimit te pikave te references ne studimet e analizat e tyre krahesuese.

4.2.Permbledhje e Instrumentave Ligjore Te Cilat i Adresohen Administrimit te Kimikateve (Tabela 4a)

Tabela 4A

Nr	Instrumentat ligjore (tipi,referenca,viti)	Lloji aktivitetit	Objektivat e instrumentit ligjor	Ministria pergjegjese
1.	Ligji nr.9108,dt.17.7.2003 "Per substancat dhe preparatet kimike"	Prodhim, tregetim, ruajtje te substancave kimike	Te vendose te drejtat dhe detyrimet e personave juridike ose fizike ne percaktimin e vetive,klasifikimin e sub.dhe prep.kimik per regjistrim,inventarizim,njoftim,menaxhimin dhe tregtimin e tyre.	M.M.P.A.U. M.SH.
2.	V.K.M nr.1,dt.21.8.1998 "Per rregullat e klasifikimit,emertimit dhe transportit rrugor te mallrave te rrezikshme"	Transporti i mallrave te rrezikshme	Percakton parimet e klasifikimit ndarjen ne klase dhe listen e mallrave kryesore,te rrezikshme, si dhe dispozitat e pergjithshme te identifikimit, ambalazhimit,procesit te ngarkim shkarkimit dhe transportit te tyre.	M.P.P.T.T
3.	V.K.M nr.824,dt.11.12.2003 "Per klasifikimin,etiketimin, ambalazhimin dhe ruajtjen e substancave kimike"	Manaxhim, administrim i substancave kimike	Parandalimin e aksidenteve,mbrojtjen e shendetit dhe jetes se njerezve qe merren me menaxhimin dhe administrimin e substancave kimike te rrezikshme.	M.M.P.A.U M.SH M.E.T.E
4.	Ligji nr.8531,dt.23.09.1999 "Per sherbimin e kontrollit te plehrave kimike"	Manaxhim, administrim i plehrave kimike	Te mundesoje kontrollin e plehrave kimike,te importit dhe te vendit,qe qarkullojne ne tregun shqiptar,per te siguruar perdorimin e plehrave te sigurta e cilesore,ne perputhje me kerkesat per ruajtjen e shendetit te njerezve,te kafsheve,te bimeve per mbrojtjen e mjedisit dhe te konsumatorit.	M.B.U.M.K

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

5.	V.K.M Nr. 72, date 15.02.2001 Per miratimin e "Rregullore e produkteve per mbrojtjen e bimeve" shfuqizon VKMnr.584,dt.6.12.1993	Manaxhim, administrim i plehrave kimike	Qellimi I aktit eshte qe nepermjet procedures se rregjistrimit,vendosjes ne treg dhe kontrollit te PMB-ve,te garantoje ne maksimum mbrojtjen e njerezve,kafsheve dhe mjedisit.	M.B.U.M.K
6.	V.K.M nr.234,dt.11.05.2000 "Per kriteret dhe rregullat e marrjes se mostrave dhe vleresimit te plehrave kimike"	Manaxhim, administrim i plehrave kimike	Akt normative per vleresimin e plehrave kimike	M.B.U.M.K
7.	V.K.M nr.253,dt.18.05.2000 "Per organizimin e sherbimit te kontrollit te plehrave kimike"	Manaxhim, administrim i plehrave kimike	Organizimi i sherbimit te plehrave kimike	M.B.U.M.K
8.	Ligji nr.7961,dt.12.7.1995 "Kodi i Punes i R.Shqiperise",ndryshuar me ligjin nr.8085, dt.12.3.1996 nr..9125,dt.29.7.2003	Mbrojtja ne pune	Te vendose te drejtat dhe detyrimet e punedhenesit dhe punemarresit per sigurine dhe mbrojtjen ne pune dhe kushteve per nje mjedis te pershtatshem.	M.P. Ç.S.SH.B
9.	V.K.M nr 459,dt.22.07.1998 "Per substancat e rrezikshme"	Mbrojtja ne pune	Percakton substancat e rrezikshme, me qellim mbrojtjen e shendetit dhe sigurimin ne pune nga perdorimi i tyre.Sipas vendimit bashkelidhur eshte vendosur lista e 154 substancave te rrezikshme.	M.P. Ç.S.SH.B
10.	Ligji nr.7986,dt.13.9.1995 "Per Inspektoriatin Shtetor te Punes"	Siguria dhe mbrojtja ne pune	Te siguroje zbatimin e legjislacionit te punes nga punedhenesi dhe personat e siguruar prej tyre.	M.P. Ç.S.SH.B
11.	V.K.M nr.207,dt.9.5.2002 "Per percaktimin e puneve te veshitura ose te rrezikshme"	Siguria dhe mbrojtja ne pune	Te percaktoje punet e veshitura ose te rrezikshme per jeten dhe shendetin e njeriut dhe krijojte kushte te larta sigurie.	M.P. Ç.S .SH.B.Ministrite e Linjes
12.	V.K.M nr 742,dt.6.11.2003 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne V.K.M nr.692,dt.13.12.2001 "Per masat e vecanta te sigurimit dhe mbrojtjes se shendetit ne pune"	Siguria dhe mbrojtja ne pune	Te vendose sherbimin mjekesor ne te gjitha subjektet qe ushtrojne veprimtari prodhuese private ose shtetore,vendase ose te huaja,juridike ose fizike.	M.P. Ç.S.SH.B M.SH
13.	Udhezim i perbashket i Ministrat te M.P. Ç.S dhe M.SH nr.2, dt.25.6.2004 "Per zbatimin e V.K.M nr.742,dt 6.11.2003"	Siguria dhe mbrojtja ne pune	Te percaktoje strukturat pergjegjese dhe funksionimin e sherbimit shendetesor ne subjektet private dhe shtetore	I.SH.P, I.S.SH
14.	Ligji nr.8934,dt.5.9.2002 "Per mbrojtjen e mjedisit"	Mbrojtja e ajrit,ujit dhe tokes	Te rregulloje mardhenjet ndrmjet njeriut dhe mjedisit,mbron perberesit mjedisit dhe proceset mjedisore,siguron kushte materiale per zhvillim te qendrueshem e nje mjedis ekologjikisht te paster.	M.M.P.A.U
15.	Ligji nr.8990,dt.23.1.2003 "Per vleresimin e ndikimit ne mjedis"	Mjedisi	Percakton rregullat,procedurat,afatet,te drejtat dhe detyrat per identifikimin , saktesimin dhe vlersimin e ndikimeve te drejperdrejta dhe te terthorta te projektit ose veprimtarise, per te siguruar shqyrtim cilesor teknik dhe juridik te kerkeses dhe marrjes se vendimit nga organet perkatese.Percakton veprimtarite qe i nenshtrohen VNM-se	M.M.P.A.U
16.	Ligji nr.9010,dt.13.2.2003 "Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta"	Mjedisi dhe shendetit	Ligji synon mbrojtjen e mjedisit dhe shendetit nga ndotja dhe demtimi prej mbetjeve te ngurta, zvogelimin e ndikimeve te tyre te demshme e te demshme	M.M.P.A.U
137 17.	Ligji nr.9115,dt.24.7.2003 "Per trajtimin mjedisor te ujerave te ndotura"	Mbrojtja e ujit	Objekti i ligjit, te mbroje mjedisin dhe shendetin e njeriut nga ndikimet negative te ujerave te ndotura, duke percaktuar rregullat e trajtimit mjedisor te tyre si dhe detyrimet e shkarkusave te ujerave te ndotura.	M.M.P.A.U
18.	Ligji nr.9103,dt.10.7.2003 "Per mbrojtjen e liqeneve nderkufitare"	Mbrojtja e ujit	Synon mbrojtjen mjedisore te liqeneve nderkufitare ne gjendjen e tyre natyrore, garantimin e kushteve te pershtatshme per zhvillimin e jetes dhe te ekosistemeve ne to,duke nxitur zhvillimin e veprimtarive te dobishme,ne perputhje me kerkesat e parimit te zhvillimit te qendrueshem dhe duke ndaluar veprimtarite qe rrezikojne.	M.M.P.A.U
19.	Ligji nr.8905,dt.6.6.2002 "Per mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja"	Mbrojtja e detit	Ka per qellim mbrojtjen e mjedisit detar te R.Shqiperise nga ndotjet dhe demtimet, parandalimin dhe shmangien e tyre,te shkaktuara nga veprimtarite njerezore ne det e ne zonen bregdetare,te cilat prishin cilesine e ujit,demtojne burimet e detit e te bregdetit,trezikojne faunen dhe floren,kercojne shendetin e njeriut,si dhe veshitresojne zhvillimin normal te veprimtarive ne kete mjedis.	M.M.P.A.U Ministrite e Linjes
20.	Ligji nr.8756,dt.26.3.2001 "Per emergjencat civile"	Emergjencat civile	Planizimi dhe perballimi i emergjencave civile, parandalimi,pakesimi dhe riaftesimi nga cdo demtim qe prek popullaten,gjene e gjalle,pronen, trashegimine kulturore dhe mjedisin.	M.B
21.	V.K.M nr.103,dt.31.3.2002 "Per monitorimin ne Republiken e Shqiperise"	Mjedisi	Shpall treguesit mjedisore dhe programin e matjeve sistematike,vezhgimit dhe raportimit te tregusve mjedisore.	M.M.P.A.U Ministrite e Linjes
22.	V.K.M nr.435,dt.12.9.2002 "Per miratimin e normave te shkarkimeve ne ajer ne Republiken e Shqiperise"	Mbrojtja e ajrit	Vendos normat e shkarkimeve ne ajer nga subjektet te cilat fillojne veprimtarine pas hyrjes ne fuqi te ketij vendimi	M.M.P.A.U
23.	V.K.M nr.248,dt 24.4.2003"Per miratimin e normave te perkohshme te shkarkimeve ne ajer dhe zbatimin e tyre"	Mbrojtja e ajrit	Vendos normat e perkohshme te shkarkimeve ne ajer nga subjektet ekzistuese te cilat ushtrojne veprimtarine para hyrjes ne fuqi te ketij vendimi	M.M.P.A.U Ministrite e Linjes
24.	V.K.M nr.34,dt.28.1.2002 "Per miratimin e Planit Kombetar te Veprimit per Mjedisin"	Mjedisi	Plani Kombetar i Veprimit per Mjedisin.Veprimet afat shkurter, afat mesem qe duhet te ndermeren per mbrojtjen e mjedisit.	M.M.P.A.U Ministrite e Linjes

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

25.	Ligji nr.7051,dt.19.7.1991 “Per token”ndryshuar me nr.7763,dt.25.10.1993,nr.7855,dt.29.7.1994	ligjin	Mbrojtja e tokes	Klasifikimi i tokes,pronese mbi token dhe te drejtat dhe detyrimet e pronareve per ruajtjen e mbrojtjen e tokes.	M.B.U.M.K
26.	Ligji nr.7623,dt.13.10.1992 “Per pyjet dhe sherbimin pyjor”,ndryshuar me ligjin nr.7838,dt.30.6.1994	ligjin	Mbrojtja e pyjeve	Administrimi,mbrojtja, profilizimi dhe trajtimi i pyjeve me qellim te mbrojtjes se ambientit, prodhimin e lendes druesore dhe produkteve te tjera te pyllit.	M.B.U.M.K
27.	Ligji nr.7662,dt.19.1.1993 “Per sherbimin e mbrojtjes se bimeve”	ligjin	Mbrojtja e bimeve	Parashikon mbrojtjen e bimeve,ne vecanti te bimeve bujqesore nga demtimi i agjenteve parazitare dhe joparazitare,mbrojtjen e produkteve bujqesore nga organizmat e demshme,mbrojtjen e shendetit te njerezve dhe kafsheve nga perdorimi i pesticideve dhe nga masa te tjera mbrojtese.	M.B.U.M.K
28.	Ligji nr.8093,dt.21.3.1996 “Per rezervat ujore”,ndryshuar me ligjin nr.8375,dt.15.7.1998,nr.8736,dt.1.2.2001	ligjin	Mbrojtja e ujit	Te siguroje konservimin,zhvillimin dhe perdorimin ne menyre sa me racionale te jete e mundur te burimeve ujore,te siguroje te drejtat e distributoreve te ujit,mbrojtjen e ujit nga ndotja,te percaktoje institucionet pergjegjese nacionale etj.	K.M
29.	Ligji nr.9103,dt.10.7.2003 “Per mbrojtjen e liqeneve nderkufitare”	ligjin	Mbrojtja e ujit	Mbrojtjen e mjedisit te liqeneve nderkufitare ne gjendjen e tyre natyrale,garantimin e kushteve te pershtatshme per zhvillimin e jetes dhe ekosistmeve.	M.M.P.A.U,
30.	Ligji nr.8025,dt.9.11.1995 “Per mbrojtjen ndaj radiacionit jonik”	ligjin	Mbrojtja nga rezatimi	Percakton termat dhe kushtet per mbrojtjen kunder rezatimit jonik ne rastin e aktiviteteve dhe paisjeve qe perdorin substance radioactive me qellim mbrojtjen e popullsisë dhe ambientit,ne pergjithesi nga rreziku potencial i radiacionit.	M.SH, M.M.P.A.U
31.	Ligji nr.8094,dt.21.3.1996 “Per depozitimin e mbetjeve urbane”	ligjin	Mbetjet	Te mbroje ambientin urban nga ndotja,te percaktoje juridiksionin e cdo komune dhe bashkie me qellim qe te disiplinoje sherbimin public te depozitimit te mbeturinave neper qytete.	M.P.P.T.T M.B
32.	V.K.M nr.26,dt.31.1.1994 “Per mbeturinat dhe mbetjet e rrezikshme”	ligjin	Mbrojtja e mjedisit	Ka per qellim te ndaloje importin dhe eksportin e mbetjeve te rrezikshme,te klasifikojë llojet e mbetjeve per te cilat kerkohej leje importi ose eksporti dhe autoritetin perkates qe jep lejen.	K.M. M.M.P.A.U
33.	V.K.M nr.776,dt.8.12.1998 “Per detyrimet e mbledhjes dhe depozitimit te automjeteve te braktisura.	ligjin	Mbrojtja e tokes	Te ndaloje krijimin e shesheve te reja per grumbullimin pa kritere te automjeteve,te ndaloje braktisjen e tyre.	M.P.P.T.T M.M.P.A.U M.B
34.	Ligji nr.8102,dt.28.3.1996 “Per kuadrin rregullator ne sektorin e furnizimit me uje dhe administrimit te shkarkimit te ujrave”	ligjin	Mbrojtja e ujit	Te krijojë kuadrin rregullues dhe Entin e pavarur rregullator te furnizimit me uje dhe administrimit te ujrave qe shkarkohen.Ne kete ligj percaktohen funksionet, kompetencat,procedurat dhe standartet me te cilat funksionon Enti Rregullator .Ligji garanton dhe mbron interesat e shtetit nre njeran ane dhe krijimin e transparences ligjore dhe rregullat ambjentale te cilat do te ndihmojne investimet private ne kete sektor nga ana tjetere.	K.K.U
35.	Ligji nr.5450,dt.24.02.1999 “Per perpunimin,transportin dhe tregetimin e naftes,gazit dhe nenprodukteve te tyre”ndryshuar me ligjin nr.9218,dt.8.04.2004	ligjin	Hidrokarbure	Krijimi i kuadrin ligjor dhe nenligjor rregullues, procedurat e dhenjes se lejes dhe autorizimeve dhe pergjegjesite e strukturave shtetore per perpunimin, transportin dhe tregetimin e naftes dhe gazit.	M.E.T.E M.P.P.T.T M.B
36.	V.K.M nr.130,dt.8.04.1999 “Per inspektoratin shtetor te kontrollit te naftes,gazit dhe nenprodukteve te tyre”	ligjin	Hidrokarbure	“ “ “	M.E.T.E
37.	V.K.M129 dt.28.03.1999 “Per procedurat dhe kushtet per dhenjen e lejes e te autorizimeve per tregetimin e naftes,gazit e nenprodukteve te tyre”	ligjin	Hidrokarbure	“ “ “	M.E.T.E I.SH.N.G
38.	Ligji nr.9092,date 3.07.2003 Per zbatimin e “ Konventes per ndalimin e zhvillimit,te prodhimit, magazinimit dhe perdorimit te armeve kimike dhe per shkaterimin e tyre”	ligjin	Armet	Ligji percakton autoritetin,pergjegjesite,krijimin dhe funksionimin e organeve te nevojshme per zbatimin e detyrimeve,qe rrjedhin nga Komnventa per Ndalimin e Armeve Kimike (KNAK) ne Republiken e Shqiperise si shtet pale e saj.	M.M M.E.T.E
39.	Ligji nr.9126 dt.29.07.2003 “Per perdorim civil te lendeve plasese ne Republiken e Shqiperise”	ligjin	Eksplozivet	Percaktimi i procedurave,rregullave dhe pergjegjesive te administrates shtetore per prodhimin,magazinimin,perdorimin,kontrollin,asgjesimin,transferimin dhe menyren e tregetimit te lendes plasese per perdorim civil,per mbrojtjen dhe sigurimin e jetes,te shendetit te njerezve, kafsheve,vlerave materiale dhe mjedisit nga lendet plasese.	M.E.T.E, M.M M.B
40.	V.K.M nr.52 dt. 29.01.2004 “Per proceduren e dhenjes se lejes se perdorimit civil te lendes plasese”	ligjin	Eksplozivet	Miratimi i procedures se dhenjes se lejes subjekteve private per perdorimin civil te lendes plasese	M.E.T.E, R.I.SH.M
41.	Ligji nr.7643,date 2.12.1992 “Per Inspektoratin Sanitar Shtetor”	ligjin	Shendetesi	Ligji percakton autoritetin me te larte te kontrollit sanitar,organizimin detyrat dhe pergjegjeiste e tij ne qender dhe ne rrethe.	M.SH I.S.SH
42.	Ligji nr.8464,date 11.03.1999 “Per Standartizimin”	ligjin	Ekonomi	Ligji vendos rregulla per procedurat e hartimit e te miratimit te standarteve shqiptare dhe per percaktimin e statusit te tyre,akreditimit te laboratoreve te provave,organizmave certifikuese te produkteve,sistemeve te cilesise,personelit dhe organizmave inspektuese me qellim qe te sigurohet nje nivel I caktuar cilesise,me perjashtim te rasteve kur ne ligj percaktohet ndryshe	M.E.T.E

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

43.	V.K.M.nr.323,date 8.07.1999 “Per pergatitjen,pershtatjen dhe zbatimin e rregullave teknike dhe procedurave per vleresimin e konformitetit me rregullat teknike dhe standartet”	Ekonomi	Pergatitja,adoptimi dhe zbatimi i rregullave teknike,procedurat per vleresimin e konformitetit nga ministrite dhe institucionet e tjera qendrore,njohjen e saj,Sistemet nderkombetare dhe rajonale te vlereimit te konformitetit.	M.E.T.E Ministrite e Linjes
44.	V.K.M nr.371,date 4.08.1999 “Per kriteret dhe kompetencat ne fushen e standartizimit,certifikimit dhe akreditimit.	Ekonomi	Vendos kriteret baze per standartizimin dhe kometencat,kriteret per certifikim dhe akreditim.Ne vendim jepen dhe prioduketet e importit te cialt mbeten standarte te detyruara ne grupe.Nder keto grupe perfshihen edhe lendet kimike .	M.E.T.E Ministrite e Linjes
45.	V.K.M nr.233,dt.11.05.2000 “Per mbeshtetjen e sherbimit te kontrollit te pleherave kimike nga organet e ruajtjes se rendit”	Ekonomi	Percaktohen rastet kur organet e rendit ndihmojne sherbimin e kontrollit te pleherave kimike per ushtrimin e veprimtarise se tij.	M.B M.B.U.M.K
46.	Projektligji “Per mbrojtjen e shtreses se Ozonit”	Mjedisi	Ligji ka si objekt:Administrimin dhe kontrollin e substancave ozonholluese, me synim pakësimin gradual të tyre deri në plotësimin e detyrimeve që lindin nga Protokollin i Montrealit.	M.M.P.A.U

Shenim :

- M.M.P.A.U. -Ministria e Mjedisit,Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave
- M.SH -Ministria e Shendetesise
- M.E.T.E -Ministria e Ekonomise ,Tregetise dhe Energjitikes
- M.B.U.M.K -Ministria e bujqesise,Ushqimit dhe Mbrojtjes se konsumatorit
- M.P. Ç.S.SH.B-Ministria e Punes ,Ceshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta
- I.SH.P -Instituti Shendetit Publik
- M.B -Ministria e Brendshme
- M.P.P.T.T -Ministria e Puneve Publike,TransportitdheTelekomunik
- K.M. -Keshilli I Ministrave
- K.K.U -Keshilli Kombetar i Ujrave
- I.SH.N.G -Inspektoriati shtetror I Naftes dhe Gazit
- R.I.SH.M -Reparti I Inspektim Shpetimit Miniera
- I.S.SH -Inspektoriati Sanitar Shteteror

4.2. Permbledhje e Problemeve te Instrumentave Ligjore,Te Cilat i Adresohen Administrimit te Kimikateve.

Problemet e instrumentave ligjore ,qe ju referohen administrimit te kimikateve mund te ndahen ne dy grupe :

1. Ligjet
2. Vendimet e Keshillit te Ministrave
3. Rregullat te vecanta nga ministrite ose institucionet e tjera.

4.2.1 Ligjet

4.2.1.1. Ligji Nr.9108,date 17.07.2000 “Per Substancat dhe Preparatet Kimike”

Numuri dhe sasia e substancave dhe preparateve kimike ne perdorim apo mbetje, ne vendin tone deri me sot eshte i panjohur plotesisht.Nga ana Ministrise se Industrise dhe Energjetikes (M.I.E)

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

gjate vitit 2000 u realizua nje projekt per inventarizimin e lendeve kimike, gjendje ne te gjitha ndermarrjet ne varesi te saj.

Nga te dhenat qe disponohen nje sasi e konsiderushme e kimikateve ne shumicen e tyre stoqe, jane shume toksike ,toksike qe shkaktojne deme afat shkurter e afat gjate ne shendetin e njerezve dhe mjedis. Problem serioz ka qene mungesa e kuadrit te nevojshem ligjor dhe informacionit te nevojshem per keto substanca dhe preparate qe importohen , tregetohen, perdoren dhe administrohen nga subjektet private dhe shtetore.

Hartimi i kuadrit te ri ligjor, pershtatja e legjislacionit ekzistues me direktivat e BE ka qene dhe ngelet nje nga detyrat prioritare te Qeverise dhe te gjitha institucioneve sipas veprimtarive qe ato kryejne .Ne kete kuader, gjate vitit 2000 duke pare situaten e rende qe ekzistonte ne ndermarrjet ne varesi te ish.Ministrise se Industrise dhe Energjitikes, lidhur me administrimin e lendeve kimike ne pergjithesi dhe vecanti te lendeve kimike te rrezikshme, pervec kryerjes se inventarizimit te tyre dhe disa masave urgjente per identifikimin ,riambalazhimin dhe grumbullimin e nje pjese te tyre ne nje magazine te sigurte,ju vu detyre Institutit te Studimeve dhe Projekttimeve te Teknologjise Kimike (Institutit te Mjedisit) per te hartuar nje projektligj per substancat dhe preparatet kimike,ne zevendesim te Urdhreses te Keshillit te Ministrave Nr.4,date 15.09.1976 dhe nje VKM Nr.26,date 31.01.1994.

Hartimi i ketij ligji ne perputhje me direktivat e BE dhe ne pershtatje me legjislacionin e vendeve te zhvilluara ka per qellim:

- Ti hapte rruge zhvillimit te industrise kimike mbi nje baze ligjore bashkekohore.
- Te krijoje kushte te sigurta per administrimin e te gjitha kimikateve dhe preparateve kimike qe importohen, eksportohen ,prodhohen, ruhen dhe perdoren ne vendin tone.
- Te ndaloje futjen ne vend te substancave dhe preparateve kimike pa i regjistruar ato me perpara, kontrolluara dhe marre lejen nga autoritetet kompetente te ngarkuara me ligj.
- Te parandaloje veprimet terroriste te individeve apo grupeve te vecanta per te perdorur lendet kimike te rrezikshme qe jane gjendje ne ndermarrjet e ndryshme shtetore apo private, qe nuk ruhen sipas rregullave te caktuara.

Aktualisht eshte llogaritur qe ne sistemin e Ministrise se Ekonomise,Tregetise dhe Energjitikes ka gjendje, ne ruajtje rreth 3500 ton kimikate nga te cilat 1500 ton te rrezikshme per shendetin dhe mjedisin.Nuk dihet sakte sa substanca dhe preparate kimike futen ne treg, prodhohen ,perdoren ne industri apo eksportohen.

Ne kete aspekt siguria ne pune nga perdorimi i lendave kimike dhe preparateve perben nje objekt te rendesishem per parandalimin e rreziqeve qe mund te vijne nga keq manaxhimi i tyre.Sot nuk ka,dhe nuk ka patur asnje strukture te shtetit ,apo autoritet kompetent te vendosur me ligj per administrimin e ketyre kimikateve.

Ligji i miratuar zgjidh kete boshllek ligjor te vendit tone. Ai eshte i ndertuar mbi bazen e legjislacionit te ri te disa shteteve te zhvilluara si Cekise, Frances, Finlandes dhe Gjermanise. Ligji hedh bazat me themelore e te rendesishme per administrimin e ketyre substancave por ai ka nevojte te kompletohet me nje seri aktesh te tjera ligjore dhe nenligjore qe te permbledhura keto do te perbenin "Aktin e Kimikateve" me te cilen punojne sot shtetet me te zhvilluar evropiane.Aktualisht jane te programuar dhe po punohet per hartimin e disa rregulloreve te domosdoshme per administrimin e kimikateve.

Ligji permban 32 nene 2 anekse dhe eshte i ndare ne 11 krere.Per me shume shiko

www.albchemicals.com.al

Kreu I, permban dispozita te pergjithshme te cilat perfshijne qellimin dhe objektin e ligjit,perkufizimet dhe klasifikimin e substancave e preparateve ne baze te vetive.Qellimi i ligjit eshte te rregulloje administrimin e lendeve te rrezikshme me qellim mbrojtjen e shendetit dhe mjedisit.

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

Objekti i këtij ligji është vendosja e të drejtave dhe detyrimeve të personave juridike dhe fizike në përcaktimin e vetive dhe klasifikimin e substancave dhe preparateve kimike për regjistrimin, inventarizimin, njoftimin, menaxhimin, tregëtimin dhe të përcaktoje juridiksionin e zyrave të administratës për marrjen e masave për mbrojtjen e jetës, të shëndetit dhe mjedisit. Kreu është ndërtuar mbi bazën e direktivave të KE në klasifikimin e vetive të substancave dhe preparateve kimike.

Kreu II, parashikon rregulla për klasifikimin dhe testimin e substancave dhe preparateve kimike para se ato të hidhen në treg. Testimi do të bëhet me metoda që plotësojnë parimet e mbrojtjes së kafshëve eksperimentale të cilat vendosen me urdher nga Ministritë kompetente. Sipas ligjit: Ministria e Mbrojtjes është organi kompetent për substancat dhe preparatet që zoterojnë veti eksplozive dhe oksiduese.

Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës është organi kompetent për substancat dhe preparatet që zoterojnë veti ekstremisht të ndezshme, shumë të ndezshme dhe të ndezshme.

Ministria e Shëndetësisë është organi kompetent për substancat dhe preparatet që zoterojnë veti shumë helmuese, helmuese, të demshme për shëndetin, korrozive, irrituese, sensibilizuese, kancerogjene, mutagjene, dhe të demshme për riprodhimin.

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave është organ kompetent për substancat dhe preparatet që zoterojnë veti të rrezikshme për mjedisin.

Testimi i substancave për vetitë e tyre do të bëhet nga laboratore të kualifikuara të testuar për këtë qëllim nga ministritë kompetente.

Kreu III, përcakton detyrimet e prodhuesit ose importuesit për regjistrimin e substancave dhe preparateve që hedhin në treg, aplikimin për regjistrim dhe informacioni plotësues i nevojshëm që detyron prodhuesit dhe importuesit t'ja paraqesin organit kompetent.

Kreu IV, bën fjalë për rregulla e procedura për vlerësimin e rrezikut të substancave dhe preparateve të rrezikshme që vendosen nga organet kompetente, kushtet e përgjithshme për menaxhimin e tyre nga prodhuesit ose importuesit. Në këtë kapitull jepen rregullat kryesore për marrjen e autorizimit dhe hedhjen në treg të substancave dhe preparateve të rrezikshme.

Kreu V, parashikohen rregulla dhe detyrime për prodhuesin ose importuesin lidhur me shitjen e substancave të rrezikshme. Këtu parashikohen rregulla për substancat që ndalohen të hidhen në treg dhe për substancat që kufizohet hedhja në treg. Lista e këtyre substancave propozohet nga Ministria e Mjedisit dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Kreu VI, trajton autorizimet që jepen për menaxhimin e substancave dhe preparateve të rrezikshme, kërkesat për kualifikim të personave që merren me biznes dhe menaxhimin e substancave të rrezikshme si dhe detyrat e Ministrive për dënjjen e autorizimeve.

Ministritë e ngarkuara japin ose heqin autorizimet në bazë të aplikimit dhe të disa kushteve, të përcaktuara që duhet të plotësojnë personat juridike dhe fizike për menaxhimin e substancave dhe preparateve të rrezikshme.

Kreu VII, trajton importin dhe eksportin e substancave dhe preparateve të rrezikshme, kushtet që duhet të plotësojnë importuesit dhe eksportuesit e këtyre substancave dhe nevoja për aplikim dhe miratim nga ministritë kompetente.

Kreu VIII, parashikohen rregulla, detyrime për regjistrimin dhe njoftimin e llojit, sasise, vetive të substancave dhe preparateve të rrezikshme. Regjistrimet bëhen të vecanta për çdo biznes, mënyra dhe detajet e regjistrimit dhe njoftimit përcaktohen nga ministritë kompetente. Agjencitë Rajonale të

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

Mjedisit dhe njesite vendore te mbrojtjes se shendetit percaktojne kushtet speciale per kryerjen e aktiviteteve te cilat perdorin substanca te rrezikshme.

KreuIX, jep organizimin e administrates shtetore ne fushen e menaxhimit te substancave dhe preparateve te rrezikshme si dhe detyrat e strukturave shtetore te ngarkuara nga ky ligj si organe kompetente.Nje rol te rendesishem ligji ju ngarkon organeve vendore dhe administrates doganore.

KreuX, percakton sanksione ne rastin e shkeljeve te neneve te vecanta te ligjit per te cilat autoritetet vendore te ngarkuara me ligj kane rolin kryesor ne vendosjen e tyre.Gjobat variojne nga 500.000 lek deri ne 50.000.000 lek ne vartesi te shkeljes.Vendimet per apelim kunder vendimeve per venjen e gjobave merren nga Ministrite kompetente.

KreuXI, parashikon dispozita tranzitore dhe te fundit ,ku jane te ndara afatet e hyrjes ne fuqi te kreteve te vecante.Po keshtu ne kete kre jepen detyrimet e personave juridike dhe fizike qe kryejne biznes me substanca dhe preparate te rrezikshme per plotesimin e kushteve te autorizimeve sipas ketij ligji.Ne kete kre jepen dhe aktet e tjera ligjore dhe nenligjore te nevojshme qe duhet te pergatiten nga institucionet e ndryshme te shtetit ne zbatim te ketij projektligji.

Ne ligj nje rendesi e vecante i kushtohet ngritjes se Zyres se Administrimit te Kimikateve te Rrezikshme ne varesi te Ministrise se Mjedisit.

Ngritja e kesaj Zyre ne shkalle kombetare eshte nje kerkese e domosdoshme jo vetem e ketij ligji por dhe kerkese e direktivave te BE dhe e legjislacionit te vendeve anetare te BE si dhe strukturave nderkombetar per administrimin e kimikateve dhe preparateve te rrezikshme.

Miratimi i ligjit ka plotesuar boshllekun ligjor ne fushen e administrimit te substancave dhe preparateve kimike dhe ka hapur rrugen,hartimit te akteve te tjera ligjore dhe nenligjore per administrimin e kimikateve ne pergjithesi dhe atyre te rrezikshme ne vecanti ne perputhje me Direktivat e BE.

4.2.1.2. Ligji Nr.8934,date 5.09.2002 “Per Mbrojtjen e Mjedisit”

Eshte ligji baze, i cili rregullon mardhenjet ndermjet njeriut dhe mjedisit,mbron perberesit e mjedisit dhe proceset mjedisore,siguron kushtet per zhvillimin e qendrushem. Ligji nuk rregullon direkt aktivitetet ne lidhje me kimikatet por indirekt dhe me te njejten pergjegjesi ,ai duke ju permbajtur qellimit te tij ne kapituj dhe nene te vecanta parandalon impaktet e tyre ne mjedis qe mund te vijne nga keqadministrimin .

Neni 2 i Ligjit shprehet: -Mbrojtja e mjedisit nga ndotja dhe demtimi perben perparesi kombetare dhe eshte e detyrueshme per te gjitha organet shtetore,personat fizike dhe juridike,vendas e te huaj,qe ushtrojne veprimtarine e tyre ne territorin e Republikes se Shqiperise etj..

Ligji ne kapituj te vecante permend Vleresimin i Ndikimit ne Mjedis (V.N.M),Lejen per veprimtarite qe ndikojne ne mjedis,Parandalimin dhe kufizimin e ndotjes se mjedisit,Monitorimi dhe te dhenat,Kontrolli mjedisor,Detyrat e organeve shtetore per mjedisin,Roli i publikut dhe Sanksionet.Megjithese nuk permed kimikatet ne formulimet e neneve te ketyre kapitujve,ai mbron mjedisin nga ndikimi i tyre por njekohesisht i hap rrugen zhvillimit te sigurte te cdo veprimtarie qofte edhe te rrezikshme per njeriun dhe mjedisin.

Duke kerkuar marrjen e nje sere masave nga subjektet qe zhvillojne aktivitet dhe vendosur kompetencat e organeve shtetore per parandalimin e impakteve ne mjedis, Ligji me sanksionet qe parashikon nuk le menjane dhe veprimtarite me kimikatet pa perjashtim.

4.2.1.3.Ligji nr.9092,date 3.07.2003 Per zbatimin e “ Konventa per ndalimin e zhvillimit,te prodhimit, magazinimit dhe perdorimit te armeve kimike dhe per shkaterimin e tyre”

Ligji percakton autoritetin,pergjegjesite,krijimin dhe funksionimin e organeve te nevojshme per zbatimin e detyrimeve,qe rrjedhin nga Konventa per Ndalimin e Armeve Kimike (KNAK) ne

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

Republikën e Shqipërisë si shtet pale e saj. Ministri i Mbrojtjes është autoriteti shtetëror i Republikës së Shqipërisë për zbatimin e Konventës. Prandaj Ministrisë së Mbrojtjes krijohet Bordi i Keshilltareve si organ këshillimor për çështjet e konventës, përbërja e të cilit propozohet nga ministri i Mbrojtjes dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave. Sipas nenit 5 të këtij ligji “çdo person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, që prodhon, zoteron, përdor ose transferon lëndë kimike, importon dhe /ose eksporton lëndë me përberje kimike të përcaktuara në tabelat 1, 2 dhe 3 që i bashkelidhen këtij ligji, si dhe zotuesit e impianteve të prodhimit të këtyre lëndëve janë subjekt deklarimi dhe verifikimi nga autoriteti shtetëror, për të siguruar përputhshmërinë e veprimtarisë së tyre me Konventën dhe me këtë ligj.” Në ligj jepen rregullat për deklarim dhe marrëjen e licencës.

Në nenin 17 të ligjit thuhet “Në Ministrinë e Industrisë dhe Energjitikës krijohet dhe funksionon, si organ kontrolli, struktura e Inspektimit Shtetëror.”

4.2.1.4. Ligji Nr.8990, date 23.01.2003 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedisë”

Synon të sigurojë vlerësim të përgjithshëm dhe në kohë të ndikimeve mjedisore, të projekteve ose veprimtarive që kërkojnë të zbatohen, duke parandaluar dhe zbutur ndikimet negative në mjedis. (neni 1 pika 2). Këto projekte apo veprimtari që i nënshtrohen procesit të V.N.M jepen në shtojcat 1 dhe 2 të nenit 4 të këtij ligji. Përse u përket prodhimit të kimikateve të ndryshme që i nënshtrohen V.N.M jepen në shtojcën 1 pika 22 nga germa (a –dh) dhe pika 23, 34, 39, 40 dhe 41. Ligji përcakton rregullat, procedurat, afatet, të drejtat dhe detyrat për të identifikuar, saktësuar dhe vlerësuar ndikimet e drejtpërdrejta dhe të terthorta të veprimtarisë në mjedisin ku zbatohen.

4.2.1.5. Ligji Nr.8897, date 16.05.2002 “Për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja”,

Garanton të drejtën e shtetësive për të jetuar në një mjedis me ajër të pastër, duke mbrojtur shëndetin e njeriut, faunën, florën dhe vlerat natyrore e kulturore të mjedisit shqiptar. Ligji përcakton dhe klasifikon burimet e ndotjes, treguesit mjedisore baze të gjendjes së ajrit (përmbajtjes të lëndëve të ngurta, të oksidit të squfurit, të oksidit të karbonit, të ozonit, të plumbit/aerosol/ dhe oksideve të azotit). Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrit të Mjedisit miraton normat e perkoheshme të shkarkimeve në ajër, bazuar në normat e Bashkimit Europian.

Në kapitullin e 4 të ligjit jepen detyrimet për mbrojtjen e ajrit për personat fizikë e juridikë si dhe detyrimet kryesore të operatoreve të burimeve të palevizueshme të ndotjes. Normat e shkarkimeve nga burimet e levizueshme miratohen me udhëzim të përbashkët nga Ministri i Mjedisit dhe Ministri Transporteve.

Zonat me mbrojtje të vecante shpallen nga Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrit të Mjedisit dhe Ministrit të Shëndetësisë. Për ndotjen e ajrit, operatorët e burimit të ndotjes paguajnë takse shkarkimesh, sipas sasisë dhe tipit të ndotesave të shkarkuar, sipas përcaktimeve në ligjin nr.8435, date 28.12.1998 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”.

4.2.1.6. Ligji Nr.8906, date 06.06.2002 “Për Zonat e Mbrojtura”, ka për qëllim të sigurojë mbrojtje të vecante të përbërësve të rëndësishëm të rezervave natyrore, të biodiversitetit dhe të natyrës në teresi nëpërmjet krijimit të zonave të mbrojtura. Në nenin 6 të këtij akti, pika 2 germa dh dhe g, pika 3 germa d dhe neni 9 pika 2b ndalojnë përdorimin apo depozitimin e kimikateve të ndryshëm në Zonat e Mbrojtura (Parku kombëtar).

4.2.1.7. Ligji Nr.9010, dt 13.02.2003 ‘Për Administrimin Mjedisor të Mbetjeve të Ngurta’ Synon mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit nga ndotja dhe dëmtimi prej mbetjeve të ngurta, nëpërmjet administrimit mjedisor të tyre në çdo fazë, përfshi krijimin, grumbullimin, ndarjen, ruajtjen, transportin, riciklimin, përpunimin dhe asgjësimin, të cilat çojnë në pakesimin e mbetjeve dhe zvogëlimin e ndikimeve të tyre të rrezikshme e të demshme. Ligji nuk është i zbatueshëm sipas nenit 3 pika 2 për mbetjet e rrezikshme, radioaktive, berthamore dhe eksplozive, administrimi i të cilave rregullohet me ligje të vecante.

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

Sipas nenit 10 germa c zoteruesit e mbetjeve duhet të sigurojnë ndarjen e mbetjeve të rrezikshme prej mbetjeve të tjera, dhe ruajtjen e sigurte të mbetjeve, për të cilat nuk ekzistojnë menyrë të pershtatshme përpunimi dhe asgjësimi. Në vijim të këtij neni germa d zoteruesit e mbetjeve duhet të sigurojnë që grumbullimi i mbetjeve të rrezikshme të bëhet i vecuar dhe ato të ruhen përkoheqsisht në mbajtës speciale, paketohen, etiketohen, dhe transportohen në përputhje me rregullat dhe standartet nderkombetare të miratuara në Republikën e Shqipërisë. Shpenzimet për të gjitha këto përballohen nga zoteruesit e mbetjeve.

Sipas nenit 26 të këtij ligji, në Republikën e Shqipërisë ndaloheq importimi i mbetjeve për ruajtje, depozitim ose asgjësim. Monitorimi i mbetjeve është pjesë e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit dhe kryheq sipas kërkesave të tij. Inspektorati Bashkiak dhe Inspektorati Sanitar Shtetëror kontrollojnë zbatimin e rregullave dhe të kërkesave për krijimin, grumbullimin, ruajtjen, transportimin, përpunimin dhe asgjësimin e mbetjeve urbane, të mbetjeve të ndertimit dhe të mbetjeve të vëllimshme. Inspektorati i Mjedisit kontrollojnë zbatimin e rregullave dhe të kërkesave të vendosura në Lejen Mjedisore të zoteruesit të mbetjeve.

4.2.1.8. Ligji Nr.9115, date 24.07.2003 “Për Trajtimin Mjedisor të Ujërave të Ndotura”

Ka për qëllim të mbrojq mjedisin dhe shëndetin e njeriut, nga ndikimet negative të ujërave të ndotura, duke përcaktuar rregullat e trajtimit mjedisor të tyre, si dhe detyrimet e shkarkësive të ujërave të ndotura. Ligji në nenin 4 përcakton detyrat e Ministrisë së Mjedisit dhe të organeve shtetërore qëndrore dhe vendore sipas linjqes së vet që të bashkëpunojnë për :

-përcaktimin e teknikave ,teknologjqive dhe metodave me të mira për trajtimin e ujërave të ndotura, -hartimin e planeve, krijimin e kuadrit ligjqor bashkëkohor, përsosjen e rrëjqtit institucional përgjqgjes, sigurimin dhe përdorimin e frutshëm të mjeteve të nevojshme financiare si dhe kontrollin e vazhduhem të veprimtarive që shkaktojnë ndotje të ujërave dhe subjekteve të angazhuara për trajtimin e pastrimin e tyre.

4.2.1.9. Ligji Nr.9103, date 10.07.2003 “Për Mbrojqjen e Liqeneve Transkufitare”

Synon mbrojqjen mjedisore të liqeneve nderkufitare në gjendjen e tyre natyrore, garantimin e kushteve të pershtatshme për zhvillimin e jetes dhe të ekosistemeve në to, duke nxitur zhvillimin e veprimtarive të dobishme, në përputhje me kërkesat e zhvillimit të qëndrueshem dhe duke ndaluar veprimtarite që rrezikojnë. Për mbrojqjen e gjendjes natyrore të liqeneve nderkufitare të Republikës së Shqipërisë veprojnë të gjitha konventat, protokollet, marrëveshjet nderkombetare në të cilat Republika e Shqipërisë është pale.

Në nenin 11 pika 3 e këtij ligji thuhet :-Veprimtarite bujqësore të fermereve, që jetojnë në territorin e pellgjeve ujembledhës, marrin parasysh kërkesat e planit të menaxhimit të pellgurve, sidomos për mbrojqjen e tokës dhe për përdorimin e kimikateve.

Neni 14 pika 1a e këtij ndalon kategorikisht hedhjet ose depozitimet e lendeve dhe të mbetjeve të rrezikshme, depozitimet dhe hedhjet e mbetjeve të cdo llojq.

4.2.1.10. Ligji Nr.8905, date 06.06.2002 “Për Mbrojqjen e Mjedisit Detar nga Ndotja”

Ka për qëllim të mbrojq mjedisin detar nga ndotja dhe demtimet, parandalimin dhe shmangien e tyre, të shkeqtuara nga veprimtaria njerezore në det, e në zonën bregdetare, të cilat prishin cilësinë e ujqit, demtojnë burimet e detit e të bregdetit, rrezikojnë faunen dhe floren, kërcenojnë shëndetin e njeriut, si dhe vështiresojnë zhvillimin normal të veprimtarive në këte mjedis. Neni 2 pika 6 eligjqit përkufizon lendet e rrezikshme. Sipas këtij akti “Lendet e rrezikshme” janë lendet, që prodhimi, transporti, ruajtja, përdorimi ose shkarkimi i të cilave në mjedisin detar, si pasoje e vetive të tyre, demtojnë shëndetin e njeriut, cilësite e mjedisit detar, floren, faunen dhe ulin cilësite e jetesës.

Sipas nenit 6 ,pika 1

- a) në mjedisin detar ndaloheq hedhja e lendeve dhe mbetjeve të rrezikshme helmuese e plasese.
- b) hedhja e substancave dhe lendeve të përcaktuara në Aneksin I bashkelidhur këtij

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

ligji.

- c) derdhja e hidrokarbureve dhe e ujerave te ndotura.
- dh) transportimi i lendeve dhe mbetjeve te rrezikshme

Po sipas ketij neni pika 2-Mbeturinat e percaktuara ne Aneksin II qe i bashkelidhet ketij ligji,mund te hidhen ne det vetem me autorizim te Ministrit te Mjedisit.

4.2.1.11.Ligji nr.7643,date 2.12.1992 “Per Inspektoratin Sanitar Shteteror”

Ka te drejten (si organ ekzekutiv) per kontrollin e zbatimit te ligjeve dhe akteve nenligjore sanitare ne sektoret shteterore,private,veprimtarite e ndryshme te ushtruar nga persona fizike e juridike vendas dhe te huaj,ne objektet e meposhtme :

- objektet e prodhimit,ruajtjes,magazinimit,transportit e tregtimit te produkteve te te gjitha llojeve dhe ne te gjitha kategorite e punimeve minerare,
- ne objektet ku ushtrohen veprimtari socialkulturore,shendetesore,arsimore dhe kerkimore-shkencore,
- ne repartet dhe strukturat ne vartesi te Ministrise se Mbrojtjes,Ministrise se Rendit,ne pikat kufitare,portet,aeroportet,doganat si dhe ne mjetet e transportit tokesor, hekurudhor, detar e ajror vendas dhe te huaj.

Spas neni 13a te ketij ligji I.S.SH kontrollon lidhur me mbrojtjen e shendetit te punonjesve nga ndikimi i kushteve te pavorshme te punes,si ekspozimi ndaj lendeve toksike,rrezatimit,etj.

4.2.1.12.Ligji nr.7501,date 19.07.1991“Per Token”,amenduar me ligjin

nr.7715,dt.2.06.1993,nr.7763,dt.25.10.1993,nr.7855,dt.29.07.1994,nr.8753,dt.26.03.2001, ne neni 17 te tij ndalon kanalizimin dhe grumbullimin e mbeturinave industriale,minerare dhe ujrave me permbajtje kimike te demshme per bujqesine. Ndalohet hedhja dhe groposja ne toke e cdo lloj mbetje te rrezikshme te vendit ose te importit.

4.2.1.13. Ligji nr.7662,date 19.01.1993 “Per Sherbimin e Mbrojtjes se Bimeve”

ka si qellim mbrojtjen e bimeve e ne vecanti te bimeve bujqesore nga parazitet dhe shkaqet joparazitare,mbrojtjen e produkteve bimore nga organizmat demprurese,menjanimi i rreziqeve per shendetin e njerezve e te kafsheve,qe mund te vijne nga perdorimi i pesticideve dhe masat e tjera te mbrojtjes se bimeve,si dhe zbatimi i akteve juridike nderkombetare ne fushen e mbrojtjes se bimeve.

Ne kapitullin e IV te ketij ligji nga neni 25-41 flitet vetem per pesticidet.Sipas ligjit te gjitha pesticidet i nenshtrohen rregjistrimit nga ana e Ministrise se Bujqesise dhe Ushqimit ne bashkepunim me Ministrine e Shendetesise dhe Ministrine e Mjedisit.Organi me i larte shteteror per pesticidet eshte Komisioni Shteteror i Pesticideve([www.albchemicals](http://www.albchemicals.com)),i cili funksionon nepermjet mbedhjeve periodike dhe sekretarise se perhershme ne Drejtorine e Sherbimit te Mbrojtjes se Bimeve ne M.B.U.

Instituti i Mbrojtjes se bimeve,Instituti i Higjenes dhe Epidemiologjise dhe Instituti i Kerkimeve Veterinare jane te ngarkuar te ndjekin skemen e rregjistrimit te pesticideve dhe i paraqesinkomitetit te pesticideve propozimet perkatese.(neni 27). Tregtimi dhe importi i pesticideve behet me licence.Instituti i mbrojtjes se Bimeve eshte i ngarkuar per kontrollin cilesor te pesticideve.

www.albchemicals.com

4.2.1.15. Ligji nr.7796,date 17.02.1994 “Ligji Minerar i Shqiperise”

percakton mardheniet ndermjet shtetit dhe personave juridike dhe fizike me qellim qe te perftohen te drejtat minerare dhe te ekzekutohen aktivitetet minerare.Sipas neni 13 te ketij ligji ndalohet perdorimi i tokes ose punimeve nentokesore per depozitimin,hedhjen e mbeturinave toksike,radioaktive ose mbeturineve te tjera te kesaj natyre.

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

Nenet 91, 95,96,97,98 dhe 99 detyrojnë zoteruesin e lejes minerare të marre të gjitha masat për sigurimin e jetes dhe shëndetit të punonjesve dhe mbrojtjen e mjedisit në aktivitetin e hapjes ,shfrytezimit dhe mbylljes së minierës.

4.2.1.16. Ligji nr.7875,date 23.11.1994 “Per Mbrojtjen e Faunes se Eger dhe Gjuetie” për mbrojtjen e faunes së eger ndalon ushtrimin e gjuetisë me mjete jo të autorizuar për tipin e gjuetisë që ushtrohet,me mjete e menyra që përbejnë rrezik për njëzëzit,kafshët e shpendët , me anën e zjarrit,me materiale që marrin shpejt zjarr,me lende eksplozive dhe helmuese,te hapjes së gropave,me drite,me ajër e gaz të komprimuar dhe natën.

4.2.1.17. Ligji nr.7908,date 5.04.1995 “Per Peshkimin dhe Akuakulturen” i cili zbatohet në veprimtarinë e peshkimit dhe akuakultures që ushtrohet në ujrat dhe territrin e Republikës së Shqipërisë,në nenin 24 ndalon, dhe me nenin 39 pika B, denon, përdorimin e lendeve eksplozive,kimike e helmuese, i energjisë elektrike,te afta të trullojnë,paralizojnë ose vrasin organizmat ujorë edhe në kuadrin e veprimtarisë së akuakultures.

4.2.1.18. Ligji nr.8025,date 9.11.1995 “Per Mbrojtjen nga Rrezatimet Jonizuese” përcakton kushtet e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese për të gjithë veprimtaritë që kryhen me lëndë radioaktive dhe pajisje rrezatuese,për të mbrojtur punonjësit e ekspozuar profesionalisht ndaj rrezatimeve,popullatën dhe mjedisin në teresi nga rreziqet e mundshme të rrezatimeve.Spas ligjit të gjithë personat juridikë e fizikë që kryejnë veprimtari me pajisje ose përdor ,trajon lende radioaktive duhet të pajiset me licencë.

Në ligj përcaktohen strukturat kompetente të mbrojtjes nga rrezatimi.Autoriteti kompetent kombëtar që mbikqyr dhe siguron zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet është Komisioni i ngritur pranë Ministrisë së Shëndetësisë. Ligji përcakton detyrat dhe të drejtat e komisionit dhe zyres si organ ekzekutiv i mbrojtjes nga rrezatimi, në varesi të komisionit.

4.2.1.19. Ligji nr.8093,date 21.03.1996 “Per Rezervat Ujore” ,siguron ruajtjen,zhvillimin dhe shfrytezimin sa më racional të rezervave ujorë,te domosdoshme për jetën dhe për zhvillimin socioekonomik të vendit.Ai siguron shpërndarjen e drejtë të rezervave ujorë,mbrojtjen e rezervave ujorë nga ndotjet,shpërdorimet dhe harxhimet mbi nevojat faktike si dhe përcakton kuadrin institucional në nivel kombëtar e në nivel basenesh për drejtimin dhe administrimin e burimeve ujorë.Administrimi i burimeve ujorë në Republikën e Shqipërisë kryhet nga Këshilli kombëtar i ujit(KKU) dhe nga sekretariati teknik në nivel kombëtar,si dhe nga autoritetet e baseneve në nivel lokal e nga agjenci dhe organizma të tjera që mund të caktojnë KKKU.Në ligj përcaktohen detyrat dhe të drejtat e këtyre strukturave.

Në kreun, X-Zonat dhe Siperfaqet e Mbrojtura, nën 40 ligjit, ndalon të depozitohen apo shkarkohen ndotjet,ujrat e zeza,substancë kimike e toksike,te përdoren plehra kimike dhe pesticide në zonat e mbrojtjes së afert.

4.2.1.20. Ligji nr.8378,date 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” ,në kapitullin e V nga neni 54-63 bën fjalë për transportin e mallrave të rrezikshme dhe ngarkon K.M për nxjerrjen e akteve të nevojshme për zbatimin e ligjit.Pra ligji mbyll transportin e të gjitha lendeve të rrezikshme.

4.2.1.21.Ligji nr.8094,date 21.03.1996 “Per Largimin Publik te Mbeturinave” synon mbrojtjen e mjedisit urban nga ndotja me mbeturina si dhe largimin publik të tyre në brendësi të territoreve bashkiake e të komunave,sipas vijave kufizuese që janë në juridiksionin e çdo bashkie e komune.Ai synon gjithashtu disiplinimin e shërbimeve publike për pastrimin e mbeturinave të qyteteve (dorzimin,mbledhjen,fshirjen dhe grumbullimin brenda perimetrit të territoreve të

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

mesiperme. Sipas nenit 2 të ligjit të gjitha llojet e mbeturinave pas dorezimit të tyre janë prone shtetërore. Nuk futen në mbeturina sipas nenit 6 të ligjit vec të tjerave mbetjet radiaktive, mbetjet nga puna kerkimore dhe industria pas trajtimit e perpunimit të pasurive minerare, lëndet eksplozive dhe shperthyese, geryese etj.

4.2.1.22 Ligji nr.8531, date 23.09.1999 “Per pleherat kimike” mundeson kontrollin e pleherave kimike, të importit dhe të vendit, që qarkullojnë në tregun shqiptar, për të siguruar përdorimin e plehrave të sigurta e cilesore, në përputhje me kërkesat për ruajtjen e shëndetit të njerezve, të kafsheve, të bimeve për mbrojtjen e mjedisit dhe të konsumatorit.

Sherbimi i kontrollit të pleherave kimike është në vartësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe ushqimit. Ai organizohet dhe drejtohet nga Instituti i Sudimit të Tokave. Administratori dhe inspektorët për zbatimin e ligjit propozohen nga Drejtori i I.S.T. Numuri i punonjësve të sherbimit të kontrollit të pleherave përcaktohen me Vendim të Keshillit të Ministrave.

Ky sherbim sipas nenit 9 të ligjit, kryen kontrole për vlerësimin e cilësive së pleherave kimike para se ato të hidhen në treg, si dhe gjatë tregëtimit të tyre, për të garantuar sigurinë e jetës, të shëndetit dhe mosdotjen e mjedisit. Gjithashtu ai përcakton kushtet për magazinimin dhe ruajtjen e pleherave kimike.

Në ligj përcaktohen detyrimet e subjekteve që prodhojnë apo tregetojnë plehera kimike.

Organet e ruajtjes së rendit sipas nenit 19 të ligjit, me kërkesën e sherbimit të kontrollit të pleherave kimike, e ndihmojnë këto sherbim në ushtrimin e funksioneve të caktuara në ligj dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.

4.2.1.23 Ligji nr. dt. “Per mbrojtjen e shtreses së Ozonit” ka përcaktuar rregullat për administrimin, deri në heqjen nga përdorimi, të substancave ozonholluese, si dhe produkteve që përmbajnë këto substanca, ose janë prodhuar me to.

Ai ka si objekt: Administrimin dhe kontrollin e substancave ozonholluese, me synim pakësimin gradual të tyre deri në plotësimin e detyrimeve që lindin nga Protokollin e Montrealit. Përcaktimin e kërkesave që lidhen me prodhimin, eksportin, importin, hedhjen në treg, përdorimin, mbledhjen, depozitimin, riciklimin, rikuperimin dhe shkatërrimin e substancave ozonholluese.

4.2.2 Vendime të Keshillit të Ministrave

4.2. 2.1. V.K.M nr. V.K.M nr.824, dt.11.12.2003 “Per klasifikimin , ambalazhimin etiketimin, dhe ruajtjen e substancave kimike”, mbështet kuadrin e politikave të qeverisë për hartimin e legjislacionit të ri në kushtet aktuale të vendit, me anën e pershtatjes progresive të legjislacionit të komunitetit evropian, si një nga kushtet për integrimin e vendit të tone në strukturat evropiane. Mbas hartimit të ligjit nr.9108, date 17.7.2003 “Per substancat dhe preparatet kimike” plotësimi i tij me akte nenligjore si dhe ngritja e strukturave të nevojshme për regjistrimin dhe kontrollin, krijon kushte të sigurta për administrimin e të gjitha substancave dhe preparateve kimike dhe në vecanti atyre të rrezikshme, konform rregullave të vendosura me kohë, nga vendet e zhvilluara të rajonit, si dhe Direktivave të BE për substancat kimike.

Në këto kuader Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës, në vijim të punës së bërë për hartimin e ligjit baze për substancat dhe preparatet kimike dhe në zbatim të pikës 4 të nenit 7 të ligjit nr.9108, date 17.7.2003, me qëllim të eliminimit të pengesave në implementimin e këtij ligji, duhet të ndermarre hartimin e një sere aktesh nenligjore, për administrimin e substancave dhe preparateve të rrezikshme.

Vendimi ka si qëllim, të vendosë rregulla në klasifikimin, ambalazhimin, etiketimin dhe ruajtjen e substancave dhe preparateve kimike të rrezikshme në përputhje me rregullat nderkombetare. Ai synon, krijimin e kushteve të sigurta për administrimin e të gjitha kimikateve dhe preparateve kimike që importohen, eksportohen, prodhohen, tregëtohen, perdoren dhe ruhen në vendin tone.

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

Per me shume informacion shiko www.albchemicals.com.al

Vendimi eshte bazuar ne Direktivat e BE, 67/548/EEC dhe 79,83,88,92,93, ne ligjin italian, etj.Vendimi perbehet nga 8 krere dhe 3 anekse te permbledhura ne 52 faqe.

Ne kreun 1 dhe 2, te vendimit, jepen dispozita te pergjithshme, objekti dhe perkufizimi i simboleve dhe termave nderkombetare ne fushen e administrimit te substancave dhe preparateve kimike.

Ne kreun 3, jepen parimet nderkombetare te klasifikimit te substancave dhe preparateve kimike sipas vetive fiziko-kimike, vetive toksikologjike, ne baze te efekteve specifike ne shendetin e njeriut, sipas efekteve ne ndotjen e mjedisit dhe se fundi ne nje aneks te vecante jepet klasifikimi dhe vleresimi i substancave dhe preparateve te rrezikshme sipas renditjes se numurit rendor te elementit.

Kreu 4, ben fjale per kerkesat qe duhet te plotesojne prodhuesit apo importuesit per ambllazhimin e substancave dhe preparateve kimike te rrezikshme, para se ato te hidhen ne treg. Kerkesat kane lidhje me qendrusherine e ambllazhit, hermecitetin dhe shenjat paralajmeruese te rrezikut te substancave dhe preparateve te rrezikshme.

Ne kreun 5 dhe 6, jepen rregulla per etiketimin e substancave dhe preparateve te rrezikshme, para se ato te hidhen ne treg. Ne kete kre, jepen rregulla per vendosjen e etiketes, simbolet qe perdoren dhe dimesionet qe duhen perdorur sipas kapacitetit te ambllazhit dhe disa parashikime te vecanta ne lidhje me etiketimin e preparateve specifike, sic jane preparatet e klasifikuara te rrezikshme per publikun e gjere, ato te destinuara per sperkatje, si dhe per substancat ,qe permbajne frazen R-33, R-64 dhe elemente te tjere shume te rrezikshem.

Ne kreun e 7, jepen rregulla te pergjithshme per ruajtjen e kimikateve ndertimin e magazinave ,administrimin dhe mbikqyrjen e tyre.

Ne kreun 8, jepen dispozita te fundit dhe tranzitore, te cilat kane per synim, realizimin e afatit te hyrjes ne fuqi te ligjit per substancat dhe preparatet kimike.

Ne aneksi nr.1 jepet natyra e rreziqeve te substancave dhe tregusave te ndryshme, duke filluar nga R-1 deri R-65 dhe kombinimet e treguesit me simbolin R.

Aneksi nr.2, jep rregullat e sigurise, duke perdorur simbolin S dhe frazat e ndryshme te kombinuara te saj.

Ne aneksin nr.3 jepet klasifikimi i substancave dhe preparateve kimike sipas numurit rendor te elementit.

Miratimi i vendimit plotesoj boshllekun ligjor, qe ekziston ne pergjithesi ne administrimin e substancave dhe preparateve kimike te rrezikshme.

Ky vendim, sebashku me Urdheresen nr.1, date 21.08.1998 te Keshillit te Ministrave “Per rregullat e klasifikimit, emertimit dhe transportit rrugor te mallrave te rrezikshme”, jane akte te rendesishme, te harmonizuara me njera tjetren dhe me Direktivat e BE dhe do te sherbejne implementimit te ligjit nr.9108, date 17.7.2003 “Per substancat dhe preparatet kimike”.

4.2. 2.2 Urdheresa nr.1, dt.21.8.1998 e Keshillit te Ministrave “Per rregullat e klasifikimit, emertimit dhe transportit rrugor te mallrave te rrezikshme” eshte i mbeshtetur ne ne Ligjin nr.8308, date 18.03.1998 “Per transportet rrugore” neni 54 dhe 57. Vendimi perbehet nga IX krere dhe 3 Anekse, Per me shume informacion shiko www.albchemicals.com.al

qe ne menyre te permbledhur po i permendim me poshte :

Kreu I, jepen dizpozita te pergjithshme.

Kreu II, Klasifikimi i mallrave te rrezikshme, i ndan te gjithe mallrat ne 9 klasa ne perputhje me konventat nderkombetare dhe marveshjen europiane te transportit rrugor nderkombetar te mallrave te rrezikshme (ADR). Po keshtu ne kete kre jepet dhe ndarja e klasave ne grupe te vecanta. Ne Aneksi 1qe ka lidhje me kete kre ,jepet lista e detajuar e mallrave te rrezikshme per cdo klase, te hartuar ne perputhje me rekomandimet e Kombeve te Bashkuara dhe marveshjen europiane ADR.

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

Kreu III, Idnetifikimi dhe shenimi i mallrave të rrezikshme nën fjalë për detyrimin e identifikimit të mallrave të rrezikshme në të gjithë dokumentacionin e ngarkesë, për skedën individuale të identifikimit dhe modelin e skedës që jepet në Aneksin 2. Gjithashtu flitet për rregullat që duhet të zbatohen për ambalazhimin dhe shenimet në ambalazh.

Kreu IV, Nisja dhe Pritja e mallrave të rrezikshme jep detyrimet e nisesit të mallit të rrezikshëm, të transportuesit të mallit dhe detyrimet e pritesit. Në këtë kre jepen dhe rregulla për importin dhe eksportin e mallrave me transport automobilistik.

Kreu V, Ambalazhi flitet për karakteristikat e ambalazhit, miratimin e tij në DPS dhe për klasa të vecanta jepen rekomandime speciale duke i ndarë ambalazhet në tre grupe mallrash. Po në këtë kre flitet dhe për provat që duhet t'ju bëhen ambalazheve që do të përdoren për transportin e mallrave të rrezikshme e në vecanti provave të autoboteve kur malli është në gjendje të lenget.

Kreu VI, Rregulla për ngarkim-shkarkimin e mallrave të rrezikshme jepen rregulla të hollësishme që duhet të kihen parasysh nga drejtuesit i subjektit që kryen ngarkim shkarkimin për instruktimin e punonjësve që do të merren, plotësimin e kushteve dhe me mjete mbrojtëse dhe mënyrën e trajtimit të këtyre veshjeve pas përfundimit të procesit të punës.

Kreu VII, Shoqërimi i ngarkesave të rrezikshme gjatë transportimit, ju ve detyre subjekteve, portit, stacionit hekurudhor që merren me transportin për shoqërimin e mallrave të rrezikshëm me punonjës të kualifikuar e që kanë njohuri të plota mbi rrezikshmerinë e këtyre mallrave dhe që janë në gjendje të zhdëkin pasojat, në rast se gjatë rrugës prishet ambalazhi, derdhet etj. Po kështu në këtë kre jepen udhëzime për shoqërimin e mallrave të klasave të ndryshme. Rëndësi i kushtohet kushteve që duhet të plotësojë automjeti që transporton mallrat e rrezikshme.

Kreu VIII, Transporti i mallrave të rrezikshme, vendos si kusht licensimin e automjeteve të subjekteve private ose shtetërore që kryejnë transport të mallrave të rrezikshme si dhe kushtet që duhet të plotësojnë automjetet e tyre. Drejtuesit e automjeteve me mallrat e rrezikshme duhet të jenë pajisur me dëshmi aftësie profesionale për grupin e mallrave që transportojnë. Automjeti transportues duhet të jetë i pajisur me mjetet e nevojshme të ndihmes së parë etj. Në këtë kre jepen dhe udhëzime të përgjithshme për raste të ndalimit, qëndrimit apo parkimit të automjetit.

Kreu IX, Dispozita të fundit dhe tranzitore, nën fjalë për përgjegjësinë e institucioneve shtetërore, të drejtën e lejeve për transportin e mallrave të ndara sipas klasave dhe domosdoshmerinë kontrollit të gjendjes teknike të automjeteve, pa dokumentin e verifikimit të gjendjes teknike nuk mund të jepet asnjë lloj leje transporti. Në këtë kre jepen gjithashtu dhe disa detyra për Ministrinë e ngarkuar në këtë vendim për hartimin e udhëzimeve të vecanta. Në Aneksi 3 të këtij vendimi jepen modelet e etiketës sipas klasave të rrezikut.

4.2.2.3. V.K.M nr.26, date 31.01.1994 “Për Mbetjet e Rrezikshme dhe Mbeturinat”, jep perkufizimin e “Mbetjes së rrezikshme” dhe të “Mbeturines”. Sipas këtij Vendimi mbeturinat e ndryshme që përpunohen me anën e teknologjive prodhese bashkëkohore, lejohen të importohen për përfitimin e lendeve ose materialeve të dobëdhme, me kusht që nga transporti, depozitimi dhe përpunimi në territorin e vendit tone, këto mbeturina të mos ndikojnë negativisht në shëndetin e njeriut dhe mjedisin rrethues.

Në Aneksin nr.1 të vendimit janë renditur mbeturinat që lejohen të importohen në vendin tone. Ndryshimet në Aneksin nr.I, sipas pikës 3 të Vendimit, mund të bëhen me propozim të Ministrisë së mjedisit dhe miratim të Këshillit të Ministrave.

Sipas këtij Vendimi personat juridike a fizike prodhues janë të detyruar të kujdesen për asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme që disponojnë në përputhje me standartet për mbrojtjen e mjedisit.

Në pikën 8 të vendimit ndalohej futja në territorin e Republikës së Shqipërisë mbetjet e renditura në Aneksin II bashkëlidhur këtij vendimi. Ndryshimet në këtë Aneks janë kompetencë e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave dhe Këshillit të Ministrave. Importi dhe eksporti i mbetjeve bëhet me leje nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave. Leja është vjetore dhe jepet sipas procedurës të vendosur nga kjo Ministri. Mbetjet e rrezikshme nuk mund të eksportohen nga Republika e Shqipërisë në qoftë se institucioni i autorizuar e shtetit importues nuk

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

pajis personin juridik ose fizik eksportues me dokumentacionin perkates te vendit te tij. Leja jepet pasi eshte depozituar ky dokumentacion ne Ministrine e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave.

Per zbatimin e ketij vendimi jane te ngarkuar Inspektoret e Mjedisit, Policia Financiare dhe Organet Doganore.

4.2.2.4. V.K.M nr. 742, dt. 6.11.2003 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne V.K.M nr. 692, date 13.12.2001 ”Per masat e vecanta te sigurimit dhe te mbrojtjes se shendetit ne pune”, vendim i cili detyron punedhenesit per marrjen e masave te funksionimit te sherbimit mjekesor, vendosjen e mjekut te nderrmarjes. Marrja ne pune e mjekut eshte e detyrueshme per te gjitha subjektet veprimtaria e te cilit klasifikohet sipas V.K.M nr. 459, dt. 22.07.1998 “Per substancat e rrezikshme”, nr. 419, dt. 4.08.2000 “Per objektet e rrezikshme” dhe nr. 207, dt. 9.05.2002 “Per percaktimin e puneve te veshtira ose te rrezikshme” pamvaresisht nga numuri i punonjesve.

4.2.2.5. V.K.M nr. 459, dt. 22.07.1998 “Per substancat e rrezikshme” Percakton substancat e rrezikshme, me qellim mbrojtjen e shendetit dhe sigurimin ne pune nga perdorimi i tyre. Sipas vendimit bashkelidhur eshte vendosur lista e 154 substancave te rrezikshme. Perdoruesit e ketyre substancave jane te detyruar te marrin leje ne Inspektoratin Shteteror te Punes, leje qe i hap rrugen Doganes per ti lejuar keto substance te futen ne territorin e Republikes se Shqiperise.

4.2.2.6. V.K.M nr. 34, dt. 28.1.2002 “Per miratimin e Planit Kombetar te Veprimit per Mjedisin” Plani i veprimit mbeshtet veprimtari edhe ne fushen e mbetjeve te rrezikshme. Aksione dhe Projekte te P.K.V.M. pika 15-Strategjia dhe plani i Veprimit per administrimin e mbeturinave te rrezikshme, industriale dhe spitalore, pika 18-ligj per kimikatet dhe mbetjet e rrezikshme. Ne planin e administrimit te mbetjeve te rrezikshme, industriale dhe spitalore kerkohet :

- Njohja e gjendjes dhe identifikimi i prioriteteve
- Hartimi i regjistrit te mbeturinave te rrezikshme
- Vleresimi i rrezikut mjedisor dhe shendetesor nga mbeturinat e rrezikshme.
- Hartimi i kuadrit ligjor rregullator
- Ngritja e strukturave institucionale te administrimit te tyre
- Ngritja e nje sistemi monitorimi
- Hartimi i programeve te trajnimit

Ndersa veprimtarite ne kuadrin e planit te administrimit te kimikateve qe parashikohen jane:

1. Inventari i kimikateve ne ruajtje ne gjendje pune dhe te skaduar
2. Analize e kuadrit ligjor ekzistues
3. Hartimi i nje kuadri ligjor bashkekohor
4. Analize e nevojave institucionale ne kete fushe
5. Program trajnimi per administrimin e kimikateve
6. Projekte pilot per eliminimin dhe asgjesimin e sigurt te kimikateve.

4.2.2.7. V.K.M nr. 52, dt. 29.01.2004 “Per proceduren e dhenjes se lejes se perdorimit civil te lendeve plasese” percakton kushtet qe duhet te plotesojne subjektet e interesuara per perdorimin civil te lendeve plasese. Subjektet qe marrin kete leje duhet te jene te licensuara nga institucionet perkatese ne fushat minerare, gjeologjike, te hidrokarbureve dhe te ndertimit te cilat per realizimin e veprimtarise se tyre, kane domosdoshmeri perdorimin e lendeve plasese. Leja ka afatin e njejte me ate te veprimtarise. Personat e apjitur me kete leje jane te detyruar te zbatojne rregullat dhe masat teknike, te miratuara ne rregulloret perkatese.

4.2.2.8 V.K.M nr. 253, dt. 18.05.2000 “Per organizimin e sherbimit te kontrollit te plehrave kimike”, percakton sherbimin e kontrollit te plehrave kimike si pjese te struktures organizative te Institutit te Tokave. Administratori, inspektoret dhe punonjesit ndihmes emerohen nga keshilli

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

drejtues i institutit me propozim të drejtorit. Vendimi përcakton dhe numurin e punonjësve si dhe pagat.

4.2.2.9 V.K.M nr.234,dt.11.05.2000 “Per kriteret dhe rregullat e marrjes se mostrave dhe vleresimit te plehrave kimike” është akt normative për vlerësimin e plehëve kimike të analizuar në baze të kufijëve të lejuar për çdo element dhe ose në llogaritjen e vlerës së indeksit të përgjithshëm të plehëve. Në vendim pika 7 jepen dhe kufijtë e lejuar të përmbajtjes së deklaruar të mikroelementeve si B,Co,Cu,Fe,Mn,Mo,Zn. Mostra zyrtare është 0.5-1 kg dhe përfaqëson sasinë e plehëve prej 50 ton. Marrja e saj bëhet në përputhje me metodologjinë e përcaktuar nga shërbimi i kontrollit të pleherave kimike.

4.2.2.10 V.K.M nr.213,dt.11.05.2000 “Per mbeshtetjen e shërbimit te kontrollit te plehrave kimike nga organet e ruajtjes se rendit” synon mbështetje të shërbimit të kontrollit të pleherave kimike nga organet e ruajtjes së rendit në rast të vecanta të përcaktura në këtë vendim, që kanë të bëjnë me shkelje të ligjit.

4.2.2.11 V.K.M nr.72,dt.15.02.2001 Per miratimin e “Rregullore e produkteve per mbrojtjen e bimeve”, ky Vendim shfuqizon VKM nr.584, date 6.12.1993 “Per miratimin e pesticideve qe perdoren ne bujqesi”. Qëllimi i aktit është që nëpërmjet procedurës së regjistrimit, vendosjes në treg dhe kontrollit të PMB-ve, të garantojë në maksimum mbrojtjen e njerezëve, kafshëve dhe mjedisit, duke siguruar në të njëjtën kohë një mbrojtje të efektshme të bimeve. Në këtë vendim jepen përkufizime të termave me të përdorshme si “produkt, mbetje të PMB, lende vepruse” etj. Vendimi përbehet nga IX krere dhe ka 75 nënë, Neni 3 bën klasifikimin e produkteve të mbrojtjes së bimeve (PMB). Për regjistrimin e këtyre produkteve krijohet komisioni (KSHRPMB) me 10 specialiste të fushave të ndryshme, kryesisht agronome, higjieniste, kimiste, veteriner etj. Për vlerësimin e PMB janë ngarkuar Instituti i mbrojtjes së bimeve, Instituti Shëndetit Publik dhe Instituti i kërkimeve veterinarë. Përveç këtyre institutivave të drejtën e përdorimit të PMB të parregjistruar për qëllime eksperimentale e kanë edhe institucione të tjera dhe persona të pajisur me autorizim të leshuar nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetsisë.

Në nenin 8 dhe 9 jepen kushtet e përgjithshme për regjistrimin e një PMB. Certifikata e regjistrimit si dokument përfundimtar i procedurës së regjistrimit leshohet nga Ministri. Me këtë certificate PMB përdoret në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. KSHRPMB i propozon Ministrin amandimin ose anulimin e një vendimi të regjistrimit në përputhje me Vendimet e mëtejshme të BE për PMB-te.

Regjistrimi i një PMB-je bëhet kur lenda aktive e të cilit është në aneksin I të Direktives nr.91/414/EEC. Afati i regjistrimit është maksimum 5 vjet. Për rinovimin e regjistrimit kërkuesi duhet të paraqitë kërkesën 1 vit përpara afatit të skadimit të regjistrimit. Vendimi në kreun e III bën fjalë për kushtet e importit, ruajtjes dhe tregëtimit të PMB-ve

Në kreun e V jepen rregulla që duhet të ndiqen për transportin e PMB-ve dhe gjatë përdorimit të tyre.

Në kreun e VI trajtimet kimike me mjete ajrore jepen kushtet, detyrat dhe lejet që duhet të merren në rastet e trajtimeve të PMB me mjete ajrore.

Në kreun VII-Asgjesimi, bëhet klasifikimi i tyre dhe në nenin 57 ndalohet kategorikisht asgjësimi i PMB me groposje. Pranohet largimi nga territori i vendit ose djegia.

Në kapitullin VIII-Kontrolli cilësor i PMB ,kjo bëhet nga Instituti i Mbrojtjes së Bimeve dhe Inspektorati përkatës. Në këtë kre flitet dhe për rastet e bllokimit, detyrimeve të tregëtuesave si dhe shpenzimet dhe pagesat për Regjistrimin e PMB.

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

4.3. Kuadri ligjor ekzistues sipas kategorise se perdorimit, qe i adresohet llojeve te kimikateve nga Prodhimi/Importi deri Asgjesimi

I. PESTICIDET

1.Importi-Ligjin 7662,date 19.01.1993 “Per sherbimin e mbrojtjes se bimeve” kapitulli IV nenet 25~41 V.K.M nr72, dt 15.02.2001 Per miratimin e “Rregullore e produkteve per mbrojtjen e bimeve”.

2.Prodhimi-Nuk ka rregulla

e Shendetesise		X					X	X
e Bujqesise,Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatori						X	X	X
e Punes,Ceshtjeve Social dhe Shanseve te Barabart	X	X	X	X		X	X	X
e Ekonomise,Tregetise dhe Energjitikes	X	X	X	X	X	X	X	X
e Puneve Publike, Trasp. dhe Telekomunikacionit	X	X	X	X	X			
e Mbrojtjes	X		X	X	X	X	X	X
e Drejtesise						X		
e Brendshme		X	X	X		X	X	X
e Financave	X		X			X	X	X

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

Tabela 5.A.3-Pergjegjesite e Ministrive, Agjencive dhe Institucioneve te tjera ne lidhje me kimikatet industriale

Ministria	Gjendja e ciklit te jetes							
	Import	Prodhim	Ruajtje	Trasp	Expo	Perdorim	depozitim	Asgjesim
e Mjedisit,Pyjeve dhe Administrimit Ujrave		X	X	X	X	X	X	X
e Shendetesise	X	X	X		X	X	X	X
e Bujqesise,Ushqimit Mbrojtjes se Konsum	X		X	X	X	X	X	X
e Punes,Ceshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta	X	X	X	X		X	X	X
Ekonomise,Tregetise dhe Energjitikes	X	X	X		X	X	X	X
Puneve Publike, Transportit Telekomu	X		X	X	X		X	X
e Mbrojtjes	X		X	X	X			X
e Drejtesise	X	X	X	X	X	X	X	X
e Brendshme	X		X	X	X		X	X

Tabela 5.A.4-Pergjegjesite e Ministrive, Agjencive dhe Institucioneve te tjera ne lidhje me kimikatet e konsumit

Ministrite perkatese	Gjendja e ciklit te jetes							
	Import	Prodhim	Ruajtje	Trasp	Expo	Perdorim	depozitim	Asgjesim
e Mjedisit,Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave								X
e Shendetesise						X		X
e Bujqesise,Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit								
e Punes,Ceshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta	X					X		
e Ekonomise,Tregetise dhe Energjitikes	X		X		X	X	X	
e Puneve Pub.Transp dheTelekomunikacionit			X				X	
e Mbrojtjes								
e Drejtesise								
e Financave			X			X	X	
e Brendshme				X			X	

Shenim I –Importim; P-prodhim; S-ruajtje; T-transport; Eksport; U-perdorim /tregetim; D-depozitim; L-Asgjesim

5.2 Pershkrim i Autoriteteve Ministrore dhe Mandateve

Administrimi i kimikateve ne vend behet prej Institucioneve te renditura ne tabelen 5.A.1 ; 5.A.2, 5.A.3 dhe 5.A.4 te cilat kane detyrimet dhe te drejtat qe rrjedhin nga legjislacioni dhe instrumentat rregulluese.

Ministria e Mjedisit,Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave ka pergjegjesine per lejet e prodhimeve te substancave dhe preparateve qe zoterojne vetite e klases 1.5 ,vleresimin, testimin, administrimin dhe kontrollin e tyre.Me Ministrine e Bujqesise,Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit ka

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

pergjegjiesine per lejet e prodhimit e te importimit te produkteve te mbrojtjes se bimeve dhe pleherat kimike, vleresimin, testimin, administrimin dhe kontrollin e tyre.Ministria e Mjedisit,Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave nepermjet Zyres se Rregjistrimit te kimikateve(qe parashikohet te ngrihet),mban rregjistrin e shkarkimeve, mbledh dhe informon gjendjen e mjedisit,kontrollin e gjendjes se ambjentit, kryen vleresimin e impakteve mjedisore dhe auditimin mjedisor.Kontrollon substancat e rrezikshme brenda regjimit te lejushem ne krahasim me dokumentat ligjore.Njekohesisht me infrastrukuren qe ka kjo ministri, ARM-te dhe Inspektoratin e mjedisit, merr masa per parandalimin e rreziqeve ndaj njerezve dhe mjedisit dhe ndeshkimin e personave pergjegjies per cdo shkelje te rregullave e normave te miratuara te demtimit te mjedisit.

Ministria e Mjedisit,Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave ka autoritetin per te kontrolluar cdo aktivitet ne mjedis dhe ka mandatin per ta gjobitur ose ndaluar perkohesisht ose perfundimisht aktivitetet me ndikime te medha ne mjedis..Ne perberje te kesaj ministrie funksionojne agjencite rajonale te mjedisit ne shkalle prefektore dhe Inspektorati i Mjedisit.

Ministria e Shendetesise ka pergjegjiesine per lejet e prodhimeve te substancave dhe preparateve qe zoterojne vetite e klases 6 deri 14 ,vleresimin,testingin, administrimin dhe kontrollin e tyre.Ministria e Shendetesise ne zbatim te Ligjit"Per substancat dhe preparatet kimike" dhe Ligjit"Per inspektoratin sanitar shteteror" duhet te kontrolloje importin, prodhimin, tregjetimin, ruajtjen ,perdorimin dhe dekontaminimin e substancave te rrezikshme,leshon leje per kimikatet e reja qe administrohen nga industria,bujqesia dhe nevojat e konsumit.

Kjo ministri ka nje rjet institucionesh ne qender dhe baze qe merren me mbrojtjen e shendetit te qytetareve kontrollin higjienosanitar te ambjenteve te punes dhe gjendjen shendetesore te punonjesve.

Ministria e Ekonomise,Tregetise dhe Energjitikes ka pergjegjiesine per lejet e prodhimeve te substancave dhe preparateve qe zoterojne vetite e klases 3,4 dhe 5,vleresimin,testingin dhe administrimin e tyre.Kjo Ministri ka pergjegjiesine e ndertimit te rafinerive ,TEC-eve dhe objekteve te medha prodhuese, por nuk ka pergjegjiesine e ndertimit te distributoreve te benzines,naftes ne qytete dhe autostrada qe jane kompetence e Pushtetit vendor dhe Ministrise se Puneve Publike,Transportit dhe Telekomunikacionit.

Nga ish ministria e industrise dhe energjitikes gjate vitit 2000-2001 u ndermor nje studim per te inventarizuar te gjitha kimikatet qe ishin gjendje ne te gjitha nderrmarjet ne varesi ,perfshire ketu edhe ato qe ishin privatizuara nga kjo ministri.Krahas kesaj u dha detyre qe per kimikatet e rrezikshme te behesh grumbullimi i tyre ne nje magazine te sigurte.U grumbulluan rreth 80 ton kimikate te ndryshme nga te cilat 15 ton cianure te K,Ca.Tani eshte e pa qarte se cduhet te behet me kimikatet e grumbulluara.

Ministria e Ekonomise,Tregetise dhe Energjitikes jep lejet per perdorimin civil te lendeve plasese pas miratimit me perpara te veprimtarise nga Pushteti Vendor,Ministria e Shendetesise, Ministria e Mjedisit,Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave dhe institucionet e tjera vendore. Kjo ministri ushtron kontrole periodike nepermjet inspektorateve te sigurimit teknik qe ajo ka ne vartesi.Ministria ka te drejten ligjore qe te pezulloje perkohesisht ose ndaloje cdo veprimtari qe shkel legjislacionin ne fuqi.

Ministria e Punes,Ceshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta eshte autoriteti kryesor per zbatimin e kodit te Punes.Inspektorati shteteror i punes ne vartesi te kesaj ministrie dhe ne bashkepunim me inspektoriatet e tjera te shtetit kordinojne punen per te siguruar zbatimin e legjislacionit te punes nga punedhenesit dhe personat e siguruar prej tyre.MPCSSHB ushtron kontroll ne vendet e punes me qellim sigurimin e punonjesve dhe mbrojtjen e tyre me mjetet e nevojshme per nje pune pa avari dhe aksidente dhe plotesimin e nevojave te punemaresve me kushtet me te domosdoshme higjienosanitare.

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

MPÇSSHB ka percaktuar punet e veshtira ose te rrezikshme si dhe listen e substancave te rrezikshme me qellim mbrojtjen e shendetit dhe sigurimin ne pune nga perdorimi i tyre. MPÇSSHB leshon lejen e punes nepermjet inspektoratit te punes.Nje leje e vecante kerkohet nga punedhenesit per punonjesit qe do te punojne me substancat e shpallura si te rrezikshme nga kjo ministri.

Ministria e Bujqesise,Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit mban rregjistrin e produkteve per mbrojtjen e bimeve(pesticideve) dhe pleherave kimike,i teston dhe kontrollon ato mbi bazen e legjislacionit dhe rregullave te nxjerra per nje administrim me te mire te tyre.Importi dhe eksporti i tyre kontrollohen nga kjo ministri.Ministri ka autoritetin te pezulloje ose ndaloje cdo lloj PMB apo pleh kimik qe nuk i pergjigjet kerkesave te sdandarteve te miratuara.Ne cdo rreth vepron kontrolli i sherbimit te PMB.Ne kontrollin e tyre jane te angazhuar Institutet kerkimore ne vartesi te M.Bujqesise si Instituti i mbrojtjes se bimeve, ai veterinar, i studimit te tokave etj.

Ministria e Puneve Publike,Transportit dhe Telekomunikacionit pergjigjet per transportin e mallrave te rrezikshme.Ajo leshon lejen per automjete qe trasportojne mallrat e rrezikshme,ben kontrollin teknik dhe bashkerisht me Ministrine e Rendit Publik i shoqeron keto mallra deri ne destinacion brenda vendit.Transporti i lendeve eksplozive te importit sigurohet me mjetet dhe personelin e Ministrise se Mbrojtjes.

Ministria e Mbrojtjes ka pergjegjesine e prodhimit ,importit,eksportit ,administrimit, kontrollit te substancave qe zoterojne vetite e klases 1,2 dh 3.Kjo Ministri me ligj nuk ka pergjegjesine e klases 1 vetem per lendet eksplozive te perdorimit civil ,qe i ka kaluar si pergjegjesi Ministrise Ekonomise,Tregetise dhe Energjitikes si perdoruesi kryesor i kesaj lende.Per te gjitha llojet e tjera te eksploziveve kjo Ministri ka pergjegjesine e vleresimit,testimit,administrimit dhe kontrollit te tyre Ministria e Mbrojtjes jep lejet dhe ka pergjegjesine kryesore per importin,eksportin ,testimin e lendeve eksplozive dhe transportin e lendeve kimike te rrezikshme.

Mbrojtja Civile qe vepron brenda struktures se Ministrise se Brendshme ka struktura qeveritare te ngritura dhe permanente per mbrojtjen e popullsisë ne raste fatkeqesije dhe aksidentesh qe drejtohet nga zevendes kryeministri i Qeverise i cili ka autoritetin dhe pergjegjesine per te kryer aktivite ne pergjigje te emergjencave.

5.3 Komentet /Analiza

Tashme ekzistojne nje numur i madh aktesh ligjore dhe nenligjore qe mbulojne te gjithë sektoret e ekonomise, te cilat percaktojne detyrimet dhe te drejtat e institucioneve te ndryshem dhe autoritetin e kontrollit te tyre.Nevoja e nje kordinimi ne implementimin e bazez ligjore eshte e nevojshme ne kete periudhe te kalimit ne ekonomine e tregut.Adaptimi i legjislacionit European,perfshirja ne legjislacionin e vendit te Direktivave te BE duke ndjekur ne vazhdimesi ndryshimet dhe te rejat ne to per persosjen e kuadrit ligjor ekzistues, kerkon ngritjen e rolit te strukturave shteterore, perfshirjen e institucioneve joqeveritare dhe sindikatave te puntoreve qe ne fillim te ndermarrjes se iniciativave ligjor e ne vecanti kur kemi te bejme me kimikate te rrezikshme.Aktualisht ka nje boshllek te madh ligjor dhe rregullave,mekanizmave jo rregullatore ne lidhje me kimikatet.Vendi ka nevojë per nje **Akt te Kimikateve** (sic i kane te gjitha vende e zhvilluara) ku te perfshihen te gjitha aktet ligjore dhe normative,te vleresimit te tyre,te sigurimit prej tyre dhe masave mbrojtjese per ruajtjen e shendetit te punonjesve dhe qytetareve ne pergjithesi pse jo dhe te asgjesimit te tyre.

Pra eshte e nevojshme te krijohet nje baze e re ligjor per administrimin e kimikateve.

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

Kimikatet e konsumit janë të pa trajtuara nga ana ligjore dhe mungon në përgjithësi kontrolli i tyre. Ligji “Për substancat dhe preparatet kimike” si iniciative e ish Ministrisë së Industrisë dhe Energjitikës në përparim për të përcaktuar përgjegjësitë dhe detyrimet e subjekteve private dhe shtetërore për një administrim me të mirë të kimikateve, gjendje në të gjithë territorin e vendit, duhet të merret seriozisht nga të gjitha institucionet e ngarkuara për në vecanti nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave si autoriteti kompetent.

Në bazë të Ligjeve të miratuara, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave duhet të ngrejë Zyren e regjistrimit të kimikateve, Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës të krijojë shërbimin e kontrollit të kimikateve .

Ministria e Shëndetësisë dhe MPPÇSSHB kanë detyrë të vecanta që lidhen me normat e lejuara, masat e sigurisë dhe emergjencës, kualifikimin e punonjësve etj. Për kërkohejt një angazhim i përgjithshëm i institucioneve të ngarkuar me ligj për të marrë seriozisht jo vetëm me detyrat që ngarkon ligji por për të zgjeruar ato gjithmonë për të qenë bashkëkohore me ligjet dhe Direktivat e BE.

Më gjithë progresin e arritur në administrimin e kimikateve në përgjithësi duhet thesuar se pengese kryesor në plotësimin e kuadrit të nevojshëm ligjor por edhe administrimit me të mirë të kimikateve nga njëra anë, ka qenë mbështetja e kufizuar nga ana financiare për stabilizimin e situatës së krijuar nga prania në ndërmarrjet e privatizuara ose të nxjerrja jashtë përdorimit e mjaft kimikateve stoqe dhe të pa mbrojtura sipas rregullave dhe nga ana tjetër niveli i ulët i shkallës së ndërgjegjesimit të komunitetit dhe politikaneve në forcimin e bazës ligjore dhe masave për ruajtjen dhe mbrojtjen e sigurte të kimikatet në përgjithësi dhe ato të rrezikshmet në vecanti.

Kapitulli 6

Aktivitetet në lidhje me Industrinë , Grupet e Interesuara Publike dhe Sektorin Kerkues

-
- 6.1 Pershkrimi i Organizatave
 - 6.2 Permbledhje e Mundësive Profesionale të Disponueshme në Sektorin Jo- Qeveritar
 - 6.3 Analiza , Vleresime dhe Rekomandime
-

Nevoja e harmonizimit , koordinimit , lidhjes dhe marreveshjes së aktiviteteve , paraqesin interes në kohën kur ekonomia është duke kaluar nga menaxhimi i centralizuar në formë të reja të organizimit dhe menaxhimit , kur pronësia është duke kaluar nga ajo publike në ato private dhe sektori privat tashmë është i konsoliduar . Gjithashtu e njëjta nevojë është e domosdoshme në kushtet e ekonomisë së tregut dhe privatizimit , në kushtet e zhvillimit të shpejtë të bizneseve të vogla dhe të mesme në zgjerimin e bizneseve të përmasave të mëdha dhe monopoleve , dhe në kushtet e zhvillimit intensiv të aktiviteteve të ndryshme prodhuese .

Eksperiencën e fituar në botë si dhe eksperiencën e Shqipërisë , sugjerojnë që *organizmat jo-qeveritare* mund dhe duhet të luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e bërjes së politikave të secilit vend për arsye të strukturave të specializuara , metoda e tyre e financimit , format e tyre të ekzistencës dhe mënyra e punës . Subjekti kryesor i aktiviteteve të tyre duhet të jenë problemet mjedisore , veçanërisht ato të lidhura me rrezikun e menaxhimit të kimikateve .

Në mund të klasifikojmë organizmat jo-qeveritare në Shqipëri , duke pasur parasysh subjektin e lartpërmendur si edhe shumëllojshmërinë e tyre në vendin tonë , si vijon :

- Organizatat industriale , dhomat e tregtisë , grupet ekonomike , kompanitë aksionere , shoqëritë tregtare etj
- Universitetet , Institutet e larta , Institutet kërkimore , kolegjet , shkollat teknike , shkollat e specializuara private , kurset specializuese kombëtare dhe nderkombëtare , sektoret e kërkimeve , shoqëritë , fondacionet , laboratorët privat , libraritë etj
- Organizmat e tjera jo-qeveritare si kompanitë aksionere , kompanitë private , qendrat , shoqatat , klubet dhe levizjet

Metodat për regjistrimin e organizmave ekzistuese jo-qeveritare , përcaktojnë subjektin e aktiviteteve për ato, përvetësojnë nga shumëllojshmëria e tyre . Kjo gjë bën të mundur shumëllojshmërinë e aktiviteteve prodhuese , importin dhe eksportin , përdorimin e substancave kimike , zhvillimin dhe aplikimin e substancave të reja kimike , kurset e trajnimit etj .

Monitorimi , kontrolli , vlerësimi , magazinimi , riaktivizimi dhe ripërdorimi i mbetjeve gjithashtu janë subjekte të aktiviteteve për një numër strukturash jo-qeveritare .

Për mungesë të një sistemi uniform të menaxhimit të substancave kimike , përfshi mbetjet e rrezikshme ka efekt jo të mirë për shtetin dhe organizmat jo-qeveritare . Gjithçka e thënë me lartë vendos nevojën e krijimit të sistemit kombëtar për menaxhimin e kimikateve dhe përpunimin e standardeve nderkombëtare në këtë fushë . Legjislativi i ri është më se i domosdoshëm si një bazë për përgjegjësinë dhe të drejtat e autoriteteve dhe pjesëve të tjera të shoqërisë .

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

Dhoma e Tregtise

Ne Shqipëri ekziston vec organizmave te tjera edhe Dhoma e Tregtise dhe e Industrise e cila eshte nje Institucion i te drejtes publike e pavarur dhe pa qellim fitimi . Ajo ka mision kryesor perfaqsimin e komunitetit te biznesit te Tiranës ne marrëdhëniet me shtetin si dhe mbrojtjen e interesave te ligjshme ekonomike te tij . Dhoma luan rol nxites per zhvillimi e tregtise dhe industrise ne rrethin e Tiranës ne perputhje me interesat ekonomike te anetareve te sajë dhe ligjet e shtetit . Ajo e mbështet veprimtarine e sajë ne ligjin Nr 7804 dt 10.03.1994 “ Per Dhomat e Tregtise dhe Industrise “ . Gjithashtu ajo ka deget e saj dhe ne qytetet e tjera te vendit.

Ne te antarsohen :

- Tregtaret
- Shoqerite tregtare
- Ndermarrjet shteterore
- Perfaqesite dhe deget e shoqerive tregtare etj

Trainime

Ne bashkepunim me eksperte dhe institucione te specializuara , Dhoma organizon trainime brenda dhe jashte vendit , per formimin profesional te anetareve te sajë ne fusha te ndryshme dhe per ceshtje ne interes per ata . Ajo e ndihmon biznesin shqiptar dhe ka lidhje te ngushta me shume Dhoma Tregtare ne bote si ajo e Italise , Austrise Gjermanise , Amerikes etj .

Per me shume informacion *[Dhoma e Tregtise dhe Industrise-Tirana Albania](#)*
[Adress:Rruga Kavajes Nr 6 Tirane Tel/fax 00355 4 234551 http:// www.cci.gov.al](#)

Akademia e Shkencave e Shqiperise

Akademia e Shkencave e Shqiperise eshte themeluar me 10 Tetor 1972 . Nepermjet studimeve shkencore ajo ka zgjidhur nje varg problemesh te rëndësishme te lidhura me njohjen e historise , gjuhes e kultures se popullit Shqiptar , me njohjen e natyres e te pasurive natyrore te vendit , me futjen e perdorimin e metodave e teknologjive te perparuara ne prodhimin industrial e bujqesor , me permirsimin e mbrojtjes se mjedisit e te shendetit te popullsise etj

Kjo Akademi ka si detyra kryesore :

- Kujdeset per te hapur fusha te reja kerkimesh e studimesh shkencore , ne perputhje me nevojat e zhvillimit te vendit
- U ofron institucioneve te larta shteterore keshillimin dhe ekspertizen e nevojshme ne zgjidhjen e ceshtjeve te rëndësishme per zhvillimin e vendit
- Perpunon sebashku me organet shteterore perkatese , rekomandime per shfrytezimin efektiv te arritjeve tekniko-shkencore ne zhvillimin ekonomik e shoqeror te vendit
- Bashkepunon me institucione dhe qendra te tjera shkencore

Per me shume informacion *[Akademia e Shkencave-Tirana Albania](#)* *[Adress:Sheshi Fan Noli Tirane Tel/fax 00355 4 227476](#)*

6.1 Pershkrimi i Organizatave Jo Qeveritare

Organizatave Jo-qeveritare te cilat merren me ndotjen e ambientit qe vjen nga aktivitetet industriale ,bujqesore dhe nivelin e jetes se perditeshme numurohen ne mbi 110 por nga ato qe kane lidhje me prodhimin , shitjen , transportin , magazinimi ose asgjesimin e substancave kimike jane te pakta dhe me keto merren kryesisht organizmat shtetere dhe shoqeri te vecanta prodhuese. Te gjitha keto jane antare te Dhomes se Tregetise Shqiptare . Pervec organizatave te njejta jo-qeveritare ,ka dhe shume kompani private dhe perfaqesues te zyrave te medha te kompanive Europiane , Amerikane etj.. te cilat merren me prodhimin dhe tregtimin e kimikateve ne Shqiperi . Keto kompani dhe perfaqesues se zyrave , nuk jane bashkuar ne organizata me te medhaja ,dhe aktivitetet e tyre nuk jane te koordinuara , keshtu qe organizma te ngjashem nuk jane perfshire ne Profilin Kombetar .

REC ne Shqiperi

Qendra Rajonale e Mjedisit për Evropën Qendrore e Lindore (REC) është një organizatë ndërkombëtare jofitimprurëse, joavokate, me mision mbështetjen për zgjidhjen e problemeve mjedisore në Evropën Qendrore e Lindore (EQL). Qendra e përmbush misionin e saj duke nxitur bashkëpunimin ndërmjet organizatave joqeveritare, qeverive, bizneseve dhe aktorëve të tjerë mjedisorë, si dhe duke mbështetur shkëmbimin e lirë të informacionit dhe pjesëmarrjen e publikut në vendim-marrjen mjedisore.

REC është krijuar në 1990 nga Shtetet e Bashkuara, Komisioni Evropian dhe Hungaria. Sot REC bazohet ligjërisht në Kartën e REC, nënshkruar nga 28 vende dhe Komisioni Evropian dhe në një marrëveshje ndërkombëtare me qeverinë hungareze. REC ka zyrën qendrore në Szentendre, Hungari dhe zyrat e vendeve në secilin prej 15 vendeve përfituese, të cilat janë:

Shqipëria, Bosnja-Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Republika Çeke, Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, RIJ e Maqedonisë, Polonia, Rumania, Serbia-Mali i Zi, Sllovakia dhe Sllovenia.

Donatorët më të fundit janë Komisioni Evropian dhe qeveritë e Shqipërisë, Austrisë, Belgjikës, Bosnje-Hercegovinës, Kanadasë, Kroacisë, Republikës Çeke, Danimarkësvicrës, Mbretërisë së Bashkuar , Shteteve të Bashkuara, etj.si dhe organizata të tjera ndërqeveritare dhe institucione private.

Ka ndermarre nje seri projektesh qe kan lidhje me mbrojtjen e ambientit,nder to dhe ndikimi i menazhimit te kimikateve oer nje ambient te paster.

Per me shume vizitoni sitin :<http://albania.rec.org>

Shoqata e Bujqesise organike Tirane

Themeluar qe ne 13 Korrik 1997 nga nje grup prej 22 specialistesh ne fushen e bujqesise Shoqata e Bujqesise organike Tirane i ka vene si qellim vehtes te promovoje praktiken e nje Bujqesie Organike per te kontribuar ne nje zhvillim te qendrueshem ne Shqiperi ajo informon idete dhe avantazhete nje bujqesie te qendrueshme nepermjet publikimeve ,shtypit , trajnimeve etj.Me zyrat qendrore ne Tirane,dhe shume dege ne rrethe te ndryshme te vendit ajo angazhon specialiste te shume fushave qe kontribojne ne kete drejtim.Shoqata e Bujqesise Organike eshte antare e IFOAM (International Federation of Organic Agriculture Movement).Ajo ka si partner kryesor FiBL (Research Institute of Organic Agriculture) te themeluar qe ne 1974 ne Zvicer.FiBL nje institut mjaft i njohur ne gjithe boten ne fushen e Bujqesise Organike. Ajo eshte partnere kryesore dhe merr pjese ne disa projekte te rendesishme ne vendin tone si “Mbeshtetja e nje Bujqesie te Qendrueshme ne Shqiperi “ (Sustainable Agriculture Support in Albania 2003-2006) financuar nga qeveria Zvicerane

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

Per me shume informacion Shoqata e Bujqesise organike Tirane Albania(SH.B.O.)
Adress:Rruga Sami Frasheri Godina Nr 20/10 Kati 8 Tirana Albania Tel Fax 00355 4 250575
email organic.org.al <http://www.organic.al>

Tabela 6A : Permbledhje e Ekspertizes se Disponueshme Jashte Qeverise

Fusha e Ekspertizes	Institutet Kerkimore	Univesitetet	Industria	Konsumator / ambientalisti	Unionet e Punes	Org. Profesionale	Te tjera
Mbledhja e te Dhenave	X	X		X		X	
Testimi i Kimikateve	X	X					
Vleresimi i Riskut	X	X		X			
Reduktimi i Riskut	X	X			X	X	
Analizat e Politikes	X			X	X		
Trainimi dhe Edukimi	X	X		X			
Rikerkimi mbi Alternativat	X	X					
Monitorimi	X	X		X			
Informacion per Punetoret	X	X		X	X	X	
Informacion per publikun	X			X	X	X	

X- institucionet aktore per vleresimin e kimikateve

Komente

- Legjislacioni mjedisor ku ben pjese dhe administrimi i kimikateve ka parashikuar si nje obligim te qeverise informimin e publikut dhe grupeve te tjera te interesuara . Kjo ka te beje me regjistrat qe nisin nga prodhimi deri tek asgjесimi i mbetjeve , gjithashtu plane dhe strategji dhe cdo gje ne lidhje me menaxhimin e kimikateve . Problemi qendron ne zbatimin e ketyre klauzolave per sa kohe ka mungese te mjeteve te informimit te pamjaftueshem.
- Per menaxhimin e kimikateve ne teresi dhe aktivizimin e organizatave jo qeveritare ka nje memorandum mirekuptimi ndermjet Qeverise (Ministrise se Mjedist) dhe NGO-ve ku shkembimi i informacionit eshte nje nder prioritetet . Gjithashtu ekziston dhe problemi venies ne praktike te ketyre projekteve nepermjet financimit dhe gjetjes se rruges se financimit duke qene se NGO nuk jane te fuqishme sa te perballojne shpenzimet per te mbajtur dhe shkëmbyer informacionin e nevojshem
- NGO jane gjithnje te ftuara per te diskutuar cdo lloj rregulloreje ligjore qe projektohet nga Ministria e Mjedisit perpara se ti dergohet Qeverise per miratim . Ato jane pjese e diskutimit rreth raporteve te vlersimit te impaktit mjedisor te bere nga subjekte qe kane per qellim te hapin aktivitetet ne lidhje me kimikatet .
- Deri tani nuk kemi shembuj te inisitivave vullnetare per te mbeshtetur aktivitetet ne lidhje me menaxhimin e kimikateve.
- NGO-te jane te aktivizuara dhe ato nepermjet mjeteve te masmedias informojne publikun dhe perpiqen te terheqin vemendjen ne rastet e vlersimit te rrezikut
- NGO-te ne pergjthesi jane te angazhuara ne shume probleme te menaximit te mjedisit qe vjen nga keqperdorimi dhe keqmenaxhimi i kimikateve . Ato sipas kuadrit ligjor ne fushen e mjedisit dhe kimikateve kane te gjitha te drejtat te marrin pjese ne kontrollin dhe vendimmarrjen
- Deri tani nuk ka shembuj te informimit , studimeve ose kerkimet e meparshme te bera nga organizatat jo-qeveritare , perfshi organizatat e industrise ne forcimin e kapaciteteve qeveritare per menaxhimin e kimikateve pervec komenteve te tyre dhe sugjerimeve mbi materialet e dhena atyre nga qeveria

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

8. Por shkalla e bashkepunimit midis qeverise dhe sektoreve jo-qeveritar ne lidhje me menaxhimin e kimikateve keto dy vitete e fundit ka qene ne rritje vecanerisht pas krijimit te Ministrise se Mjedisit

Kapitulli 7
Komisionet Nder-Ministore dhe Mekanizmat Koordinues

- 7.1 Komisionet Nder-Ministore dhe Koordinimi
- 7.2 Pershkrimi i Komisioneve Nder-Ministore dhe i Mekanizmave Koordinuese
- 7.3 Pershkrimi i Mekanizmave për Marrjen e Informacionit nga Organizmat Jo-Qeveritare
- 7.4 Komentë dhe Analiza

7.1 Komisionet Nder- Ministore dhe Koordinimi

Gjate ndryshimeve të viteve 1990 e më tej në Europën jugore dhe në Shqipëri në ndryshimet e sistemit politik dhe kapercimi i ngadalte nga ekonomia e centralizuar në atë të tregut u vu re një rregullim i aktiviteteve ekonomike, të prodhimit, e në teresi të zinxhirit të mekanizmave koordinues në qeverisjen e vendit.

Menaxhimi i kimikateve në një vend, ka të bëjë me përdorimin e kimikateve në ndermarrjet industriale, bujqësore dhe të konsumit si edhe tregtimi i kimikateve. Në vendin tonë shumë nga ndermarrjet e medhaja industriale e humbën funksionin e tyre, duke rezultuar në rritje të konsiderueshme të prodhimit si rezultat i konkurrencës së madhe, kostos së lartë dhe problemeve të rëndësishme ambientale. Ndermarrjet e tjera u futën në borxhe falimentuan, dhe e mbyllën fare aktivitetin. Ndërsa një grup i tretë i ndermarrjeve ndryshuan drejtimin e tyre. Procesi i ngadalte i privatizimit shkaktoi vështirësi të tjera në ecurinë normale të ndermarrjeve që mendonin të kishin një të ardhme në prodhimin e kimikateve duke hapur rrugë importit total të nevojave të vendit si për kimikatet e industrisë, bujqësinë, konsumit etj.

Tjeter faktor negativ që ka influencuar në ecurinë e prodhimit dhe sot të importimit të kimikateve është se kontrolli cilësor i kërkuar nga Standardet Shqiptare dhe nga ato të CEE për Cilesinë e produktit kimik është pakesuar. Gjithashtu ka mangësi të Akteve Normative të cilat kërkojnë zbatimin e standardeve ndërkombëtare të cilësive. Ndermarrjet e prodhimit të produkteve kimike dhe përdoruesit e kimikateve përcaktojnë cilësinë e produktit në bazë të kërkesave të tyre teknike por jo gjithmonë ndjekin ecurinë e jetës së kimikatit.

Për pasojë për përmirsimin e gjendjes, janë ngritur disa komisione ndërminstrore dhe mekanizma koordinues që kontribuojnë dhe vendosin në nivel qeveritar për problemin e menaxhimit të kimikateve. Disa nga detyrat e tyre janë:

- = Krijimi i dekreteve që kanë të bëjnë me kontrollin e kimikateve dhe produkteve kimike
- = Krijimi i dekreteve që kanë të bëjnë me detyrimet që rrjedhin nga konventat ndërkombëtare të nënshkruara dhe ratifikuara
- = Përgatitja për pjesëmarrjen e Shqipërisë në marrëveshje të tjera ndërkombëtare OBT
- = Vlerësimi i ndikimit mjedisor për secilin nga ndermarrjet industriale që janë në treg për tu privatizuar
- = Kontrolli dhe vlerësimi i ndermarrjeve industriale, krijimi i prodhimeve të reja ose teknologjive të reja me një vizion drejt sigurisë së shëndetit dhe mjedisit
- = Licensimi i ndermarrjeve industriale sipas standardeve ISO 9000 dhe ISO 14000
- = Edukimi dhe rritimi i specialistëve që merren me menaxhimin e kimikateve

Por realizimi i gjithë këtyre detyrimeve, veç strukturave të ngritura për këtë qëllim, realizohet me ndihmën, konsultat dhe vendimet që marrin komisionet Nderministore dhe organizmat e tjera koordinues që veprojnë në shkallë vendi

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

Table 7.A : Pasqyra e Komisioneve Nder-Ministrorë dhe Organizmave Koordinuese

Emertimi Komisioneve	Pergjegjesia	Sekretariat	Anetaret	Mandati	Inf. I seksionit 7.2 (Po/Jo)	Efekt shmeria
Komiteti nder-ministror per zbatimin planit te veprimit ne Mjedis	Zbatimi i planit te veprimit ne mjedis	Ministria e Mjedisit	Ministrite e linjes	I perkohshem	Po	2
Grupe pune per diskutimet e legjislacionit	Udhehiqet nga Kryeministr	Ministria e Mjedisit	Eksperte te linjes , NGO	Deri ne aprovim	Po	2
Komiteti nder-ministror per POPs	Ministria e Mjedisit	Njesia e projektit	Ministrit e linjes , NGO	Deri ne aprovim	Po	2
Komisioni mbrojtjes se ambjentit	Ministria e Mjedisit	Ministrite e linjes	Eksperte , NGO	I vazhdueshem	Po	2
Komisioni per mbrojtjen e popullsise ne rast fatkeqsish ose aksidenteve industriale	Min.Mbrojt, Min.Ekono, Min.Puneve Publike... Min.Shendetsise	Ministrite e linjes	Ekspert te ministrive te linjes	I vazhdueshem	Po	2
Komisioni shteteror per regjistrimin e pesticideve te importuara www.albchemicals.com.al	Ministria e Bujqesise , Doganat ,	Ministria e Bujqesise , Doganat ,	Ekspert te ministrse se bujqesise dhe Financave	I vazhdueshem	Po	2

Rradhitja e vleresimit te efektivitetit nga 1-3 (1) shkelqyeshem; (2) mesatare; (3) e dobet

Shpeshesia e takimeve te Komisioneve nderministeriale percaktohet nga nevojat e tyre ,dhe ato zhvillohen zakonisht dy here ne vit ose sipas kerkesave ne perputhje me kerkesat e projekteve ,apo te problemeve qe lindin ne kohe te ndryshme, ndersa procedurat e vendimmarrjes percaktohen nga ministrite e linjes ose qeveria.

7.2 Pershkrime te komisioneve nderministrorë dhe mekanizmave koordinuese

Komisioni shteteror per regjistrimin e pesticideve te importuara

Ne zbatim te ligjit Nr 7491 dt.29/04/1991 per sherbimin e mbrojtjes se bimeve qe ka lidhje kryesisht me importimin perdorimi apo asgjесimin e Pesticideve eshte krijuar drejtoria e Mbrojtejes se bimeve qe ka pergjegjesine kryesore per gjendjen e pesticideve ne Shqiperi Nepermjet ketij ligji cdo person fizik juridik ,vendas apo i huaj eshte i detyruar te regjistroj importimin e nje pesticidi te caktuar te ri apo te pedorur me pare dhe te jete paisur me leje te posacme te miratuar nga ministri i bujqesise dhe Ushqimit i cili cakton afatin e perdorimit ose mund ta anulloje ate kur verehen shkelje te ligjit ose te akteve nen ligjore

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

Per mungese te dhenash nuk eshte e mundur te bejme ndonje pershkrim me te hollesishem te komisioneve nderministrore apo te NGO –ve te tjera. Keto pershkrime do te behen me ripunimet dhe plotesimet qe do ti behen materialit ne te ardhemen

Komente

Menaxhimi i suksesshem i kimikateve ne nivel kombetar komplikohet nga fakti qe zakonisht ministrite e ndryshme marrin pjese ne kontrollin e kimikateve ne faza te ndryshme te ciklit te jetes se tyre krahas faktit qe ka nderthurje ne nje fare shkalle te pergjegjsive per nje problem te caktuar dhe per kete shkak menaxhimi i kimikateve ka nevojte te domosdoshme ngritjen e nje mekanizmi te suksesshem koordinimi ndermjet te gjitha ministrive (sic do ishte zyra e menaxhimit dhe regjistrimit te kimikateve ne zbatim te detyrave qe ka vene ligji Nr 9108 dt 17.7.2003 “Per substancat dhe preparatet kimike”

1. Duke patur parasysh gjendjen e institucioneve apo organizmave ekzistuese te menaxhimit te kimikateve verehet se ato nuk funksionojne gjithmone sic duhet per shume arsye :
 - 1.1 Pergjegjesite dhe te drejtat e aktoreve te ndryshem nuk jane gjithmone te qarta dhe te percaktuara me akte normative ligjore
 - 1.2 Ministrite e linjes qe administrojne keto mekanizma nuk kane buxhet te mjaftueshem per ndjekjen ne vazhdimesi te problemeve
 - 1.3 Ka mangesi ne zgjidhjet teknologjike (te dhena online , faks , lidhje telefonike etj)
Te gjitha sa permendem kane lidhje me pamundesite financiare per te patur nje ekip me te plote e me kopetent per ndjekjen e problemeve ne menyre te vecante ne ministrite e linjes qe tashme kan nje reduktim te ndjeshem te personelit administrative.
2. Ne te shumten e rasteve organizmat dhe agjensite qeveritare marrin pjese ne zgjidhjen e problemeve ne shkallen dhe mundesite reale, pa mundur te operojne ne thellesi te problemit ,per mungese te personelit te akteve nenligjore dhe ne shume raste te mungeses se perfshirjes ne takime te rendesishme per te kontribuar ne prezantimin e perfaqesimit te mekanizmi qe ato mbulojne .
3. Mekanizmat egzistuese nuk I mbulojne te gjitha aspektet e rendesishme te kimikateve, te cilat kerkojne nje kooperim dhe koordinim nderministror te persosur. Drejtorite dhe specialistet ndjekin problemet e kimikateve midis ceshtjeve te tjera te nje sektori multidisiplinor . keshtu qe ka dale domosdoshmeri krijimi i nje komiteti nderministror per menaxhimin e kimikateve sidomos tani qe ligji mbi “Substancat Kimike “ eshte miratuar.
4. Mekanizmat ekzistuese punojne te ndara sipas problematikes dhe specifikes se tyre
5. Duke ndjere nevojten e mbeshtetjes se ketyre mekanizmave per realizimin me mire te detyrave te tyre, sjellja e mekanizmave shtese nga jashte strukturave te qeverise eshte bere e mundur sipas rastit me kerkesen ose nevojten per te zgjidhur dicka te vecante
6. Deri tani nuk kemi mekanizma per ndarjen e informacionit midis agjensive te interesuara per menaxhimin e kimikateve. Por detaje te problematikave publikohen ne web site e Ministrive te cilat vendosin per mos thene shume rralle te dhena, per pakujdesi apo per mungese te fondeve te nevojshme nje problematike e pa zgjidhur deri tani. Ministria e Mjedisit publikon “Raportin e gjendjes se mjedisit” dhe organizon Takime me agjensite qe kane lidhje me kimikatet ne rastet e diskutimit te planeve , strategjive festimit te diteve mjedisore etj

Kapitulli 8
Aksesi mbi te Dhenat dhe Perdorimi

- 8.1 Te Dhenat e Duhura per Menaxhimin Kombetar te Kimikateve
- 8.2 Vendndodhja e te Dhenave Kombetare
- 8.3 Procedurat per Mbledhjen e te Dhenave Kombetare dhe Lokale
- 8.4 Disponimi i Literatures Nderkombetare
- 8.5 Disponimi i Databejsit Nderkombetar
- 8.6 Sistemet e Shkembimit te Informacionit Kombetar
- 8.7 Komente dhe Analiza

8.1 Te Dhenat e Duhura per Menaxhimin Kombetar te Kimikateve

Aktualishtne Shqiperi nuk ka nje sistem menaxhimi te kimikateve te integruar ne nivel kombetar . Menaxhimi i kimikateve kryhet i ndare sipas llojit te kimikateve dhe nga organizmi qeveritar i ngarkuar me kete pergjegjsi per industrine ,bujqesine,shendetesine etj..

Tabela 8 A Jep te dhena mbi informacionin e disponueshem ne lidhje me menaxhimin e kimikateve si edhe mbajtjen institucionale te informacionit mbi disa kimikate

Tabela 8. A : Cilesia dhe Sasia e Informacionit te Disponueshem

Te Dhenat e Duhura per	Pesticidet(bujqesore,shendeti publik,per perdorim)	Kimikatet Industriale	Kimikate Konsumuese	Mbetjet Kimike
Ambienti Prioritar	Ministria Bujqesise Ministria Mjedisit	Ministria Ekonomise	Ministria Ekonomise	Ministria Ekonomise
Vleresimi i Impaktit te Kimikateve ne Kushtet Lokale	Ministria Mjedisit ,Bujqesise, Shendetesise	Ministria Mjedisit Ministria e Shendetesis	Ministria Mjedisit Ministria e Shendetesise Ministria Mjedisit Ministria e Shendetesise	Ministria Ekonomise
Vleresimi i Riskut	Ministria Mjedisit ,Bujqesise, Shendetesise	Ministria Mjedisit Shendetesise Ekonomise	Ministria e Mjedisit Ministria Shendetesise Ministria Ekonomise	Ministria Mjedisit Shendetesise Ekonomise
Klasifikimi/Etiketimi	Ministria Mjedisit ,Bujqesise, Shendetesise	Ministria Ekonomise	Ministria Ekonomise	Ministria Ekonomise
Regjistrimi	Ministria ,Bujqesise, Shendetesise	Ministria Ekonomise	Ministria Ekonomise	Ministria Ekonomise
Licensimi	Ministria Mjedisit ,Bujqesise, Shendetesise	Ministria Ekonomise	Ministria Ekonomise	Ministria Ekonomise
Lejet	Ministria Mjedisit ,Bujqesise, Shendetesise	Ministria Ekonomise	Ministria Ekonomise	Ministria Ekonomise
Vendimet e Uljes se riskut	Ministria Mjedisit ,Bujqesise, Shendetesise	Ministria Ekonomise	Ministria Ekonomise	Ministria Ekonomise

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

				se
Gadishmeria per Aksidentet	Ministria Mjedisit ,Bujqesise, Shendetesise	Ministria Ekonomise	Ministria Ekonomise	Ministrit e e linjes
Kontrolli i Helmimit	Ministria Mjedisit ,Bujqesise, Shendetesise	Ministria Mjedisit,Shendetesis	Ministria Mjedisit Ministria e Shendetesis	Ministria Mjedisit, Shendetesis
Inventarizimi i Emetimeve	Ministria Mjedisit ,Bujqesise, Shendetesise	Ministria Ekonomi Mjedisit,Shendetesis	Ministria Ekonomise Ministria Mjedisit Ministria e Shendetesis	Ministria Ekonomi Mjedisit, Shendet.
Inspektimet	Ministria Mjedisit ,Bujqesise, Shendetesise	Ministria Ekonomi Mjedisit,Shendetesis	Ministria Ekonomise Mjedisit ,Shendetesis	Ministria Ekonomi Mjedisit, Shendet.
Informacion per Punetoret	Ministria Mjedisit ,Bujqesise, Shendetesise	Ministria Ekonomise	Ministria Ekonomise	Ministria Ekonomise
Informacion Publikut	Ministria Mjedisit ,Bujqesise, Shendetesise	Ministria Ekonomise	Ministria Ekonomise	Ministria Ekonomise
Te Tjera				

8.2 Percaktimi apo vendosja e te dhenave kombetare

Ne tabelen e meposhteme jepen disa te dhena orientuese mbi vend ndodhjen dhe burimin e te dhenave per menazhimin e kimikateve te cilat I perkasin ne te shumten e rasteve ministrive te linjes, Institutit Kombetar te Informatikes dhe Doganave. Teorikisht jan te percaktuara ne kete menyre por ne terrenin praktik hasen veshtiresi te natyrave te ndryshme qe bejne te pamundur perputhjen e kerkesave me mundesite reale per informacion

Tabela 8.B : Percaktimi i te Dhenave Kombetare

Lloji i te Dhenes	Vendodhja	Burimi i te Dhenes	Kush Ka Akses	Si te kemi Akses	Formati
Statistikat e Prodhimit	INSTAT Tr Ministria Ekonomise	Ministrite e linjes INSTAT Tr Min. Ekonomise	Publiku	Me kerkese	Publikim e website
Statistikat e Eksportit	INSTAT , doganat , Ministria Ekonomise	INSTAT Tr Ministria Ekonomise doganat	Publiku	Me kerkese	Publikim e website
Statistikat e Perdorimit te Kimikatit	Ministria Ekonomise, Mbrojtjes ,Bujqesise	INSTAT Min. Ekonomise Bujqesise,Mbrojtje	Specialistet e Ministrive	Me kerkese	Publikim e website
Raportet per Aksidentet Industriale	Ministrite linjes	Min. Ekonomise Min. Punes	Ndermarrjet	Me kerkese	Publikim e , website
Raportet per Aksidentet ne Transport	Ministrite linjes	Min. Transport Inspek .Shendetit. e Punes	Ministrite perkatese	Me kerkese	Publikim e website

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

Te Dhenat Profesionale Shendetesore industriale	Min.Shendetit. .. Min.Punes Min.Ekonomis	Inspektoriatet e Shendetit Inspektoriatet e Punes	Cdo njeri	Me kerkese	Publikim e website
Statistikat e Helmimeve	Ministrite linjes	Spitalet Ministria e Puneve te brendeshme	Cdo njeri	Me kerkese	Publikim e website
Clirimi Ndot dhe Regjistri i Transfertave	Min.Mjedisit	Inspektoret e mjedisit	Specialistet e Ministrive	Me kerkese	Publikim e website
Te Dhenat per Mbetjet e Rrezikshme	Ministria Ekonomise, Mbrojtjes ,Bujqesise	Ministria Ekonomise, Mbrojtjes ,Bujqesise	Specialistet e Ministrive	Me kerkese	Publikim e website
Regjistri i Pesticideve	Min.Bujqesise.	Min.Bujqesise	Specialistet e Ministrive	Me kerkese	Publikim e website
Regjistri i Kimikateve Toksike	Min.Shendetes	Min.Shendetes	Specialistet e Ministrive	Me kerkese	Publikim e website
Inventari i Kimikateve Ekzistuese	Ministrite e linjes	Ministrite e linjes	Specialistet e Ministrive	Me kerkese	Publikim e website
Regjistri i Importeve	Dogana	Dogana	Specialistet e Ministrive	Me kerkese	Publikim e website
Regjistri i Prodhuesve	Min.Ekonomis e Tregetise...	Min.Ekonomise Tregetise...	Specialistet e Ministrive	Me kerkese	Publikim e website
Vendimet e PIK	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo

8.3 Procedurat per mbledhjen dhe perhapjen e te dhenave Kombetare

Gjate hartimit te draftit per menazhimin e kimikateve ne rrang kombetar dualen nje sere problemesh qe megjithese nuk mund te zgjidhen per momentin jan nje program pune per te ardhmen ,per persosjen e sistemit te grumbullimit perpunimit dhe shperdarjes se informacionit per kimikatet.Keshtu megjithese ne duhet te kemi te dhena per importin e kimikateve te ndara sipas kategorive te perdorimit dhe te rezikshmeris ato nuk jan te ndara ,ne shume raste vendosen emra te pergjithshem “kimikate inorganike” pa ditur c’ sillet,ne raste te tjera perdoruesit nuk dine ku do te marrin lejet e importit ,perdorimit ,asgjesimit etj gje qe ve ne veshitresi organet vendimmarrese per nje manazhim e perdorim te kujdeshem.

Ministria e Shendetesise e Ministrise se Punes e Ceshtjeve Sociale dhe spitalet nuk kan te dhena dhe studime per efektet shendetesore dhe mjedisore te kimikateve qe me vone ti mbledhe ti analizoje e te nxjerre konkluzione vendimmarrese.

Por informacion te rregullt per dy grup kimikatesh,sic jane pesticidet per bujqesine dhe helmet per konsum ne popullate (zhdukjen e insekteve) ndiqen me kujdes nga ministria e Bujqesise dhe ajo e Shendetesise qe ka struktura te posacme per kete qellim.

Marrja e informacionit per keto probleme eshte e kufizuar vetem per persona te vecante dhe qellime te caktuara dhe biznesit I ruhet sekreti professional

Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

8.4 Literatura nderkombetare

Tabela 8.C : Disponimi i Literatures Nderkombetare

Literatura	Vendodhja	Kush Ka Akses	Si Te Kesh Akses
Dokumenta te Kritereve te Shendetit Mjedisor (WHO)	Min.Shendetes Min.Bujqesise	Cdo njeri	Pa kufizim
Udhezuesi i Shendetit dhe Sigurise (WHO)	Min.Shendetes Min.Bujqesise	Eksperte te ministrve	Me leje te ministrive perkatse
Dokumentat Udhezues per kimikateIPCS (FAO&UNEP)	Min.Bujqesise	Ndermarrjet , specialiste	Me leje te ministrive perkatse
Te Dhenat e Sigurise Pesticideve FAO/WHO	Min.Shendetes Min.Bujqesise	Eksperte te ministrve	Pa kufizim
Dokumenta nga FAO/WHO Mbi Mbetjet e Pesticideve	Min.Shendetes Min.Bujqesise	Eksperte te ministrve	Pa kufizim
Te Dhenat e Sigurise se Materialeve (industri)	Ministria Ekonomise	Eksperte te ministrve	Pa kufizim
Udhezuesi i OECD per Testimin e Kimikateve	Nuk eshte	Eksperte te ministrive	Pa kufizim
Principet e Praktikes Laboratorike	Ministrite e linjes	Eksperte te ministrive	Pa kufizim
Principet e Praktikes Prodhuese	Ministrite e linjes	Eksperte te ministrve	Pa kufizim
Rjeti i Librarise Globale Mjedisore WHO/UNEP	Min.Shendetes Qendra UNEP Tirane	Eksperte te ministirve	Pa kufizim

8.5 Mundesia e te dhenave nderkombetare

Tabela 8.D : Disponimi i Databejsit Nderkombetar

Databejsi	Vendodhja	Kush Ka Akses	Si Te Kesh Akses
IRPTC International Register of Potentially Toxic Chemicals	nuk ka	nuk ka	Me internet
ILO CIS	nuk ka	nuk ka	Me internet
InternationalProgram on Chemical Safety IPCS INTOX	nuk ka	nuk ka	Me internet
Databejsi i Permbledhjes se Sherbimeve Kimike	nuk ka	nuk ka	Me internet
Rjeti i Informacionit mbi Kimikatet	nuk ka	nuk ka	Me internet
Databejsi i Rrjetit te Info.Shkencor dhe Teknik	nuk ka	nuk ka	Me internet
Databejsi Perkates nga Vende te Tjera	nuk ka	nuk ka	Me internet

8.6 Sistemi I shkëmbimit të Informacionit Kombëtar

Informacioni Kombëtar për gjendjen e menaxhimit të kimikateve merret nepermjet sistemeve të internetit në websitet e ministrive por që janë shumë, shumë të varfëra për të mos thënë që mungojnë fare. Ka një pakujdesi të theksuar të aparatit të ministrive dhe të strukturave që i kontrollojnë për të vendosur të dhëna dhe informacione mbi menaxhimin e kimikateve në shërbim të informimit publik, të shkruar dhe të elektronik. Po të marrim parasysh që për situatën konkrete në shumë rrethë, përjashtuar Tiranën, është dobët informimi elektronik, informimi i shkruar del domosdoshmëri dhe i përket ministrive të linjës të gjejnë rruget e mundësitë për realizimin e tyre.

Një punë mjaft të vlefshme dhe rezultative po bëjnë organizatat ndërkombëtare e vendin tone UNDP; UNEP; ILO; WHO; UNITAR; FAO:::

Të cilat jo vetëm në ruge elektronike www.undp.org por dhe nepermjet broshurave të perkthyer në gjuhën shqipe kanë dhënë një kontribut të vlefshëm në përhapjen e informacionit në shumë zona të vendit

8.7 Komentë dhe Analiza

1. Ka mungesë në literaturë dhe informacionet baze dhe në shpërndarjen e tyre, të cilat kanë lidhje me sistemin e dobët të informimit në vend, buxheti i vogël i disponueshëm për literaturën, pjesëmarrje e ulët e përfaqësuesve të vendit në institucionet e huaja që kanë lidhje me kimikatet.
 1. Lidhur me vlerësimin e të dhënave për menaxhimin e kimikateve nuk kemi dublime apo konflikte sepse janë të pakta dhe për përdorim të brendshëm.
 2. Për institucionet e specializuara që mbajnë të dhëna informative të karakterit profesional siç janë ato të INSTAT apo drejtorise të doganave ato janë mjaft të sakta dhe të besueshme me data bazë automatike, por jo të gjithë databejsit janë automate në institucionet e tjera. Po behen përpjekje në këtë drejtim, megjithatë jemi larg automatizimit.
 3. Për këtë gjendje, ka përpjekje të vazhdueshme nepermjet orgoanizatave ndërkombëtare dhe donatoreve të tjerë që të përsoset sistemi i informacionit, por
 4. Nevoitet buxhet, trainim dhe rritja e kapaciteteve të strukturave përgjegjëse për informim sepse në shumë raste, aksesit në internet mungon dhe mjetet e tjera nuk janë disponueshme
 5. Shqipëria është pale e Konventës së Arhusit dhe po përpiqet të zbatojë filozofinë e përhapjes së informacionit në politikën kombëtare në lidhje me menaxhimin e kimikateve
-
-

Kapitulli 9
Infrastruktura Laboratorike

- 9.1 Pasqyra e Infrastruktures Laboratorike
- 9.2 Pasqyra e Sistemeve Qeveritare te Informacionit
- 9.3 Pasqyra e Trainimeve dhe e Programeve te Edukimit Teknik
- 9.4 Komete / Analiza , Konkluzione , Rekomandime

9.1 Pasqyra e Infrastruktures se Laboratorike

